ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4-MUJORE Nr. 24

2020

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria : botime KLSH - 01/2020/114 Tiranë, 2020

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE

kërkimore-shkencore-informative

shqip-anglisht

Nr. 24/2020, Tiranë

ISSN 2308-6106

Viti i IX-të i botimit 2020

Shtator - Dhjetor 2019

Seria: Botime KLSH – 01/2020/114

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR. 24

Redaktore: Irena Islami

Amantja Patozi

Art Design: Elisa Metaj

Seria: botime KLSH - 01/2020/114

Shtypur në Shtypshkronjën ”------”

Tiranë 2020

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

of research, science and information
in Albanian and in English

No. 24/2020, Tirana
ISSN 2308-6106
September - December 2019
Series: Publications ALSAI -01/2020/114

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof. Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Fakulteti i Drejtësisë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Dr. Sang M. Lee, Universiteti i Nebraskës, SHBA	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA**,** Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

I NDERUAR LEXUES !

Numri i 24-të i Revistës Kërkimore Shkencore të KLSH-së është botimi i 114-të i kolanës së botimeve të KLSH-së.

Në këtë numër të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre Kontrollori i Përgjithshëm i Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-ve, z. Gene Dodaro, Presidenti i Gjykatës Europiane të Audituesve z.Klaus-Heiner Lehne, Kryetari i KLSH-së, Dr.Bujar Leskaj, Prof.Assoc.Përparim Kabo, Prof.Dr.Skënder Osmani, Prof.Dr.Lindita Milo, Kontrollor i Përgjithshëm i SAI-t të Perusë, z.Nelson Shack Yalta, përfaqësues të SIGMAs, të Gjykatës Austriake të Auditimit, etj.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI "Experentia mutua omnibus prodest (*Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve*)".

Bordi Shkencor i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Rruga "Abdi Toptani"nr. 1,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Deklarata e Kongresit të XXIII-të të INTOSAI-t	INCOSAI XXIII, shtator 2019, Moskë	11
Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Arritjen e Prioriteteve dhe Qëllimeve Kombëtare	Z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-ve *(Fjala e mbajtur në INCOSAI XXIII)*	23
Promovimi i vendimmarrjes bazuar në fakte në procesin politik	Intervistë me z.Klaus-Heiner Lehne, President, ECA *Publikuar në revistën e ECA, Nr.4, 2019*	29
Faleminderit INTOSAI!	Bujar Leskaj Kryetar, KLSH	35
Realiteti shqiptar i Tranzicionit në fokusin e mendimtarëve amerikanë	Prof.Assoc. Dr.Përparim Kabo	51
Një pamje mbi elementin fundor stokastik dhe gjeostatistikën për vlerësimin e parametrave në burim	Prof.Dr.Skënder Osmani Aida Bode Univesiteti Politeknik i Tiranës Prof.Dr.Mihallaq Kotro Ervin Toromani Arben Boçari Universiteti Bujqësor i Tiranës	85

Paradigma e auditmit të jashtëm dhe mirëqeverisja	Prof.Dr.Lindita Milo Msc.Amantja Patozi KLSH	99
Zhvilimi i Marrëdhënieve efektive të punës ndërmjet parlamenteve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit	Bianca Breteche&Alastair Swarbrick, SIGMA *Publikuar në revistën e ECA, Nr.4, 2019*	107
Çfarë kontributi mund të sjellë auditimi i sektorit publik në garantimin e shoqërive etike dhe transparente?	*Ariane Holezek* *Gjykata Austriake e Auditimit* *Publikuar në EUROSAI Magazine,no.25-2019*	113
Teknologjia : Mundësitë për të ndërtuar kapacitete, për të forcuar mbikqyrjen	Nelson Shack Yalta Kontrollor i Përgjithshëm SAI i Perusë *Publikuar në INTOSAI Journal, Winter 2020*	117
Auditimi dhe strategjia e të dhënave	Koen Van der Bracht SAI i Belgjikës *Publikuar në INTOSAI Journal, Winter 2020*	121
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH-së (shtator-dhjetor 2019)	127
Gjykata Federale e Llogarive të Brazilit	Profil	185
Bordi i Auditimit të Republikës së Indonezisë	Profil	189

TABLE OF CONTENTS

Title	AUTHOR	PAGE
Moscow Declaration	INCOSAI XXIII September 2019, Moscow	195
The role of Supreme Audit Institutions in achieving National Priorities and Goals	Mr.Gene Dodaro Comptroller General of United States *(Remarks in INCOSAI XXIII)*	207
Promoting evidence-based decision making in the political process	Interview Klaus-Heiner Lehne ECA President *ECA Journal No.4,2019*	213
Thank you INTOSAI!	Bujar Leskaj ALSAI Chairman	219
A view on stochastic finite element and geostatistics for resource parameters estimation	Prof.Dr. Skënder Osmani Aida Bode University Polytechnic of Tirana Prof.Dr.Mihallaq Kotro Ervin Toromani Arben Boçari Agricultural University of Tirana	233
The paradign of external audit and good governance	Prof.Dr. Lindita Milo Msc. Amantja Patozi ALSAI	247

Developing effective working relationships between parliaments and supreme audit institutions	Bianca Breteche&Alastair Swarbrick, SIGMA *ECA Journal No.4,2019*	255
What could be the contribution of public sector auditing as a guarantee of ethical and transparent societies?	Ariane Holezek Austrian Court of Audit *EUROSAI Magazine, no.25-2019*	261
Technology: Opportunities to build capacity, enhance oversight	Nelson Shack Yalta Comptroller General of the Republic of Peru *INTOSAI Journal, Winter 2020*	265
Data, auditing and strategy	Koen Van der Bracht SAI of Belgium *INTOSAI Journal, Winter 2020*	269
Events and activities of ALSAI during September - December 2019	INFO	273
Federal Court of Accounts-Brazil	Profile	331
The Audit Board of the Republic of Indonesia	Profile	335

INCOSAI XXIII – DEKLARATA E MOSKËS

Parathënie

Në përputhje me misionin e INTOSAI për progresin e vazhdueshëm të auditimit të qeverisjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-eve), Kongresi XXIII-të i INTOSAI (INCOSAI) nxit vazhdimin e diskutimeve të mëparshme të INCOSAI dhe synon të sigurojë relevancën e vazhdueshme të SAI-eve si institucione me vlerë të madhe për shoqëria.

INCOSAI i XXIII-të iu përkushtua diskutimit se si secili SAI në nivel kombëtar mund të mbështetet në zhvillimet e auditimit të sektorit publik dhe përparimet teknologjike për të mbetur relevant, për t'iu përgjigjur nevojave të palëve të interesuara dhe të jetë një vlerë e shtuar duke siguruar mbikëqyrje të pavarur të jashtme mbi objektivat kombëtare të dakordësuara më parë, përfshirë dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Deklarata nxjerr në pah konkluzionet kryesore të INCOSAI të XXIII-të dhe fushat kryesore ku mund të nxitet progresi në INTOSAI.

Për të siguruar vlerat dhe përfitimet, SAI-et dhe INTOSAI duhet të aplikojë qasje të reja dhe të përfitojnë nga mundësitë për të përmbushur sfidat e zhvillimit. SAI-et duhet të përgjigjen ndaj një qeverisjes në ndryshim dhe, duke bërë këtë, t'i përgjigjen sfidave kombëtare dhe globale të zhvillimit.

Ndryshimet thelbësore në auditimin publik dhe politikën publike në të gjithë botën kanë krijuar një mjedis të ri dhe pritshmëri të reja për SAI-et. Ndryshimet e fundit në mjedisin e SAI-eve përfshijnë: (a) miratimin e Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm nga të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara; (b) revolucionin e të dhënave; (c) miratimin e Kuadrit të INTOSAI për Deklaratat Profesionale

(IFPP) dhe (d) pritjet dhe detyrimet që rrjedhin nga ISSAI-P 12: Vlera dhe përfitimet e SAI-eve- sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve. Rrethanat moderne kërkojnë cilësi të punës audituese, qasje të reja në auditim dhe kërkojnë nga SAI-et të rimendojnë më tej rolin e tyre në proceset e llogaridhënies së qeverisjes.

Ndërkohë që SAI-të ndryshojnë sa i përket kapaciteteve, konteksteve dhe mandateve të tyre, të gjithë përballen me sfida të ngjashme. Si t'i përgjigjemi kërkesës së opinionit publik për një administrim efektiv dhe eficient të burimeve publike? Si të përballen me kompleksitetin e qeverisjes, e nevojshme kjo për të arritur objektivat kombëtare, si dhe objektivat e programeve, politikave dhe strategjive? Si munden SAI-të dhe INTOSAI të trajtojnë ndryshimet që sjell revolucioni i të dhënave dhe dixhitalizimi?

Akumulimi i përshpejtuar i të dhënave dhe zhvillimet e shpjeta në teknologji dhe komunikim shërbejnë si sfida dhe mundësi për të përmirësuar cilësinë e auditimit publik, për të zhvilluar eficiencën e tij, për të nxitur drejtimin e tij strategjik duke rritur në këtë mënyrë vlerën e SAI-ve përkundrejt palëve të interesuara dhe duke rritur besimin në institucionet publike në të gjithë botën.

Nuk ka asnjë recetë që duhet ta ndjekin SAI-të për të qenë të shpejtë, efektiv, relevantë dhe institucione të pavarura me shumë vlerë. SAI-et do të vazhdojnë të kryejnë auditime financiare, përputhshmërie dhe performance në përputhje me mandatet e tyre zyrtare. SAI-et do të vazhdojnë të kryejnë veprimtari audituese, të cilat janë në përputhje me mandatet e tyre zyrtare dhe me pritshmëritë e palëve të interesuara. Sidoqoftë, drejtimet e mundshme në të cilat mund të përqendrohen SAI-et, këto në përputhje me kontekstet dhe mandatet e tyre përkatëse, mund të vendosen dhe mbështeten edhe nga INTOSAI.

INTOSAI ka struktura të mirëorganizuara dhe nisma që i mundësojnë INTOSAI të adresojë sfidat dhe mundësitë e zhvillimit. Kjo rrjedhë pune do të përbëjnë një pjesë integrale të detyrave, përparësive dhe planeve të INTOSAI-t në të ardhmen.

Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), që u takuan në Moskë nga data 25 deri më 27 shtator 2019:

- duke njohur Axhendën e

Zhvillimit 2030 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 25 shtator 2015 dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A / RES / 69/228 *"Promovimi dhe nxitja e eficiencës, llogaridhënies, efekti-vitetit dhe transparencës në administratën publike për forcimin e Institucioneve Supreme të Auditimit";*

- duke riafirmuar angazhimin për të dhënë një kontribut të rëndësishëm të auditimit të pavarur në Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, siç përcaktohet nga Deklarata e Abu Dhabi;

- duke njohur pavarësisë e SAI-eve si një parakusht themelor për një kontribut efektiv në llogaridhënie, transparencë, qeverisje të mirë, përdorimin e shëndetshëm të fondeve publike dhe, në fund të fundit, vlerën dhe përfitimet e SAI-eve në përputhje me ISSAI 12 dhe Planin Strategjik të INTOSAI 2017-2022;

- duke zbatuar Kuadrin e INTOSAI-t për Deklaratat Profesional, deklarojnë se drejtimet e ardhshme të auditimin publik varen nga angazhimi i fuqishëm i SAI-eve dhe INTOSAI-t për: I-sigurimin e një mbikëqyrjeje të pavarur të jashtme për arritjet e objektivave kombëtare, përfshirë dhe ato që lidhen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm;

II-përgjigjen në mënyrë efektive ndaj mundësive që sjell përparimi teknologjik;

III-rritjen e ndikimit të SAI-eve në llogaridhënien e menaxhimit publik dhe transparencë.

Sigurimin e mbikëqyrjes së jashtme të pavarur për arritjen e objektivave të dakordësuara më parë në shkallë kombëtare, duke përfshirë ato që lidhen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Anëtarët e INTOSAIT ranë dakord për sa vijon:

1. SAI-et inkurajohen të kontribuojnë për rezultate më efektive, transparente dhe të përgjegjshme, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e përpjekjeve të qeverive të nevojshme për të mbështetur arritjen e objektivave kombëtare dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

2. SAI-et inkurajohen të zhvillojnë qasje strategjike të auditimit publik që mbështesin arritjen e objektivave kombëtare dhe të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

3. SAI-et mund të rrisin vlerën e auditimit publik duke zgjeruar përgatitjen e informacioneve të bazuara në auditim për çështje të rëndësishme dhe strategjike të administratës publike dhe funksione të qeverisë.

Ti përgjigjen efektivisht mundësive që sjell zhvillimi i teknologjisë

4. SAI-et mund të promovojnë parimin e aksesimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave, burimit të kodeve dhe algoritmeve.

5. SAI-et mund të synojnë përdorimin më të mirë të analizës së të dhënave në auditime, përfshirë dhe adaptimin e strategjive për planifikimin e auditime të tilla, krijimin e grupeve me përvojë në analizimin e të dhënave dhe prezantimin e teknikave të reja në praktikën e auditimi publik.

Rritjen e ndikimit të SAI-eve

6. SAI-et mund të nxisin mendimin eksperimental për të përmirësuar inovacionin dhe zhvillimin.

7. SAI-et mund të shtrijnë fokusin në (a) identifikimin e zonave të riskut me interes kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimin mbi risqet; (b) nevojat për menaxhimin e risqeve sistemike në qeverisje, përveç risqeve operacionale, institucionale dhe risqeve të tjera të një entiteti të vetëm.

8. SAI-et inkurajohen të edukojnë audituesit e së ardhmes, të cilët mund të përdorin analizën e të dhënave, mjetet e inteligjencës artificiale dhe metoda të përparuara cilësore për forcimin e inovacionit dhe të veprojnë si aktorë strategjikë, shkëmbyes të njohurive dhe prodhues të vizionit për të ardhmen.

9. SAI-et duhet të marrin në konsideratë gjetjen e më shumë mënyrave për të adresuar gjithëpërfshirjen kur kryejnë auditime që kanë si pikë kryesore Axhendën e vitit 2030, me parimin për të mos lënë askënd pas dhe agjendat e të tjera të zhvillimit.

10. SAI-et mund të rrisin ndikimin e tyre pozitiv duke vendosur një bashkëveprim produktivë me subjektin e audituar dhe duke forcuar bashkëpunimin e komunikimin me komunitetin akademik dhe publikun në përgjithësi.

Arritja e këtij vizioni kërkon angazhime nga secili SAI individuale, si dhe mbështetje bashkëpunuese për SAI-et nga të gjitha strukturat e

INTOSAI, të tilla si Komitetet e Objektivave, strukturat organizative, organizatat rajonale, IDI, Revista Ndërkombëtare të Auditimit të Qeverisjes dhe Sekretariati i Përgjithshëm. Bashkëpunimi shumë-palësh dhe dypalësh midis SAI-ve do të vazhdojë të luajë një rol veçanërisht të rëndësishëm për të ndihmuar SAI-et që të mbeten relevante.

ANEKS

Shpjegimet për drejtimet e auditimit publik në të ardhmen.

Sigurimi i mbikëqyrjes së jashtme të pavarur për arritjen e objektivave të dakordësuara më parë në shkallë kombëtare, duke përfshirë ato që lidhen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

1. **SAI-et inkurajohen të kontribuojnë për rezultate më efektive, transparente dhe të përgjegjshme, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e përpjekjeve të qeverive, të nevojshme për të mbështetur arritjen e objektivave kombëtare dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.**

Çështjet kryesore

- Objektivat e reja globale dhe kombëtare kërkojnë punësimin në menaxhimin publik të bazuar në performance dhe të orientuar drejt rezultatit për të mbajtur qeveritë të përgjegjshëm para parlamentit dhe publikut.

- SAI-et inkurajohen të promovojnë llogaridhënien bazuar në përgjegjësinë profesionale, besimin dhe një qasje të ekuilibruar në vlerësimin e performancës. Përgjegjësia e orientuar drejt rezultate është më e vështirë për t'u fiksuar dhe shumë menaxherë publik ende po punojnë për të fituar aftësi për buxhetimin e bazuar në performancë dhe vendosjen e objektivave dhe rezultateve jo financiare të performancës.

- SAI-eve mund t'u duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë lidhjes midis masave të performancës me rezultatet komplekse.

- Kur është e rëndësishme, SAI-të mund të përqendrohen në vlerësimin e rezultateve dhe ndikimeve komplekse gjatë auditimit të programeve individuale ose enteve publike.

- Në përputhje me qasjen e auditimit të të gjithë qeverisjes, SAI-të mund të ndihmojnë në evidentimin e përpjekjeve në nivele të ndryshme të qeverisë në mënyrë që këto përpjekje të jenë në

përputhje me treguesit kryesorë (treguesit lokal, rajonal dhe kombëtar që kanë të bëjnë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm).

2. **SAI-et inkurajohen të zhvillojnë <u>qasje strategjike të auditimit publik</u> që mbështesin arritjen e objektivave kombëtare dhe të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.**

Çështjet kryesore

- INTOSAI synon të mbështesë SAI-et në dhënien e një kontributi vendimtar në suksesin e Axhendës së vitit 2030 dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë për të bërë një ndryshim në jetën e qytetarëve në përputhje me ISSAI-P 12.
- Objektivat kombëtare dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm vështirë se mund të arrihen pa përpjekje të përbashkëta të entiteteve publike, nivele të ndryshme të qeverisjes dhe shoqërisë.
- Inkurajohen SAI-et ta konsiderojnë rolin e tyre si kontribuues strategjik në qeverisje duke ruajtur pavarësinë e tyre. Pavarësia e tyre, pikëpamja e tyre unike mbi ciklin e buxhetimit dhe njohuritë e grumbulluara mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare afatgjata.
- Të gjithë SAI-et, brenda mandateve të tyre, mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare duke nxitur më tej një qasje strategjike në auditim, që nënkupton ndër të tjera: (1) kryerjen e auditimeve në mënyrë të koordinuar dhe të lidhur me vlerësimin e aftësisë së qeverisë për të arritur qëllimet e saj; (2) vlerësimin e pjekurisë së sistemeve që përcaktojnë qeverisjen strategjike përca-ktimin e objektivave, përafrimin e strategjive me qëllimet kombëtare dhe sigurimin e feedback-ut dhe kontrollet e duhura.
- SAI-et mund të vlerësojnë koordinimin në nivele të ndryshme të qeverisjes për të vlerësuar sinergjitë midis programeve publike, politikave dhe strategjive. Nëse mandati ligjor dhe konteksti e lejon, SAI-et duhet të pozicionohen mirë për të vlerësuar koherencën e politikave dhe të përqendrohen në çështje dhe metoda që ndërthuren edhe në një perspektivë tërësore të qeve-risjes.

3. SAI-et mund të rrisin vlerën e auditimit publik duke zgjeruar <u>përgatitjen e informacioneve të bazuara në auditim</u> për çështje të rëndësishme dhe strategjike të administratës publike dhe funksione të qeverisë.

Çështjet kryesore

- Përmes rekomandimeve të auditimit, SAI-et mund të përmbushin rolin e tyre këshillues pa kompromentuar pavarësinë, d.m.th. pa u angazhuar në menaxhim ose veprimtarinë e një entiteti të audituar.
- Aktiviteti këshilluese i SAI-t mund të ofrohen në një mënyrë që t'i kushtohet vëmendje Deklaratës së Pekinit ndërkohë që ilustrohen dhe promovohen parimet e Deklaratave të Limës dhe Meksikës (ISSAI-P 1, ISSAI-P 10).
- SAI-et duhet të mbrojnë pavarësinë dhe pozicionin e tyre duke shmangur ndërhyrjen në vendimmarrje, politikëbërje dhe funksionet e menaxhimit të qeverisjes, por mund të jenë vlerë e shtuar në adresimet strategjike, tema komplekse dhe të ndjeshme përmes ofrimit të rekomandimeve.
- Dhënia e këshillave duhet të bazohet në prova dhe rekomandimet e auditimit, të bazuara në pozicione të pavarura institucionale të SAI-ve, njohuri unike të akumuluara dhe gjykim profesional.
- Produktet jo audituese të SAI-ve mund të rrisin vlerën e tyre në promovimin dhe qeverisjen e mirë përmes shpërndarjes së ekspertizës dhe praktikave më të mira.

T'U PËRGJIGJEMI NË MËNYRË EFIKASE ZHVILLIMEVE TEKNOLO-GJIKE

4. SAI-t mund të promovojnë parimin e <u>aksesimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave, burimit të kodeve dhe algoritmeve.</u>

Çështjet kryesore

- Të dhënat e disponueshme të krijuara nga administrata publike (open data) po rriten me shpejtësi. Aksesi i të dhënave krijon një mjedis të ri informacioni për të gjithë. Përdorimi efektiv i të dhënave publike kontribuon në rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies së qeverisë.
- SAI-t mund të luajnë një rol të rëndësishëm në informimin dhe orientimin e qeverive në lidhje me përfitimet që sjell aksesimi i të

dhënave publike. SAI-t mund të promovojnë parimin e disponueshmërisë dhe hapjes së të dhënave të prodhuara nga qeveria, nëse nuk prek ligjet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

- SAI mund të promovojë hapjen e sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes të përdorura nga qeveria sipas parimeve të kodit burim të hapur dhe open Data.
- SAI-t duhet të lehtësojnë një diskutim në lidhje me publikimin e rezultateve të SAI-ve në një format të hapur të të dhënave *(Open Data).*

5. SAI-t mund të synojnë përdorimin më mirë <u>të analizës së të dhënave në auditime,</u> përfshirë dhe adaptimin e strategjive për planifikimin e auditime të tilla, krijimin e grupeve me përvojë në analizimin e të dhënave dhe prezantimin e teknikave të reja në praktikën e auditimi publik.

Çështjet kryesore

- Përdorimi i analizës së të dhënave në SAI është një risi që i bën të dhënat një burim për promovimin e efikasitetit, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike.
- Pozicioni unik i SAI-ve brenda sektorit publik u lejon atyre të mbledhin një pjesë të madhe të të dhënave nga subjektet e audituara. Përdorimi i teknikave të analizimit të *Big Data* gjatë procesit të auditimit, u mundëson SAI-ve:
  - ✓ Përfshirjen në departamente, fusha, nivele qeveritare dhe rajone të ndryshme, duke mundësuar sintezën e të dhënave të marra dhe gjetjen e zgjidhjeve të plota për problemet e qeverisë;
  - ✓ Kombinimin në vend në terren dhe mbledhjen e të dhënave mikste për të siguruar përditësime të rregullta të të dhënave dhe mundësimin e monitorimit në kohë reale të çështjeve gjithëpërfshirëse dhe fushat kryesore të rrezikut.
- SAI-t mund të përfitojnë nga kryerja e kërkimeve analitike të të dhënave në fazën paraprake të auditimeve. Kjo do të shkurtojë kohën e punës në terren dhe do të lejojë monitorim të rregullt.
- SAI-t mund të përfitojnë nga zgjerimi i studimeve kërkimore dhe përmirësimi i brendshëm i metodologjisë së punës së tyre për të aplikuar metodat e duhura kërkimore.

SAI-t gjithashtu mund të angazhojnë institucione akademike për të kryer kërkime të përbashkëta.

- Duke forcuar bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve dhe organizatave ndërkombëtare relevante, INTOSAI mund të mbledhë të dhëna të shumta nga SAI-t lidhur me eksperiencat dhe dijet e tyre në auditim, të përpunojë udhëzues dhe raporte kërkimore, duke inkurajuar SAI-t në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

RRITJA E IMPAKTIT TË SAI-ve

6. SAI-t mund të nxisin mendimin eksperimental për të përmirësuar inovacionin dhe zhvillimin.

Çështjet kryesore

- SAI-t mund të rrisin kapacitetet e tyre inovative dhe eksperimentale, d.m.th. të përfshijnë të mësuarit, testimin dhe vlerësimin e fazave në disa pjesë të punës së tyre. Qasjet eksperimentale në SAI mund të përshpejtojnë të mësuarit dhe të krijojnë kapacitete nga ndërtimi dhe testimi sistematik i supozimeve dhe identifikimi i mangësive në njohuri.
- SAI-t mund të mbështesin përdorimin më efikas në shoqëri të njohurive të bazuara në eksperiment dhe të përfshijnë në mënyrë më të plotë të eksperimentimeve në programet qeveritare, strategjitë dhe politikat.
- Eksperimentimi në politikën publike synon të gjejë mënyra inovative për të dhënë rezultate. Për të trajtuar çështje të ndërlikuara dhe për të dhënë rezultate më të mira, qeveritë duhet të marrin përsipër qasjet eksperimentale, të gjejnë se çfarë funksionon dhe çfarë nuk funksionon në politikat publike, gjë që lejon të kuptojmë efektivitetin e ndërhyrjeve.
- SAI-t mund të "udhëheqin nëpërmjet shembullit", duke promovuar një mentalitet që inkurajon eksperimentimin me qasje inovative në të gjithë sektorin publik. Kështu, SAI-t mund të nxisin qeveritë në drejtim të inovacionit.

7. SAI-t mund të shtrijnë fokusin në (a) identifikimin e zonave të riskut me interes kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet; (b) nevojat për menaxhimin e risqeve sistemike në qeverisje, përveç risqeve operacionale, institucionale dhe risqeve të tjera të një entiteti të vetëm.

Çështjet kryesore

- SAI-t inkurajohen të kenë një këndvështrim prioritar mbi objektivat e qeverive respektive, të identifikojnë rreziqe domethënëse dhe sistemike në nxjerrjen e rezultateve dhe në rekomandimet e dhëna të identifikohen mënyrat për shmangien e rreziqeve.
- SAI-t mund të konsiderojnë krijimin e grupeve të parashikimit dhe të fillojnë të ofrojnë produkte me një perspektivë parashikimi për të bashkuar analizën e auditimit dhe aktivitetet jo-audituese.
- SAI-t të vazhdojnë të mbështesin me vendimet e tyre programet e hartuara të menaxhimit të riskut që të parashikojnë riskun e auditimit dhe të shmangin përjashtimin e subjekteve që duhet të jenë të përfshira në planet e auditimit.
- Menaxhimi i riskut duhet të bëhet një praktikë e rregullt e menaxhimit të SAI-ve.

8. SAI-t inkurajohen të edukojnë audituesit e së ardhmes, të cilët mund të përdorin analizën e të dhënave, mjetet e inteligjencës artificiale dhe metoda të përparuara cilësore për forcimin e inovacionit dhe të veprojnë si aktorë strategjikë, shkëmbyes të njohurive dhe prodhues të largpamësisë.

Çështjet kryesore

- SAI-t inkurajohen të kontribuojnë në përmirësimin e profesionalizmit të stafit të tyre. Kompetencat dhe aftësitë e audituesve janë aseti kryesor i SAI-ve.
- Ndryshimet në mjedisin e auditimit dhe pritshmëritë e palëve të interesit kërkojnë aftësi të reja për grupet e audituesve të SAI-ve:

✓ analiza strategjike e të menduarit-fizibiliteti, mendimi i drejtuar nga hipoteza, orientimi drejt objektivit, parashikimi, planifikimi strategjik, të menduarit sistemik, prioritetet;

✓ analiza e të dhënave - të punuarit me *datasets dhe databases*, vizualizimi i të dhënave dhe prezantimi i të dhënave komplekse;

✓ *soft-skills* - komunikim efektiv, inteligjencë emocionale, krijim dhe ruajtje e besimit të bazuar në profesionalizëm, udhëheqje, aftësi për të ndërtuar konsensus.

- Për të forcuar potencialin analitik, SAI-t mund të krijojnë njësi analitike për të adresuar probleme të veçanta (p.sh., të kuptuarit e

risqeve dhe menaxhimin e tyre, vlerësimin e programit, etj).

9. SAI-t duhet të marrin në konsideratë gjetjen e më shumë mënyrave për të adresuar gjithë-përfshirjen kur kryejnë auditime që kanë si pikë kryesore Axhendën e vitit 2030, me parimin për të mos lënë askënd pas dhe agjendat e të tjera të zhvillimit.

Çështjet kryesore

- SAI-t mund të përfitojnë nga ekspertiza e njeri-tjetrit dhe të kontribuojnë për mirë-qeverisjen dhe për politikat e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) në fushat me rëndësi shoqërore që lidhen me këtë strategji (mjedisi, arsimi, kujdesi shëndetësor, barazia gjinore, etj).
- SAI-t mund të kontribuojnë në parimin e "askënd mos lini pas", duke audituar temat e barazisë gjinore dhe tema të tjera gjithëpërfshirëse. Në auditimin e barazisë gjinore dhe gjithë-përfshirjes, është kritike për të rënë dakord për kuptimin e saj në kontekstin kombëtar dhe për të sqaruar pasojat e tij në implementimi e Axhendës së vitit 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.
- SAI-t mund të vlerësojnë gatishmërinë e sistemeve statistikore kombëtare për të monitoruar objektivat kombëtare dhe zbatimin e SDG, duke kryer auditime që sjellin informacione mbi performancën.
- SAI-t mund të konsiderojnë vlerësimin e gjithë-përfshirjes pasi shqyrtojnë gatishmërinë e mekanizmave kombëtarë të zbatimit, objektivat e qeverisë, informacionin mbi performancën dhe zbatimin e SDG-ve specifike si edhe objektivat kombëtare për të cilat është rënë dakort, etj.

10. SAI-et mund të rrisin ndikimin e tyre pozitiv duke vendosur një bashkëveprim produktiv me subjektin e audituar dhe duke forcuar bashkëpunimin e komunikimin me komunitetin akademik dhe publikun në përgjithësi.

Çështjet kryesore

- Ndërveprimi me të audituarin është thelbësor për të shpjeguar dhe sqaruar rekomandimet e SAI-ve dhe për të lehtësuar zbatimin e tyre.
- SAI-t mund të përfitojnë nga komunikimi efektiv midis tyre dhe palëvë të interesit, gjë që rrit aftësinë e SAI-ve për të identifikuar dhe analizuar çështjet me interes kombëtar për të informuar vendim-marrësit lidhur

me një program, projekt apo veprimtari.

- SAI-t mund të përmirësojnë komunikimin e tyre me ekspertë dhe komunitete akademike- një burim i vlefshëm informacionesh relevante dhe opinionesh të bazuara në prova. SAI-t gjithashtu mund të përfitojnë nga përdorimi i studimeve kërkimore dhe zhvillimi i qasjeve të tyre metodologjike.
- SAI-t gjithashtu mund të përfitojnë nga angazhimi i qytetarëve, përmes të dhënave të burimeve njerëzore, takimeve shkencore, objeksioneve, etj. Mjetet e angazhimit publik shërbejnë si katalizatorë për frymëzimin publik, rrisin besimin e publikut, mundësojnë përqendrimin e përpjekjeve të ndërsjella, dhe inkurajojnë zgjidhje inovative për sfidat publike.

Përktheu: Alma Shehu,

Audituese e parë

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

ROLI I INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT (SAI-ve) NË ARRITJEN E PRIORITETEVE DHE QËLLIMEVE KOMBËTARE

Fjala e z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i SHBA-ve

Diskutim në Temën e II-të të Kongresit INCOSAI XXIII, 23-27 shtator 2019, Moskë

Mirëmëngjes. Unë po filloj duke falenderuar Presidentin e Dhomes Ruse të Llogarive, Z. Aleksej Kudrin dhe Dhomën e Llogarive të Federatës Ruse që më ftuan të marr pjesë në këtë seancë plenare të rëndësishme për Temën e II-të të Kongresit.

Siç e dimë të gjithë, ISSAI 12 –"Vlera dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit" na bën thirrje që të bëjmë një ndryshim në jetën e qytetarëve. Tema jonë për këtë pasdite është veçanërisht e përshtatshme, pasi një përgjegjësi thelbësore e SAI-ve është të sigurojmë që ne po punojmë për çështjet dhe përparësitë më të rëndësishme, me të cilat përballet secili prej vendeve tona.

Si shumë SAI të tjerë, GAO ka një plan strategjik që udhëzon punën tonë dhe na mban të përqendruar në çështjet jetike për Shtetet e Bashkuara. Plani ynë aktual, që përfshin vitet 2018-2023 eksploron trendet, paqartësitë kryesore dhe implikimet e tyre, dhe nxjerr në pah çështjet kombëtare që mund të jenë shqetësimi më i madh për Kongresin tonë dhe popullin amerikan në vitet dhe dekadat e ardhshme. Qëllimet strategjike të planit, objektivat strategjikë dhe përpjekjet kryesore detajojnë përparësitë dhe organet thelbësore të punës që do të ndërmarrim, në përgjigje të këtyre tendencave dhe paqartësive.

Nuk është për t'u habitur, duke pasur parasysh shtrirjen e mandatit të GAO-s dhe objektivat e Axhendës së vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-se, si dhe 17 Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm, se ekziston një shkallë e lartë e përafrimit të drejtpërdrejtë midis planit tonë strategjik dhe ketyre qellimeve. Për shembull:

OBJEKTIVI 4 i ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM është "Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe të

barabartë me cilësi dhe promovimi i mundësive për të mësuar gjatë gjithë jetës". Në SH.B.A. dhe gjetkë, kolegji dhe arsimi tjetër pas arsimit te mesem -duke përfshirë programet e arsimit profesional, të diplomuarve dhe programe të tjera - luajnë një rol jetësor në mbështetjen e suksesit ekonomik për individët dhe kombin në tërësi. Për të zgjeruar aksesin në arsimin pas atij të mesëm, programet federale të SHBA-ve japin miliarda dollarë ndihmë çdo vit. Sipas objektivit strategjik të GAO-s për të mësuar gjatë gjithë jetës, ne kemi bërë raporte të shumta për shumë vite dhe kemi bërë shumë rekomandime për nevojën për të përmirësuar mbikëqyrjen dhe përgjegjshmërinë e programeve federale të ndihmës studentore. Raportet kanë treguar nevojën për të forcuar programet e ndihmës, për të vepruar më mirë në dobi të studentëve dhe taksapaguesve, si dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë për rezultatet e studentëve, duke ruajtur qasjen.

OBJEKTIVI 13 i ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM është që "të ndërmarrë veprime urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij". Sipas Këshillit Kombëtar të Kërkimit Shkencor të SHBA dhe Programit Global të Kërkimit Shkencor të Ndryshimeve Klimatike të SHBA-së, ndryshimet në klimën e Tokës-përfshirë temperaturat më të larta, ndryshimet e reshjeve, rritja e nivelit të deteve, si dhe ngjarjet më të rënda dhe të shpeshta të motit-janë duke u zhvilluar dhe pritet të rriten me kalimin e kohës. Këto rreziqe krijojnë ekspozim të konsiderueshëm fiskal për qeverinë federale.

Raportet e fundit të GAO-s, nën objektivin tonë strategjik, që mbulojnë burimet natyrore dhe mjedisin, rishikuan dobësitë e energjisë, ujit, infrastrukturës mbrojtëse, rreziqeve të acidifikimit të oqeanit dhe efekteve të ndryshimit të klimës në siguruesit federalë dhe zinxhirët e furnizimit. Zbuluam se agjensitë federale kanë filluar të adresojnë rreziqet e ndryshimit të klimës. Sidoqoftë, shumë më tepër duhet të bëhet, duke pasur parasysh shtrirjen e problemit aktual me zhvillimet klimatike.

OBJEKTIVI 16 i ZHVILLIMIT TE QENDRUESHEM është "Të promovojë shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, të sigurojë qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtojë institucione efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet". Puna e GAO-s në përputhje me këtë objektiv përfshin të gjitha objektivat tona strategjike. Për

shembull, ne punojmë në larminë e fuqisë punëtore federale, kemi rishikuar strategjitë e qeverisë lidhur me angazhimine qytetarëve, ne shpesh shohim se si programet federale u shërbejnë kategorive vulnerabël të popullsisë dhe ne punojmë për të forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë.

Programi ynë i Rrezikut të Lartë dhe raportet tona vjetore të copëzimit të programit federal, mbivendosjes, dublimit dhe mundësive për kursime të kostos dhe zgjerim të ardhurash, janë dy nisma specifike të GAO-s, që janë të përqendruara drejtpërdrejt në adresimin e çështjeve më të rëndësishme me të cilat përballen Shtetet e Bashkuara.

Së pari, në lidhje me programin tonë të rrezikut të lartë: Që nga fillimi i viteve 1990, programi i vleresimit te risqeve te larta i GAO-s e ka përqendruar vëmendjen në operacionet e qeverisë, të cilat paraqesin vulnerabilitet më të madh ndaj mashtrimit financiar, shpërdorimeve, abuzimeve dhe keqmenaxhimit, ose që kanë nevojë për transformim për të adresuar ekonomicitetin, efiçiencen, ose sfidat e efektivitetit. Çdo dy vjet ne raportojmë për përparimin që adreson zonat me rrezik të lartë dhe përditësojmë listën e risqeve të larta. Raporti ynë më i fundit, publikuar në muajin mars 2019, diskutoi 35 fushat me rrezik të lartë që janë ndër çështjet më të ngutshme, me të cilat përballet qeveria federale.

Çështjet e rrezikut të lartë mbulojnë gamën e plotë të operacioneve federale, duke përfshirë Menaxhimin Federal të Strategjisë së Kapitalit Njerëzor, Modernizimin e Sistemit Rregullator të Financave të SHBA-ve, Kufizimin e Ekspozimit Fiskal të Qeverisë Federale duke menaxhuar më mirë rreziqet e ndryshimit të klimës, Përmirësimin e Menaxhimit të Blerjeve dhe Operacioneve të Teknikes se Informacionit, Mbrojtjen e Shëndetit Publik përmes Mbikëqyrjes së Përmirësuar të Produkteve Mjekësore dhe Zbatimit të Ligjeve Tatimore.

Programi ynë i rreziqeve të larta ka sjellë vëmendje, aq të nevojshme për problemet kryesore kombëtare që pengojnë qeverisjen efektive dhe kushtojnë miliarda dollarë çdo vit. Përfitimet financiare për qeverinë federale, për shkak të përparimit në adresimin e zonave me rrezik të lartë gjatë 13 viteve të fundit arritën në afro 350 miliardë dollarë ose mesatarisht rreth 27 miliardë dollarë në vit.

Në lidhje me punën tonë lidhur me rastet e fragmentimit, mbivendosjes dhe dublimit të programeve federale, raportet tona, të publikuara çdo vit që nga viti 2011, kanë përmbledhur gjithsej mbi 900 masa të rekomanduara për Kongresin ose agjencitë e degëve ekzekutive, për të zvogëluar, eliminuar ose menaxhuar më mirë fragmentarizimin, mbivendosjen ose dublimin e programeve, duke arritur kursime tek ulja e kostos; ose rritje të të ardhurave. Puna jonë shqyrton jo vetëm se si programet ose agjensitë individuale funksionojnë në izolim, por edhe më shumë se si përpjekjet kolektive nëpër programe dhe agjensi po kontribuojnë në rezultate të rëndësishme kombëtare.

Kjo ndërprerje - ose ajo që shpesh quhet "E tërë Qeveria"- perspektiva për auditimet e performances, e cila jep përfitime thelbësore. Në përgjithësi, rreth gjysma e 900 masave të rekomanduara në raportet e GAO-s ndaj fragmentimit, mbivendosjes ose dublikimit të programeve qeveritare janë zbatuar plotësisht nga Kongresi ynë ose nga agjensi ekzekutive. Veprimi mbi bazën e rekomandimeve tona ka ndihmuar qeverinë federale të kursejë mbi 262 miliardë dollarë, që nga viti 2011. Ende duhet të bëhet më shumë. Për të cituar një nga shumë shembuj, siguria e ushqimit ka nevojë për vëmendje në Shtetet e Bashkuara, ashtu siç është në një numër vendesh të tjera. Çdo vit në SHBA rreth 48 milion njerëz sëmuren dhe 3000 vdesin nga sëmundje të shkaktuara nga ushqimi.

Një strukturë komplekse e qeverisjes është përgjegjëse për sigurinë e ushqimit në SHBA me 16 agjenci që mbikqyrin së bashku zbatimin e të paktën 30 ligjeve që lidhen me ushqimin. GAO ka gjetur se, ndërsa agjensitë individuale dhe programet e tyre mund të menaxhohen mirë brenda mandateve të tyre specifike, sistemi i përgjithshëm i sigurisë ushqimore është i fragmentuar dhe vuan nga mungesa e koordinimit dhe koherencës.

GAO ka treguar prej kohësh nevojën për një strategji plotësisht të integruar të sigurisë kombëtare të ushqimit, e cila përfshin përgjegjësitë e 16 agjencive të sigurisë ushqimore. Por deri më tani nuk janë ndërmarrë veprime kuptimplota të mjaftueshme.

Unë veçoj iniciativat e listave të rreziqeve të larta dhe listave të fragmentimit, mbivendosjes dhe dublikimeve të programeve qeveritare të GAO-s, sepse, siç kemi parë të gjithë në kontekstet tona kombëtare dhe sikurse është

nënvizuar në dokumentin e diskutimit të Temës 2 të Kongresit, mënyra të reja të të menduarit, qasje të reja të menaxhimit publik dhe kapacitete të reja qeveritare janë thelbësore për qeveritë tona kombëtare, për të arritur qëllimet e tyre kombëtare, duke përfshirë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Politika gjithnjë e më komplekse dhe ndërlidhëse e sfidave me të cilat përballet qeveria - veçanërisht në një mjedis global - kërkon që qeveritë të rrisin ose zhvillojnë grupe të reja të kapaciteteve themelore, duke përfshirë krijimin e mekanizmave institucionalë që lehtësojnë menaxhimin e performancës më gjerësisht në rezultatet kombëtare që prekin shumë fusha njëherësh, përveç çdo programi ose agjencie individuale. Kjo përfshin miratimin e një orientimi drejt Tërësisë së Qeverisjes (“Whole of Government”, ose objektivave tërësore) ndaj vendimmarrjes, shpërndarjes së burimeve, përfshirjes dhe koherencës së politikave.

Si përfundim, mësimi për të gjithë ne në komunitetin e llogaridhënies është që ne duhet të sigurojmë që praktika jonë e auditimit të performancës të zhvillohet në përputhje me kompleksitetin e qasjeve dhe strukturave të qeverisjes që përdoren për të adresuar sfidat kombëtare. Broshura e Temës së dytë për këtë Kongres e mbulon shumë mirë këtë mësim. Sikurse e dëshmojnë auditimet tona të rreziqeve të larta dhe të fragmentimit, mbivendosjes dhe dublikimit të programeve qeveritare, duke adoptuar një qasje të Qeverisjes Tërësore (“Whole of Government”) në punën tonë të auditimit, SAI-t mund të kontribuojnë në arritjen e përparësive dhe qëllimeve kombëtare, dhe në këtë mënyrë, të ofrojnë "vlera dhe përfitime" më të mëdha për palët e interesuara të tyre dhe për qytetarët.

PROMOVIMI I VENDIMMARJES BAZUAR NË FAKTE NË PROCESIN POLITIK

Intervistë me Presidentin e ECA, Z. Klaus-Heiner Lehne

Në Shtator 2019, Kolegji i ECA rizgjodhi z. Klaus-Heiner Lehne si President të saj për një mandat të dytë tre vjeçar. Pasi ka shërbyer si anëtar i Bundestagut gjerman dhe Parlamentit Evropian, Klaus-Heiner Lehne ka njohuri të plota për tranzicionin politik dhe atë çka politikëbërësit kërkojnë, veçanërisht kur janë të rinj në detyrë.

Nga: Gaston Moonen

Publikuar në "ECA Journal", nr.4/2019

Drejtimi i ECA për tre vjet të tjera

Klaus-Heiner Lehne buzëqesh kur e urojnë për rizgjedhjen e tij si President i ECA. "Faleminderit shumë. Besimi që kanë treguar kolegët e mi më motivon të vazhdojmë përpjekjet tona të përbashkëta për të modernizuar Gjykatën dhe për të forcuar rolin e saj si audites i jashtëm i Unionit.Ne konstatojmë që raportet tona përdoren gjithnjë e më shumë për të ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit financiar të BE-së dhe aktiviteteve të tij rregullatore. Unë gjithashtu kam marrë shumë reagime pozitive nga kolegët e mi, Presidentë dhe Auditues të Përgjithshëm të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) në shtetet anëtare dhe më gjerë. Unë jam shumë mirënjohës për bashkëpunimin e shkëlqyer midis anëtarëve të Kolegjit dhe për përkushtimin e entuziazmin e stafit tonë" nënvizon z. Lehne.

Kutia 1 – Klaus-Heiner Lehne rizgjidhet si President i ECA

Në Shtator 2019, Kolegji ECA rizgjodhi Klaus-Heiner Lehne si Presidentin e saj për tre vjet të tjerë. Mandati i tij i dytë si President i ECA zgjat nga 1 tetori 2019 deri më 30 shtator 2022. Kolegji e emëroi z. Lehne për herë të parë si anëtar të ECA në 2014. Në maj të vitit 2019, Qeveria gjermane propozoi të rinovojë mandatin e tij edhe për gjashtë vjet, duke filluar nga 1 Mars 2020.

Lidhur me përparësitë në mandatin e tij të dytë si President i ECA, Klaus-Heiner Lehne dëshiron të bazohet në ndryshimet e suksesshme të prezantuara në Strategjinë aktuale të ECA 2018-2020. "Së pari duhet të transferojmë strategjinë ekzistuese në një strategji të re. Ne zhvilluam seminarin vjetor të ECA në shtator, ku diskutuam rreth zbatimit të strategjisë sonë aktuale dhe reflektuam rreth post-strategjisë pas vitit 2020. Një peer review për strategjinë tonë aktuale do të përfundojë në muajt në vijim dhe ne kemi marrë tashmë reagimet paraprake të kolegëve"- shprehet z. Lehne. Ai deklaron se raporti përfundimtar i peer review pritet në fund të vitit 2019. "Përfundimi kryesor i diskutimeve tona në shtator ishte që strategjia jonë e rradhës ka të ngjarë tëmbulojë një periudhë prej pesë vitesh"- nënvizon presidenti i ECA.

Të jesh i depolitizuar por politikisht i rëndësishëm…

Një strategji pesë-vjeçare do të harmonizonte veprimtarinë e ECA me Këshillin Evropian dhe Komisionin Evropian. Data e fillimit dhe e mbarimit do të ishte e ndryshme, por kjo nuk është problem. "ECA është një institucion i depolitizuar. Si ish politikan mund t'ju them se ne me të vërtetë jemi një institucion i depolitizuar. Por ajo që ne bëjmë ka natyrisht rëndësi politike"-shprehet presidenti i ECA. Kjo është aryeja që z. Lehne e vlerëson si shumë të rëndësishme lidhjen e të ngushtë me palët e interesit të ECA-s, veçanërisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin. "Ajo që palët tona të interesit bëjnë, natyrshëm ka ndikim në punën tonë"- nënvizon z. Lehne.

Gjatë kohës si anëtar i Parlamentit Evropian, Klaus Heiner Lehne ishte veçanërisht aktiv në Komitetin e Çështjeve Ligjore, të cilin ai e kryesoi për pesë vjet. Në atë komitet, ai nuk merrej shpesh me botime e ECA. Presidenti shprehet se: "Sigurisht që kisha dëgjuar për raportet e ECA, por raporti i vetëm me të cilin kam pasur ndonjë marrëdhënie gjatë kohës që kam kaluar në Komitetin e Çështjeve Ligjore ishte raporti i parë special për rregullimin më të mirë dhe sistemin e vlerësimit të ndikimit të BE - një temë qartësisht e rëndësishme për komitetin që unë drejtoja në atë kohë. Si kryetar i këtij komiteti, si dhe gjatë punës time në komitetin e tregut të brendshëm, unë kam qenë përgjegjës për çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e ndikimit".

Për Presidentin e ECA-s, ndryshimi nga një institucion në tjetrin në vitin 2014 nënkuptonte gjithashtu ndryshimin e disa zakoneve. Ai shprehet se: "Më parë, nëse lexoja

një artikull të gazetës në mëngjes dhe nëse përmbajtja më mërzite ose zemëronte, unë kontaktoja një gazetar për ti dhënë atij disa informacione për të përgënjeshtruar atë që ishte shkruar në gazetë. Në rastin mëtë mirë ato që unë kisha përgënjeshtruar do të gjendeshin në gazetë në ditët në vijim". Ai sqaron se anëtarët e ECA nuk mund të bëjnë gjëra të tilla. "Në këtë detyrë duhet të jeni më shumë si një gjykatës, i cili duhet të jetë plotësisht i pavarur. Kjo do të thotë që nuk duhet të ndërhyni në politikën aktuale të jetës së përditshme"- nënvizon z.Lehne.

..... Kjo do të thotë t'i mbash veshët hapur për ata që janë në politikë

Kur bëhet fjalë për të ndikuar në një institucion jo politik si ECA, Presidenti i ECA ka disa këshilla për politikanët. "Nëse ata bëjnë propozime të mira për auditime, ne me siguri do t'i përfshijmë ato në programin tonë vjetor të punës"- shprehet z. Lehne. Ai i referohet programeve vjetore të punës së ECA-s. Më tej ai shpjegon se: "Parlamenti Evropian bën, mesatarisht rreth 60 propozime në vit. Ne kemi përfshirë një të tretën deri gjysmën e këtyre sugjerimeve në programin tonë vjetor të punës. Sigurisht, ata duhet të bëjnë propozime të mira!"

Klaus-Heiner Lehne thekson se përmirësimi i marrëdhënieve me palët e interesit është një objektiv i rëndësishëm në Strategjinë e ECA 2018-2020. "Unë mendoj se kemi përparuar shumë në mardhëniet me Parlamentin Evropian. Në fundin e mandatit legjislativ, unë u ftova në Konferencën e Presidentëve (takimi i liderëve të grupeve politike), që është organi më i lartë vendimmarrës në Parlamentin Evropian, përveç seancës plenare. Çdo vit takoj kryetarët e komiteteve në Konferencën e Kryetarëve të Komiteteve të Parlamentit Evropian për një shkëmbim stimulues të përparësive. Është e rëndësishme për ne t'i dëgjojmë dhe t'i informojmëata për disa nga gjetjet tona kryesore, pasi ata janë vendimmarësit kryesorë që përgatisin legjislacionin"- shprehet z. Lehne.

Në përgjithësi, ai i konsideron marrëdhëniet me Parlamentin Evropian si të shkëlqyera. "Ne kemi përmirësuar marrëdhëniet tona me Komitetin e Kontrollit Buxhetor (CONT) dhe pothuajse me të gjitha komitetet e tjera të specializuara". Ai e ilustron këtë duke përmendur takimin që Kolegji i ECA ka pasur me Monika Hohlmeier, kryetaren e re të CONT. Ai nënvizon se ECA është shumë e vetëdijshe që CONT ka kapacitete të kufizuara për t'u marrë

me rreth 35 deri 40 raporte speciale të publikuara nga ECA gjatë një viti. Megjithatë ai shton se: “Komitetet e specializuara janë shumë të interesuara për raportet tona të performancës. Ekzistojnë më shumë se 20 komitete të specializuara për të cilat duhet të jetë plotësisht e menaxhueshme që të shqyrtojnë mesatarisht dy raporte të ECA-s në vit”.

Për Presidentin e ECA-së është e qartë se duhet të bëhen marrëveshje mes CONT dhe komiteteve të tjera të specializuara. Ai shpjegon se mund të organizohen takime të përbashkëta për të cilat një komitet i specializuar mund të ftojë anëtarët e CONT dhe kryetarin e këtij komiteti. “Sigurisht që ata mund të marrin raportin pak a shumë në të njëjtën kohë dhe të dy komitetet mund të zhvillojnë një diskutim, edhe nëse komiteti i specializuar mund të shqetësohet më shumë nga tema e një raporti specifik. Në fakt, nëse i hidhni një vështrim të kujdesshëm raporteve tona specifike, nuk është shumë e vështirë të bëhet një përzgjedhje. Prandaj, unë përshëndes vendimin e CONT për të vijuar në këtë drejtim. Ne gjithashtu publikojmë edhe raporte të tjera që merren më shumë me aspekte të pastra të performancës, të cilat me siguri kanë më shumë interes për komitetet e specializuara sesa për CONT”- nënvizon Presidenti i ECA.

Sa i përket marrëdhënieve me Këshillin, Presidenti i ECA konsideron se ka ende shumë punë për të bërë. Z. Lehne shton se: “Kemi bërë një përparim të vogël, por ende nuk mjafton në këndvështrimin tim. Kur bëhet fjalë për kontakt me të, Këshilli ndonjëherë është pak kompleks”. Ai thekson se çdo vit ai paraqet raportin vjetor të ECA në Këshillin për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (ECOFIN). "Por diskutimi mbi raportet tona të performancës janë të rralla. Megjithëse ka raste kur kjo ndodh, siç ishte rasti kur u paraqit në ECOFIN raporti i veçantë 3/2018 për procedurën e çekuilibrit makroekonomik, në një takim ministror". Klaus-Heiner Lehne gjykon se duhet të zhvillohen më tej marrëdhëniet me Këshillin. “Duhet kohë dhe një presidencë mbështetëse e Këshillit. Më duhet të them se bashkëpunimi me Presidencën finlandeze dhe veçanërisht me ministrin Tuppurainen ka qenë i shkëlqyeshëm edhe përsa i përket përmbajtjes”- nënvizon z. Lehne.

T'i shërbesh palëve të ndryshme të interesit të ECA me produkte të ndryshme në formate të ndryshme

Ju duhet vetëm një vështrim në faqen web të ECA për të parë që në vitet e fundit publikimet e ECA janë bërë më të larmishme se kurrë më parë. Në to përfshihen botimi i raporteve të përputhshmërisë dhe të performancës, publikimi i opinioneve, publikimi i raporteve informuese, etj. Kjo përzierje më e gjerë në botim nuk është krijuar vetëm për të nxitur "oreksin" e lexuesve. Klaus-Heiner Lehne shpjegon se faktorët e jashtëm gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm. "Një arsye kryesore është se auditimi klasik i performancës kërkon shumë kohë. Në të njëjtën kohë, Rregullorja Financiare e BE-së parashikon në parim që një auditim i tillë të bëhet në 13 muaj. Ndonjëherë na duhet më shumë kohë se kaq, kjo për arsye që janë jashtë kontrollit tonë". Ai jep një shembull: ECA mund të përballet me kufizime për të aksesuar të dhëna ose vonesa nga subjekti që auditohet. "Por nganjëherë palët e interesuara thjesht kërkojnë nga ne që të ofrojmë produkte brenda një afati më të shkurtër kohor dhe të japin informacione, edhe nëse ato bazohen në rezultatet e auditimeve të mëparshëm. Pra, kërkojnë informacion ose përmbledhje të konsoliduar në vend të produkteve reale të auditimit. Për palët institucionale të interesit, si dhe mediat është nganjëherë e vështirë të bëhet dallimi midis produkteve që publikon ECA. A është ky një raport auditimi që ka ndjekur procedura të caktuara, duke përfshirë një procedurë observacioni nga subjekti i audituar, apo është diçka tjetër?"- shprehet z. Lehne

Ai mendon se ECA duhet të gjejë një mënyrë për të përshkruar këtë dallim dhe ta bëjë më të qartë për palët e interesuara se çfarë është secili produkt dhe çfarë pune është bërë për të. "Ne po punojmë për ta përmirësuar këtë përmes Komitetit tonë të Kontrollit të Cilësisë së Auditimit, duke marrë në konsideratë edhe konkluzionet e peer review që kam cituar më parë"- u shpreh presidenti i ECA.

Të kesh njohuri mbi faktet ... dhe të veprosh duke u bazuar tek ato.

Kur flet për ambiciet e ECA për të ardhmen, Klaus-Heiner Lehne beson se institucionet moderne të auditimit përpiqen qartazi të gjejnë dhe sigurojnë mënyra që veprimtaria e tyre të përbëjë vlerë të shtuar për palët e interesit dhe qytetarët. Ai shprehet se: "Në të shkuarën ECA etiketohej ndonjëherë "ndërgjegja financiare" e taksapaguesit të BE-së. Së fundmi ne jemi etiketuar si "roje rregullatore". Unë mendoj se të dy etiketimet na përshtaten". Ai

shpjegon se ECA është dukshëm një mbikëqyrës financiar, si mbrojtësi i interesave financiare të BE-së. "Kur kryejmë auditimet tona të performancës, sigurisht që shpesh përqendroheni në aspektet rregullatore"- nënvizon z. Lehne. Sipas mendimit të tij, kjo është e nevojshme pasi palët institucionale të interesit të ECA-s, por edhe vetë qytetarët këtë presin nga ECA. "Natyrisht që kjo pikëpamje nuk përqafohet nga të gjithë partnerët tanë, por nga shumë prej tyre. Për shembull, kur flasim me përfaqësues të Parlamentit Evropian, ose parlamentarë të parlamenteve në shtetet anëtare konstatojmë që puna jonë vlerësohet lart dhe pozitivisht"- shprehet z. Lehne.

Një thirrje për hartimin e politikave të bazuara në prova.

Presidenti ECA ka një dëshirë të cilën do të donte t'ja u bënte me dije vendimmarrësve në peizazhin e ri politik të BE-së. "Në këto kohë, kur ka një bollëk informacioni që qarkullon, ata thjesht duhet të jenë të kujdesshëm. Ata nuk duhet të ndjekin trendet politike; ata nuk duhet të ndjekin tendencat që janë thjesht të rëndësishme sepse janë prezente nëmedia. Ata duhet të veprojnë bazuar në prova të forta. Unë mendoj se ne, si auditues i jashtëm i Unionit mund t'i mbështesim ata duke ofruar informacion të bazuar në fakte dhe analiza kuptimplote"- nënvizon z. Lehne. Ai thekson se përqendrimi tek faktet dhe marrja e vendimeve bazuar në analiza të thelluara, shpesh mund të kërkojë kohë. "Prandaj, në vend që të nxitoheni, shpesh është më mirë të keni një proces legjislativ më të gjatë dhe të mendoni më thellë për vendimet që do të merrni. Kjo është ajo që do të prisja dhe sigurisht shpresoj që ata do ta bëjnë"- konkludon Presidenti i ECA, z. Lehne.

Përktheu: Alma Shehu, Audituese e pare, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Gaston Moonen, *Publikuar në "ECA Journal", nr.4/2019*

Intervistë me Presidentin e ECA, Z. Klaus-Heiner Lehne

FALEMINDERIT INTOSAI!

Shkrim i Kryetarit të KLSH-së, dedikuar Kongresit të XXIII-$^{\text{-}\ddot{e}}$ të INTOSAI-t,

Botuar *në gazetën "Sot", në 5 tetor 2019 dhe në Kosovë në "Koha.net"*

Nga: Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së

Në 24 shtator 2019, institucioni më i lartë i auditimit publik të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) u pranua anëtare me të drejta të plota e INTOSAI-t, organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit. Një sukses i merituar për zyrën më të re të auditimit publik në botë, me vetëm 15 vjet jetë. Gjatë kongresit INCOSAI XXIII mbajtur në Moskë, Bordi Drejtues i INTOSAI-t e miratoi këtë anëtarësim me shumicë votash.

Pavarësisht nga progresi i spikatur i ZKA-së në drejtim të dijeve në auditim, trajnimeve të shumta dhe projekteve që ajo ka zhvilluar me SAI-t partnere, integrimi i plotë i saj në gjirin e organizatës INTOSAI nuk ishte i lehtë. Anëtarësim i plotë i Kosovës në komunitetin e INTOSAI-t nuk do të mund të ishte realizuar, nëse nuk do të kishte qenë mbështetja e vendosur dhe përcaktuese e Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA-ve (GAO) dhe e Kryekontrollorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Gene L. Dodaro. Z. Dodaro, personaliteti numër një i INTOSAI-t u angazhua personalisht në Bordin Drejtues të INTOSAI-t, ku luan një rol lider në përafrimet strategjike të organizatës. Z. Dodaro, mik i madh i shqiptareve dhe i KLSH-së, është frymëzuesi dhe drejtuesi i procesit të përgatitjes dhe zbatimit të Planeve Strategjike të Zhvillimit të INTOSAI-t 2006-2010, 2011-2016 dhe 2017-2022. Ishte bindja e tij e palëkundur në vlerat dhe domosdoshmërinë e integrimit të ZKA-së si anëtar me të drejta të plota në INTOSAI. Ky kontribut ishte përcaktues në suksesin e SAI-t kosovar. SAI i Serbisë votoi kundër dhe brenda në Bordin drejtues të organizatës ishte kundër edhe SAI i Rusisë, që merrte presidencën e INTOSAI-t. Ndërkohë, anëtarë të tjerë të Bordit si Austria, Polonia, etj ishin në mbështetje.

Duhet theksuar se vendimi i Bordit për anëtarësimin e SAI-t kosovar ishte shprehje e një emancipimi të fortë të INTOSAI-t, e cila me 192 vende anëtare është organizata profesionale më e madhe nën ombrellën e OKB-së.

Një kontribut të veçantë dha zj. Margit Kraker, Sekretare e Përgjithshme e INTOSAI-t dhe Presidente e Gjykatës së Auditimit të Austrisë, ndër SAI-t më me peshë, eksperiencë dhe të zhvilluara, por njëkohësisht edhe me traditë në auditim.

Ndërkohë, SAI-t kosovar i erdhën në krah shumë partnerë të fuqishëm të tjerë. Një rol ndihmues me shumë vlera dha Zyra e Auditimit Shtetëror të Polonisë (NIK), njëherazi dhe partner i KLSH-së në këto vite. Ne kemi zbatuar një projekt binjakëzimi të Bashkimit Evropian me NIK-un polak, ndërsa ZKA e Kosovës ka një marrëveshje premtuese bashkëpunimi me polakët. Mbi këto baza dhe mbi eksperiencën e grumbulluar, besimi dhe vlerësimi i palës polake ndaj ZKA është i veçantë. Në Moskë, kontributi i Zv. Presidentit të NIK, z. Wojciech Kutyla (ish-drejtues i Projektit të Binjakëzimit IPA 2013 për KLSH-në (në vitet 2016-2018), në mbështetje të anëtarësimit të plotë të ZKA, u tregua shumë i vlefshëm. Argumentet e tij ishin me peshë dhe në kohën e duhur. Një përkrahje të vyer dha edhe SAI i Suedisë, ndër SAI-t më të zhvilluar dhe aktivë në komunitetin e INTOSAI-t, me të cilin Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës e lidh një periudhë e gjatë bashkëpunimi të suksesshëm 2011-2019, si dhe SAI i Kroacisë, me President z. Ivan Klesiç. Ndër vite, SAI-n e Kosovës e kanë mbështetur miqtë e Kosovës dhe të KLSH-së, si ish-Presidentët e NIK-ut polak Jacez Jezierski dhe Krzysztof Kwiatkowski, Presidenti i SAI-t bullgar Tzvetan Tzvetkov, Presidenti i SAI-t të Malit të Zi Milan Daboviç, ish-Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe ish-Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t Dr. Jozef Moser, ish-President i Gjykatës Evropiane të Audituesve Dr. Vitor Caldeira, ish-Presidenti i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë dhe Eurodeputet Dr. Igos Sholtes, ish-Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive Prof. Dr. Rejai Akyel, Kryetari në detyrë i SAI-t të Maqedonisë së Veriut Naser Ademi, Drejtori i Planifikimit Strategjik në GAO, James Blockwood dhe dhjetëra e dhjetëra personalitete të tjerë.

Suksesi i SAI-t kosovar nuk është i rastësishëm. Ai është ngjizur përgjatë viteve të vështira të krijimit dhe rritjes së tij. Kjo arritje erdhi dhe si rezultat i punës me vlerë të trupës audituese të ZKA-së, të udhëhequr

nga Audituesi i Përgjithshëm, z. Besnik Osmani, në drejtim te reformimit të thellë të institucionit, njohjes së standardeve ndërkombëtare të fushës ISSAI-ve dhe aplikimit të tyre në praktikë, sidomos në auditimet financiare dhe të performancës. Një reformim i filluar nga një personalitet i auditimit suprem publik ndërkombëtar, z. Lars Lafe Olofsson, ish Këshilltar i Lartë i SIGMA-s (programi "Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim", i financuar nga BE dhe OECD), i cili e drejtoi Zyrën në Kosovë që nga viti 2009 i themelimit të saj dhe deri në vitin 2015.

Zoti Olofsson ka ndihmuar me dijet e tij dhe kontribuar në thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit KLSH-ZKA. Atij i dedikohet raporti i zgjeruar i bashkëpunimit që ZKA ka me një partner shumë të vlefshëm dhe të zhvilluar, Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë.

Anëtarësimi me të drejta të plota i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, i cili bëhet efektiv në 1 janar 2020, përbën pa dyshim jo vetëm suksesin më të madh në historinë e auditimit të jashtëm publik të Shtetit të Kosovës, por edhe një arritje në fushatën e madhe të njohjes së institucioneve të Kosovës nga partnerët ndërkombëtarë. Ne si KLSH jemi krenarë për suksesin e sivëllait tonë në auditim, për të cilin jemi përpjekur të kontribuojmë modestisht. Marrëveshja me Zyrën e Auditimit të Kosovës ishte marrëveshja e parë ndërkombëtare që kam lidhur në shkurt të vitit 2012. Për mua personalisht ngelet marrëveshja më e veçantë dhe emocionuese.

Këto shtatë vite e gjysëm kanë parë organizimin (nga të dyja institucionet tona) të dhjetëra seminareve, konferencave, tryezave dhe takimeve të përbashkëta të punës. Gjithçka është siguruar mbi bazat e një vullneti të fortë dhe të sinqertë bashkëpunues nga të dyja palët. Me SAI-n e Kosovës, audituesit tanë kanë shkëmbyer eksperiencat në auditim. Kemi kryer auditime të përbashkëta të performancës, me nismën tonë ose në kuadrin e nismave të grupeve të punës të EUROSAI-t. Kemi botuar libra së bashku, zhvilluar analiza të përbashkëta pune, si dhe shkëmbyer manuale dhe udhëzues të ndryshëm në shqip për standardet ndërkombëtare të auditimit suprem ISSAI.

Me këtë rast, në emër të audituesve shqiptarë, dua të falënderoj garantët e integrimit të SAI-t të Kosovës në familjen e institucioneve të auditimit suprem të botës, INTOSAI-t. Në radhë

të parë, Zyrën e Llogaridhënies Qeveritare (GAO) dhe drejtuesin e saj, Kontrollorin e Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Gene L. Dodaro, Sekretaren e Përgjithshme të INTOSAI-t Margit Kraker, Gjykatën Evropiane të Audituesve, NIK-un polak, SAI-n e Kroacisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Ju faleminderit dhe gjithmonë mirënjohës!

Këta garantë përbëjnë edhe një garanci për zhvillimin e qëndrueshëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në të ardhmen, drejt shndërrimit në një SAI modern evropian. Rrugëtimi ynë me ZKA-në është i përbashkët. Ndajmë të njëjtat misione, vlera dhe synime për të ardhmen e institucioneve tona në familjen e SAI-ve të Bashkimit Evropian, në përpjekje të vazhdueshme për t'í ofruar qytetarëve tanë vlerë të shtuar në administrimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të parave të tyre si taksapagues.

Ne do të vazhdojmë me auditime të përbashkëta në shumë fusha, pasi dy-tre projekte të iniciuara kanë ecur mirë.

Ky anëtarësim merr një vlerë të veçantë dhe përbën shembull reformimi dhe lobimi për institucionet e tjera të Shtetit kosovar, në përpjekjet e tyre për integrimin evropian të Kosovës, në një kohë kur për fat të keq, institucionet serbe lobojnë fort kundër.

Qershia mbi tortë! Ky anëtarësim me votim pothuajse unanim të SAI-ve pjesëmarrëse u përfundua në Moskë, në Kongresin e XXIII-të INTOSAI-t. Faleminderit INTOSAI dhe Dodaro!

Nga: Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË KOSOVËS

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), si Institucion Suprem i Auditimit (ISA) kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 05/L-055.

Historiku

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm[1] u themelua nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në nëntor të vitit 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), emëroi Auditorin e parë të Përgjithshëm të Kosovës, Inga-Britt Ahlenius. Atëkohë, sapo ishin krijuar institucionet e para të përkohshme të Kosovës dhe udhëhiqeshin bashkërisht nga zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë.

Duke qenë njëri prej institucioneve më të rëndësishme në vend, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm u udhëhoq për më shumë se 10 vjet nga një auditor ndërkombëtar, që në zbatimin e mandatit mbështetej nga personeli vendor.

Në vitin 2006, UNMIK-u e emëroi Auditor të Përgjithshëm, Linda Casella-n. Më pas, në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm (AP) u integrua në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht u miratua Ligji nr. 03/L-075 për " Themelimin e Zyrës së

[1] *Me Ligjin 05/L-055 për AP-in dhe ZKA-në, institucioni u riemërua "Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)".*

Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës".

Në vitin 2009, Lage Olofsson, u emërua si Auditori i tretë i Përgjithshëm i Kosovës. Ai u emërua nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (njëkohësisht Përfaqësues Civil Ndërkombëtar dhe udhëheqës i Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë).

Auditori i parë i Përgjithshëm Kosovar, Besnik Osmani u emërua në mars të vitit 2016 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me nominimin e Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, pas një procesi të hapur dhe konkurrues. Vetëm pak muaj më vonë, në qershor të vitit 2016, Kuvendi shpalli Ligjin e ri nr. 05/L-055 për AP-në dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke zëvendësuar kështu ligjin e vjetër. Me këtë aktivitet përmbylli procesin e kosovarizimit të institucionit dhe kompletimit të kornizës ligjore.

Mandati

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Auditorin e Përgjithshëm (AP)[2] si institucionin më të lartë të kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës, i cili ushtron funksionet në bazë të ligjit, duke qenë i pavarur në aspektin funksional, financiar dhe operacional në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të tij.

Zyra Kombëtare e Auditimit i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve. ZKA-ja, kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Kosovës, të organizatave buxhetore dhe të Ndërmarrjeve publike, si dhe auditime të performancës.

Auditori i Përgjithshëm dhe ZKA-ja ushtrojnë mandatin në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

ZKA-ja është e pajisur me të gjitha aktet e brendshme, doracakët dhe letrat e punës për auditimet financiare, të pajtueshmërisë, të përformancës dhe të auditimeve në

[2] *Për qëllime të këtij publikimi, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).*

fushën e Teknologjisë dhe Informacionit.

Vizioni, misioni dhe vlerat e ZKA-së

VIZIONI

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve

MISIONI

Përmes auditimeve cilësore fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare

Vlerat e ZKA-së

PAVARËSIA

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

PROFESIONALIZMI

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të INTOSAI-t dhe nga praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

Orientimet strategjike të ZKA-së

Duke qenë e vëmendshme për zhvillimet dhe sfidat e së ardhmes dhe me qëllim të përmbushjes së misionit e ambicieve institucionale, Zyra Kombëtare e Auditimit ka hartuar Planin Strategjik 2018-2021. Plani paraqet një mënyrë të re, më të avancuar të punës, e cila është më e qartë në qëllimet dhe objektivat strategjike, më e integruar dhe i ofron mundësinë ZKA-së që t'i përgjigjet pritjeve të palëve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Kompetenca profesionale

Pasuria kryesore e Zyrës Kombëtare të Auditimit janë burimet njerëzore. Qëllimi kryesor në konceptin e menaxhmentit është forcimi i qasjes korporative dhe investimi në zhvillimin e kompetencës profesionale të personelit.

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë gjithë këtyre viteve ka bërë përpjekje maksimale për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve ekzistues, dhe prurje të resurseve të reja, përmes politikës së rekrutimit të bazuar në meritë.

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore mbetet një ndër prioritetet kryesore të ZKA-së, pasi që me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuohet në cilësi më të mirë, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës. Fokusi i ZKA-së në vazhdimësi është i drejtuar në edukimin e vazhdueshëm profesional (EVP), ku përmes trajnimeve të brendshme dhe atyre të jashtme synohet të zhvillohen njohuritë dhe kompetenca e secilit punonjës në ZKA.

Aktualisht, ZKA–ja nga 170 të punësuar, numëron 141 auditorë, prej të cilëve 54% janë të licencuar në nivelin më të lartë Auditor Senior, 27% janë në nivelin Auditor dhe 19% janë Auditor Junior. Në këtë numër përfshihen auditorët e rregullsisë me 75%, auditorët e performancës dhe të TI-së me 18% dhe pjesa tjetër e përkrahjes profesionale në auditim me 7%. Në planin afatgjatë, ZKA-ja synon të zgjerojë gamën e trajnimeve të ofruara, pasi që me rastin e anëtarësimit në INTOSAI janë shtuar mundësitë e përfitimeve nga trajnimet më specifike dhe të specializuara, në bashkëpunim me institucionet simotra të auditimit.

Diskutimi me stafin për Planin Strategjik 2018 -2021, Puna në grupe, Konferenca Vjetore e ZKA-së, tetor 2019 korrik 2018

- Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës harton dhe dorëzon në Kuvend dhe te subjektet e audituara mbi 100 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performances
- Numri i auditimeve të rregullsisë është rritur për rreth 25% në krahasim me sezonin audites 2015/16
- Janë trefishuar auditimet e performancës në kra- hasim me vitin 2016
- Auditimi i Ndërmarrjeve publike (NP) ka filluar në sezonin audites 2016/17 me 4 NP.
- Numri i auditi- meve të NP-ve është trefishuar në sezonin auditees 2019/2020







Konferenca ndërkombëtare dhe shënimi i 15-të vjetorit të ZKA-së

Prishtinë, Kosovë (tetor 2018) - Me 4 tetor 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka shënuar 15-të vjetorin e themelimit si Institucion Su- prem i Auditimit i Republikës së Kosovës. Me këtë rast, nga 1 deri me 5 tetor 2018 janë organizuar një sërë aktivitetesh me tematikë të zhvillimit pro- fesional, humanitar dhe festiv. Aktiviteti kryesor dhe më i rëndësishëm ishte konferenca ndërkombëtare "Roli dhe ndikimi i Institucioneve Supreme të Auditimit në rikthimin e besimit të publikut në sektorin publik".

Pjesëmarrësit e Konferencës ndërkombëtare, tetor 2018.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë nga EUROSAI, Gjykata Evropiane e Auditorëve, ISA-të të Turqisë, Çekisë, Suedisë, Polonisë, Bullgarisë, Uellsit, Kroacisë, Arabisë Saudite, Malit të Zi, Shqipërisë, Maqedonisë. Po ashtu, pjesëmarrës në këtë konferencë ishin edhe përfaqësues nga SIGMA, si dhe zyrtarë të lartë nga Kuvendi dhe institucione tjera publike nga vendi. Konferenca ka zhvilluar punimet në dy panele me theks në "Ndikimin e auditimit të performancës për qeverisje më të mirë" dhe se "Si SAI-të duhet të demonstrojnë relevancë të vazhdueshme për shoqërinë, duke kryer auditime të bazuara në rrezik". Folës kryesor në konferencë ishin Gene Dodaro, Auditor i Përgjithshëm i SHBA-ve dhe Rimantas Šadžius, anëtar i Gjykatës Evropiane të Auditimit.

BASHKËPUNIMI BILATERAL

Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare te Auditimit të Suedisë, të Turqisë, të Çekisë, të Uellsit, të Shqipërisë e të Maqedonisë Veriore. Marrëveshjet kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave institucionale dhe e ndihmojnë ZKA-në për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale në zhvillimin e aktiviteteve specifike si: Auditime të Performancës; Auditime të Rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë); Menaxhim të Burimeve Njerëzore; Komunikim dhe Planifikim Strategjik.

Më poshtë janë të ilustruara me fotografi Marrëveshjet e Bashkëpunimit me ISA-të.

1. *Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Suedisë në Prishtinë: Zv/AP i Suedisë, Magnus Lindell dhe A-iP i Kosovës, Besnik Osmani, gusht 2017.*

2. *Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Çekisë: Milosllav Kala, AP-i i Çekisë dhe i Kosovës, prill 2019.*

3 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Auditimit të Uellsit (Britani e Madhe): Huë Vaughan Thomas, AP-i Besnik Osmani, AP i Kosovës, maj 2017.

4. Nënshkrimi i Protokolit të Bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë. Kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj dhe Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, Prishtinë, nëntor 2016.

5. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren e Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.. Në fotografi, Naser

Ademi, u.d. i Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, Prishtinë, shkurt 2019

6 & 7 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Turqisë: Seyit Ahmet Baş, President i Institucionit Suprem të Auditimit të Turqisë dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, prill 2018.

Procesi i anëtarësimit të ZKA-së në INTOSAI

Procesit të anëtarësimit të ZKA-së në INTOSAI, siç u theksua më lart, i paraprinë një mori aktivitetesh, arritjesh profesionale, bashkë-punimesh e projektesh të shënuara për më shumë së një dekadë e gjysmë. Pas një procesi të gjatë promovues në arenën ndërkombëtare, më 8 maj të vitit 2018 Zyra Kombëtare e Auditimit aplikoi për anëtarësim në INTOSAI.

Kërkesa u ekzaminua nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe më pas u paraqit në Bordin Drejtues të kësaj organizate gjatë takimit të 71-të, të mbajtur në 15 dhe 16 nëntor 2018 në Moskë të Rusisë. Pas shqyrtimit të aplikimit, Bordi Drejtues vendosi të shtyjë vendimin ndaj kërkesës së ZKA-së deri në Takimin e 72, i cili ishte planifikuar të mbahej në shtator 2019, sërish në Moskë. Shtyrja, siç u konstatua nga bordi u bë për të siguruar informata shtesë rreth aplikimit të ZKA-së.

Gati një vit më vonë, Bordi Drejtues i INTOSAI-t, në Mbledhjen e 72-të të Bordit Drejtues, i cili u mbajt me 23 dhe 24 shtator mori vendim për pranimin e Zyres Kombëtare të Auditimit në INTOSAI, me të drejta të plota. Një ditë pas, për vendimin e Bordit u informua edhe Kongresi i 23-të i INTOSAI-t, i cili u mbajt poashtu në Moskë. Gjatë këtij Kongresi, ISA i Federatës Ruse mori kryesimin e INTOSAI-t deri në Kongresin e 24-të, që pritet të mbahet pas tri vjetësh në Brazil.

Pas anëtarësimit, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani e njoftoi zyrtarisht Presidentin dhe Kryeministrin e Kosovës për vendimin dhe një ditë më vonë përmes një konference për media edhe publikun kosovar.

Lajmi për anëtarësim u përcoll me telegrame urimi nga shumë Institucione Supreme të Auditimit e organizata tjera ndërkombëtare dhe nga misionet diplomatike në Republikën e Kosovës, të cilat u dërguan në adresë të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Aplikimi për anëtarësim në INTOSAI

Republika e Kosovës
Zyra Kombëtare e Auditimit

Përkthim jozyrtar i Letrës për aplikim

This
is to certify
that

the
Supreme Audit Institution
of the
Republic of Kosovo

is a **Full Member** of the

International Organization of
Supreme Audit Institutions
(INTOSAI)

Valid from 2020

Dr. Margit Kraker
Secretary General

January 2020

INTOSAI

International Organisation of Supreme Audit Institutions
Dampfschiffstrasse 2, 1030 Vienna
www.intosai.org

Rëndësia dhe përfitimet e ZKA-së nga anëtarësimi në INTOSAI

Të qenit anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INOSAI), në veçanti nënkupton të jesh në gjendje që të përfitosh nga vlerat ndërkombëtare, duke shkëmbyer përvoja nga praktikat e globale për të zhvilluar auditimin e sektorit publik.

Aktivitetet e INTOSAI-t janë të përqëndruara në forcimin e aftësive të anëtarëve të saj dhe ofrimin e përfitimeve për Institucionet Supreme të Auditimit (ISA). Për më tepër, pjesëmarrja e Zyrës Kombëtare të Auditimit drejtpërdrejt në organet,

komitetet dhe grupet e INTOSAI-t, duke përfshirë aktivitetet trajnuese, nënkupton gjithashtu njohjen e standardeve, udhëzimeve, praktikave dhe kornizave profesionale e etike

Anëtarësimi në INTOSAI është gjithashtu një parakusht për anëtarësim në EUROSAI, një organizatë evropiane rajonale e auditimit, që përbëhet nga të gjitha ISA-t e vendeve evropiane, përveç Kosovës.

ZKA-ja mund të përfitojë drejtpërdrejt nga shumë programe të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, të cilat synojnë ndërtimin e kapaciteteve, luftën kundër korrupsionit, forcimin e bashkëpunimit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve, aplikimin e sistemeve të IT-së në aktivitetet e auditimit, etj. Të qenit anëtar i INTOSAI-t do të ndihmojë gjithashtu rreth bashkëpunimintme ISA-të e vendeve fqinje. Gjithashtu, do të ndihmojë në intensifikimin e bashkëpunimit me Isa-t e vendeve fqinje.

Për më tepër, duke qenë anëtare e organizatave të mësipërme, Zyra Kombëtare e Auditimit mund të përfitojë edhe nga programet e Gjykatës Evropiane të Auditorëve (ECA). Nga praktika e deritanishme, në rastet kur ZKA-ja ka përfituar nga ato programe, ka qenë thjesht nga vullneti i mirë i shprehur nga Presidenti i ECA-s, që të përfshijë personelin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në programet e saj.

Duke qenë se përfitimet janë të shumta e të gjithanshme, përfundimisht mund të themi se me anëtarësimin në INTOSAI për Zyrën Kombëtare të Auditimit është hapur një kapitull i ri.

REALITETI SHQIPTAR I TRANZICIONIT NË FOKUSIN E MENDIMTARËVE AMERIKANË

(Mendim alternativ)

”Asnjë vend nuk mund t’i japë vetvetes një të kaluar të re. Por ai mund të ndryshojë të ardhmen dhe të mbështesë shanset për t’u zhvilluar në një demokraci liberale”.

Nga: Prof.Asoc.Dr.Përparim KABO[1]

Realiteti shqiptar i tranzicionit me të gjitha problematikat e tij është i tillë që nuk i ka shpëtuar edhe analizave apo nxjerrjes së përfundimeve direkte dhe jo të tilla nga autorë të shquar amerikan, si analisti politik dhe personaliteti mediatik Fareed Zakaria; nobelisti Joseph Stiglitz, miliarderi filantropist George Soros, apo filozofi dhe sociologu, Stephen R.Covey, etj.

Gjithmonë më ka joshur mendimi alternativ i mendimtarëve amerikan, ndaj në këtë kumtim përmes referimeve dhe analizës për problematika si demokracia dhe raportet e saj me ekonominë, keqkuptimet në lidhje me demokracinë si dhe sjellja e njeriut që të jetë efektiv apo se si dhe me ç’mjete mund të ndërtohet sinergjia; do të vijnë në kërë parashtresë me këta argumente. Libri i Fareed Zakarias i titulluar: “E ardhmja e lirisë” është i përkthyer në shqip dhe unë prej vitesh ua rekomandoj studentëve që t’a studjojnë atë.

Po hyj në zemër të çështjes së demokracisë sipas fokusit të Fareed Zakarias. Më parapëlqen ta citoj Zakarian kur shkruan***: ”Asnjë vend nuk mund t’i japë vetvetes një të kaluar të re. Por ai mund të ndryshojë të ardhmen dhe të mbështesë shanset për t’u zhvilluar në një demokraci liberale.”***[2] E kaluara

[1] Dekan i Fakultetit të shkencave sociopsikologjike&politike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, me një përvojë po thuaj 40 vjeçare në arsim. Autor tekstesh dhe monografish, i shkolluar për filozofi dhe specializuar në antropologjinë sociale dhe atë sociopsikologjike.

[2] Fareed Zakaria, “E ardhmja e Lirisë”, botimi shqip, enti botues, Instituti dialogut dhe komunikimit, faqe 65.

shqiptare së paku në tre sisteme përmblidhet në: Periudhën e komunizmit, në Mbretërin dhe Periudhën Osmane. E përbashkëta e tyre është se janë sisteme totalitare, pra mungon demokracia institucionale si sistem politik, si kulturë antropologjike dhe antropo-institucionale. Tipar tjetër që e ka përshkruar historinë e shqipërisë si një fill i zi është varfëria. A mund të ndërtohet një e ardhme demokratike qoftë kjo edhe liberale në një vend të varfër? Kjo është pyetja që unë shtroj. Përgjigjet do ti gjej te Fareed Zakaria. "Shpjegimi më i thjeshtë për suksesin politik të një demokracie të re bazohet në suksesin e saj ekonomik, apo për të qënë më të saktë, në nivelin më të lartë të të ardhurave për frymë."-kumton Zakaria. Demokracia përmes ligjit, detyra që shtroi në hyrje të viteve 90-të Komisioni i Venecias për ish vendet komuniste mund të shpjerë tek Shteti Ligjor vetëm nëse ndërtohet një ekonomi funksionale. Vetë komunizmi prandaj ra sepse ai i varfëroi njerëzit, i ndau nga prona dhe i demotivoi nga interesi, si edhe mëton një tjetër autor amerikan Henry Kissiner në librin e tij Diplomacia. Më thjeshtë, po e formuloj pyetjen, a mund të ndërtohet demokracia në Shqipëri nëse shumica e popullit është e varfër? Një tjetër filozofe hebre-amerikane Hannah Arendt ka nënvizuar, se varfëria masive e shëndron komunitetin njerërzor në shoqëri të nevojës dhe si e tillë ajo është një shoqëri parapolitike, jo se nuk do të jetë politike, por se nuk mundet. Zbatimi ligjit dhe korrektesa ndaj kërkesave të tij kërkon edhe një gjendje të mirë ekonomike. Zakaria në parashtrimin e argumentit ***"se demokracia dhe varfëria përjashtojnë njëra tjetrën,"*** i referohet një nga mendjeve amerikane më të bukura të sociologjisë Seymur Martin Lipset, duke nënvizuar përfundimin e tij të mprehtë kur shkruan ***"Sa më i zhvilluar të jetë një vend, aq më të shumta janë shanset që ai ka për ta pranuar demokracinë."***[3]

Mbi bazën e këtyre arsyetimeve do doja të tërhiqja vemendjen se demokracia në vendin tonë duhe të rregullohet duke ndryshuar gjendjen ekonomike. *Polarizimi i skajshëm në të ardhura, dëmtimi i pasurisë kombëtare, pronës publike dhe asaj private individuale, janë rrethana negative që pengojnë për ndërtimin dhe zhvillimin e një*

[3] Seymour Martin Lipset, "Some Social Requisites of Democracy: Economic Development and Political Legitimacy,' *American Political Science Review (Mars 1959)*

demokracie funksionale. Ka metoda sasiore që e masin raportin mes të ardhurave ekonomik dhe qëndrueshmërisë së demokracisë. Është kryer një studim nga dy profesorë amerikan, Adam Przeworski & Fernando Limongi, për të gjithë vendet e Botës nga viti 1950 deri në vitin 1990. Rezultatet janë këto, përmend Zakaria në librin e tij; "Në një vend demokratik që kishte të ardhura për frymë nën 1500 dollarë, regjimi i tij (demokratik kuptohet, shënimi im PK) zgjaste rreth tetë vjet. Me të ardhura 1500 deri në 3000 dollarë ai mund të mbijetonte për rreth tetëmbëdhjetë vjet. Me mbi 6000 dollarë ai bëhej tepër i qëndrueshëm."[4] Janë tridhjetë e dy regjime politike demokratike, me të ardhura vjetore rreth 9000 usd për frymë, që së bashku kanë një jetëgjatësi 736 vjetësh. Asnjë prej tyre nuk ka dështuar. Në të kundërt, nga 69 demokracitë më të varfëra, 39 syresh dështuan, me një nivel falimentimi prej 56%. Mendimtari amerikan, ky njohës i mirë i globalizmit Fareed Zakaria e cakton shumën 6000 dollarë të ardhura për frymë si një stek që duhet kaluar nëse pretendon se do të kesh një demokraci të qëndrueshme. Ja si shprehet ai në librin e tij, e citoj:" Midis vendeve të Europës Lindore pas 1989-ës, ato vende që kishin një nivel të ardhurash që shkonin në krye të kësaj amplitude, si Polonia, Republika Çeke, Hungaria i konsoliduan demokracitë e tyre me shpejtësi. ***Ato vende që janë në fund të kësaj amplitude apo edhe poshtë saj si Rumania e Shqipëria iu duhet shumë më tepër kohë.***

Le ti drejtohemi tani analizës dhe shifrave që ofron Banka Botrore për Shqipërinë. E citoj:" Shifrat e fundit zyrtare të varfërisë datojnë në vitin 2012, kur numri i të varfërve ishte 39.1% me të ardhura 5.5 dollarë për person në ditë. Që atëherë, parashikimet me ndryshimet e kryera sollën një rënie të vazhdueshme të varfërisë, deri në 31% në vitin 2017. Rritja 9% e pagave minimale që u zhvillua në vitin 2017 mund të ketë

[4] Ky studim është kryer nga dy profesorë të shquar amerikanë, Adam Przeworski & Fernando Limongi.
Adam Przeworski (ka lindur më 5 maj 1940) është një profesor polako-amerikan i shkencave politike. Një nga teoricienët dhe analistët më të rëndësishëm të shoqërive demokratike. Ai aktualisht është profesor në Departamentin e Politikave të Familjes në Universitetin e Nju Jorkut. Fernando de Magalhães Papaterra Limongi është profesor i Shkencave Politike në Universitetin e São Paulo. Ai ka shërbyer si kryetar i Departamentit të Shkencave Politike në Universitetin e São Paulo nga 2010-2014, dhe është gjithashtu ish presidenti i Qendrës Braziliane për Analizë dhe Planifikim (CEBRAP). Ai ka një doktoraturë në shkenca politike nga Universiteti i Çikagos, ka qenë profesor vizitues në Universitetin Yale nga 2008-2009,

patur një efekt të paqartë mbi varfërinë, po të mbajmë në vemendje reduktimin e numrit të vendeve të punës të krijuara si dhe rritjen e pagave të atyre që tashmë janë në punë."[5] "Pas vitit 2008 referon BB, rritja mesatare u përgjysmua dhe në sektorët publikë dhe të jashtëm ndaj u krijuan zhbalancime makro-ekonomike. Ritmi i rritjes u pasqyrua tek varfëria dhe papunësia. Ndërmjet viteve 2002 dhe 2008, varfëria në vend u përgjysmua (në rreth 12.4%) por në vitin 2012 u rrit sërish deri në 14.3 %. Papunësia u rrit nga 12.5 % në vitin 2008 në 17.3 % në tremujorin e dytë të vitit 2015 ku papunësia e të rinjve arriti 34.2 %. Ritmet e rritjes mbi 3% gjatë vitit 2011 u moderuan gjatë 2012 dhe 2013, duke reflektuar në këtë mënyrë situatën e përkeqësuar në Eurozonë si dhe situatën e vështirë të sektorit energjetik. Rritja vazhdoi deri në 2.1 % në 2014, kryesisht për shkak të rritjes në konsum dhe investimeve private. Pritej një rikuperim në vitin 2015, por gjithsesi, rritja pritej të mbetej nën potencialin e vendit në planin afatmesëm."[6] ***"Banka Botërore, jep shifra alarmante për sa i përket varfërisë në vendin tonë. Sipas statistikave të fundit të bankës Botërore, Shqipëria renditet në vendin e fundit në rajon për sa i përket nivelit të varfërisë. Në raportin e BB-së, rreth 2 mijë e 300 shqiptarë jetojnë me 1.9 dollarë në ditë, ndërsa mbi 181 mijë të tjerë që përbëjnë 6.3 për qind të popullsisë jetojnë me 5 dollarë në ditë. Nisur nga ky raport Shqipëria renditet, pas Serbisë, Maqedonisë, Bosnjës dhe Kosovës, për sa i përket varfërisë në vend.*** Gjithashtu BB ngre dhe një tjetër shqetësim të madh, ku numri i personave në varfëri ekstreme mbetet ende shumë i lartë, madje ka tendenca rritjeje gjatë viteve të fundit. Në raportin e BB-së, thuhet se Shqipëria ka numërin më të lartë të personave që jetojnë me 5 dollarë në ditë edhe se Serbia, Maqedonia e Bosnja. Kosova paraqitet më mirë se Shqipëria pasi përqindja e popullsisë që jeton në varfëri ekstreme është më e ulët se në vendin tonë, vetëm 0.2% të totalit të popullsisë.Por gjithashtu BB hedh poshtë dhe shifrat për rritjen ekonomike të publikuara nga qeveria shqiptare. Sipas raportit të BB-së, rritja ekonomike e Shqipërisë u forcua në 3.4% në 2016 dhe parashikohej të ishte mesatarisht 3.5% gjatë vitit 2017-19."[7] Le të

[5]/www.monitor.al/varfëria-ekstreme-bb-shqipëria-në përmirësim-tirana-ka-pabarazië-të-madhe-në-popullatë/

[6]https://www.worldbank.org/sq/country/albania/overview

[7]http://banka-boterore-jep-alarmin-shqiperia-vendi-më-i-varfer-në-rajon-ja-me-sa-dollarë-jetojnë-shqiptarët/

shohim tani shifrat e INSTAT-it për të ardhurat dhe polarizimin "in extremis" në Shqipëri. E citoj:"INSTAT raporton konsumin e familjeve të ndara, 10 përqindëshi më i pasur i popullsisë në njërën anë dhe 90 përqindëshi i mbetur. Sipas këtyre të dhënave, 10 përqindëshi i pasur rezulton se është bërë ndjeshëm më i pasur. Konsumi mesatar i tyre ishte 138,700 lekë në muaj në 2015-tën dhe u rrit në 158,946 lekë më 2016. Kjo është një rritje mbresëlënëse prej 14.5%. Problemi është se kjo rritje e konsumit të 10 përqindëshit të pasur erdhi në kurriz të pjesës tjetër të popullsisë. Sipas INSTAT, 90 për qind e familjeve pati një konsum mesatar prej 63,600 lekësh në vitin 2016, me një rritje minimale nga konsumi 63,200 lekë që ishte më 2015. Rritja e konsumit të 90 përqindëshit të varfër më 2016 në terma të lekut ishte vetëm 0.6%. Kjo është më e ulët se sa norma e inflacionit. Në terma real, konsumi i 2016 për pjesën dërrmuese të Shqipërisë ishte më i ulët se sa më 2015." [8]

Bazuar tek shifrat si të ardhura për frymë, ithtarët që duan të tregojnë se Shqipëria e ka kaluar gjendjen e emergjencës dhe shpërfaq një ekonomi të qedrueshme dhe një shoqëri demokratike stabile, mund të sjellin si argument shifrat e FMN në lidhje me të ardhurat.

Statistikat e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të përditësuara në "Pasqyrën Ekonomike Globale tetor 2019" tregojnë se të ardhurat për frymë të pritshme të shqiptarëve ishin 5,732 dollarë për vitin 2019, duke na pozicionuar në vendin e 102 në botë nga 192 shtete gjithsej, në nivele të ngjashme me Irakun, Paraguajin, Libanin, Libinë etj. Pra shifra 5,732 $ duket si afër shifrës 6000 $ që caktonte Fareed Zakaria në hyrje të tranzicionit si kusht për një demokraci të qëndrueshme. Nuk duhet të manipulohemi nga këto të dhëna. Le të shohim më nga afër shifrat e FMN.

Në Europë jemi ndër vendet me të ardhurat për frymë më të ulëtat dhe na e kalojnë në renditje vetëm Kosova (4,442 dollarë për frymë, në vend të 111) dhe shtete të ish Bashkimit Sovjetik si Ukrania (vendi 125), Moldavia (128). ***Të dhënat e FMN-së referojnë se edhe një dekadë më parë, Shqipëria ishte e pandryshuar po në vendin e 102,*** një tregues ky që flet se rritja ekonomike e vendit nuk ka arritur të jetë më e lartë se e fqinjëve, apo se ajo nuk ka prodhuar mirëqenie për

[8] https://www.reporter.al/thellohet-pabarazia-ekonomike-90-e-familjeve-regjistrojnë-rënie-konsumi/

qytetarët e saj. Nga vendet e rajonit, më të pasur janë fqinjët e Malit të Zi, me të ardhura për frymë prej 8,703 dollarë, ose 62% më të larta se të shqiptarëve (vendi 72). Më pas vjen Serbia, në vend të 87 me 7,398 dollarë për frymë, Maqedonia e Veritu (6,096 dollarë në vend të 95), Bosnja 5742$ (vendi 97). Sot, vendet e Bashkimit Europian kanë të ardhura mesatare për frymë në vit prej 35.8 mijë dollarë, ose gati 7 herë më të larta sesa të shqiptarëve, sipas shifrave të FMN. Institucionet ndërkombëtare ulën parashikimin për rritjen ekonomike. Shpresat për të pasur më shumë të ardhura janë zbehur, pasi të gjitha institucionet ndërkombëtare kanë ulur parashikimet për rritjen ekonomike të vendit në 2019-n.FMN pret që vendi të rritet mesatarisht me 3%, sipas "***Pasqyrës Ekonomike Globale të tetorit,***" nga 3.7% që ishte pritshmëria në prill, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) pret që Shqipëria të rritet me 2.8 % këtë vit, duke e rishikuar me ulje prej 1.1 pikë përqindje në krahasim me raportin e muajit maj. Banka Botërore e pret zgjerimin e ekonomisë në 2.9% për këtë vit."[9] Gjendja ekonomike e familjeve shqiptare dhe individit duhet parë edhe në një këndvështrim tjetër, me qëlim që të kemi një pasqyrë reale të saj. Nuk mjafton GDP apo shifrat e të ardhurave për frymë që dalin nga një përllogaritje e thjeshtë matematikore. Ekonomia duhet analizuar në tërësinë e saj. Si edhe mëtonte Joseph Stiglitz kur i referohej krizës së Argjentinës, një rritje ekonomike kur borxhi jashtëm rritet, është e paqëndrueshme. Rritja ekonomike e bashkëshoqëruar me borxhin është e paqëndrueshme dhe shpesh sjell risqe, sepse mosshlyerja në kohë bën që asete të mëdha të ekonomisë të humbin. Ato shkojnë për të shlyer borxhin fal atij procesi që George Soros, në librin e tij "Kriza e Kapitalizmit Global" – e quan rirreshtimi i tregjeve. Le ti qasemi këtij problemi me lupën e nobelistit Stiglitz. Ja si shprehet ai: ***"GDP është një masë e dobishme e rritjes ekonomike, por nuk është gjithçka dhe fundi i gjithë zhvillimit… Rritja duhet të jetë e qëndueshme. Ju mund ta rritni GDP-në duke grabitur mjedisin, duke varfëruar burimet e pakta natyrore, duke marrë hua nga jashtë - por kjo lloj rritje nuk është e qëndrueshme … Megjithatë, për shkak se GDP është masë që llogaritet relativisht lehtë, ajo është bërë një fiksim i ekonomisteve.Telashi me këtë është se çfarë ne masim është për çfarë ne***

[9] https://lapsi.al/2019/11/11/fmn-shqiperia-e-102-a-në-botë-për -të-ardhurat-për-frymë-në-2019

përpiqemi."[10] Ka raste që vërtetë rritja e GDP-së shpie edhe në uljen e varfërisë, ky është rasti i disa vendeve të Azisë Lindore.Kjo ka ndodhur jo rastësisht. Qeveritë atje hartuan politika sociale për të qenë të sigurta që edhe të varfërit mernin nga ndarja e përfitimeve. Rasti tjetër është kur megjithëse duket se GDP rritet ajo bashkëshoqërohet me rritjen e varfërisë dhe disa herë madje, shoqërohet me uljen e të ardhurave për individ që ju takojnë shtresave të mesme. ***Ka disa tregues që shfuqizojnë shifrat që mund të sillen për të ardhurat për frymë si argument i rritjes ekonomike të një vendi. Të tillë janë niveli i arsimimit dhe përmirësimi i tij si edhe niveli i shërbimit shëndetësor. Cilësia e jetës në zonat e varfra dhe ato rurale që tu afrohet jetës në qytete pa dëmtuar vlerat e tyre tradicionale.***

Paraja në vetvete nuk prodhon liri"[11]-shprehet Fareed Zakaria.

Nëse në mënyrë iluzive mendojmë se moderniteti i blerë me para si psh, makina luksoze, dyqane moderne, restorante apo resorte, dhe nuk shohim varfërinë, që manifestohet në të ardhurat për frymë, ato realet, në defictin buxhetor, borxhin e jashtëm, salton negative në tregëtinë e jashtme, nivelin e ulët të arsimit dhe cilësinë e tij e cila lë shumë për të dëshiruar, shërbimin shëndetësor të prapambetur, transportin publik arkaik, pensionet tejet të ulta, strehimin e popullësisë me problem deri me shtresa "homeless," cilësinë e ushqimit jashtë kontrollit, zhvillimin urban kaotik, mosmbrojtjen e natyrës, administrimin e pasurive nën dhe mbitoksore jo në interesin e publiku, dhe shumë aspekte të tjerë me problem, si financat pubike, moskthimi kredive, privatizmin e të gjithë tregut bankar, atëhere në mënyrë të gabuar, Ti mendon se vendi po zhvillohet dhe nuk ndalesh të propagandosh se demokracia po funskionon. Ti gënjen kur thua se jeta e shoqërisë dhe individit është më e lumtur, si edhe deklaroi një ish ministër i financave në Shqipëri, kur tha se "lumturia ishte rritur në Shqipëri me 11%". Profesor Zakaria tërheq vemendjen edhe për sjelljen ndaj pasurive kombëtare si edhe janë burimet natyrore. Ka vende që janë të bekuar nga natyra por nuk janë të zhvilluar madje atje ka varfëri deri në nivele ekstreme për shtresa të ndryshme të shoqërisë. Si ka edhe raste kur në vende që janë të varfër në pasuri natyrore por qeveritë atje që të shtojnë fondet publike nxisin zhvillimin. ***Nuk është paradoksal***

[10] Joseph Stiglitz, "Making GLOBALIZATION WORK", page 45.Penguin Books.
[11] Libri i cituar faqe 70. Fareed Zakaria, "E ardhmja e Lirisë".

përfundimi i studjuesit Zaharia se; "Pasuria në burime natyrore pengon si modernizimin politik, ashtu edhe rritjen ekonomike.". Duket sikur ka parasysh edhe Shqipërinë në këtë përfundim; e cila ka krom, bakër, naftë, bitum, ujëra, eco-sisteme, minerale të rralla dhe reliev të pasur, fusha në ultësirën bregdetare dhe kodra të cilat ofrojnë mundësi për agrokulturën, por ka edhe varfëri. Madje paradoksalisht, atje ku ka krom ka varfëri, atje ku ka naftë ka papunësi dhe pasiguri për jetën. ***"Dy ekonomistë të universitetit të Harvardit, Jeffrey D.Sachs dhe Andrew M. Waner, vëzhguan nëntëdhjetëeshtatë vende në zhvillim përgjatë dy dekadave (1971-1989) dhe mbërritën në përfundmin se dështimi ekonomik është i lidhur ngushtësisht me dhuratat e natyrës. Mesatarisht, sa më i pasur të ishte vendi në bujqësi, në rezerva minerare dhe në naftë, aq më e ngadalshme është rritja ekonomike."***[12] Këtë problematikë në lidhje më pasuritë varfërinë dhe sjellejn e politikës e analizon edhe filozofi dhe manjati-filantropist, George Soros. Ai i referohet termit që njihet si "Mallkimi i burimeve" dhe që do të thotë se vendet e pasura me burime natyrore kanë si mallkim qeveritë e korruptuara."[13] Një nga OJF-të më të njohura Global Witness formuloi sloganin provokues, "Botojeni atë që paguani". "Ideja-mëton, Sorosi ishte që kompanitë e naftës dhe kompanitë e minierave të detyroheshin të nxirrnin në shesh pagesat që u bënin qeverive të ndryshme. Pastaj shumat mund të mblidheshin dhe populli mund t'u kërkonte llogari qeverive për paratë që kishin marrë."[14] Qeveria britanike krijoi ***"Nismën për Transparencë të Industrive Nxjerrëse, e cila bashkoi qeveri, kompani dhe shoqërinë civile në një përpjekje për të vendosur standarde ndërkombëtare transparencë që do të zbatoheshin si ndaj kompanive, ashtu edhe ndaj qeverive."*** [15] Si përfundim konkludon në lektrimin e tij George Soros;"…Menaxherët e kompanive ndërkombëtare të naftës dhe minierave përfaqësojnë për bukuri interesat e kompanive. Ato kanë arritur aq larg sa t'u japin rushfete qeverive për të marrë koncensione. Dhënësit dhe marrësit e ryshfeteve me dëshirë përbëjnë *rrënjën e mallkimit të burimeve*."[16] Kjo situatë është tipike edhe në Shqipërinë e Tranzicionit. Mineralet, nafta dhe

[12] Freed Zakaria, libri i cituar, faqe 72.

[13] George Soros, "Leksionet në Universitetin e Europës Qëndrore", botimi shqip, faqe 88-89.
[14] George Soros, libri i cituar, faqe 89.
[15] Po aty, faqe 89.
[16] Po aty, faqe 90.

ujërat janë dhënë me koncensione, por publiku i gjërë nuk ka informacion të nevojshëm se çka ndodhur, dhe është fakt që me kompanitë e huaja ka pasur goxha problematika të cilat ashtu si aisbergu janë marrë vesh në një pjesë të tyre vetëm kur kanë plasur skandale apo ka pasur protesta nga punëtorët e këtyre sektorëve ose nga operatorë të shoqërisë civile. Pjesa e errët (e zhytur nën ujë) nuk është mësuar. ***Shqipëria vend i pasur dhe i varfër, "i bekuar me pasuri mbi dhe nëntoksore" dhe i mallkuar me varfëri të skajshme.*** "Shqiptarët gëzojnë pasuri natyrore për frymë më shumë se çdo vend i rajonit, madje më shumë se vendet me standarde të larta jetese të tilla si Gjermania, Franca , Zvicra, Italia etj, por dobësitë njerëzore në menaxhimin e tyre e kanë bërë vlerën e pasurive të pashfrytëzueshme"- vë në dukje në një analizë të saj revista me profil ekonomik, e përmuajshmja "Monitor"[17] Pse? Le t'i adresohemi një studimi të Bankës Botrore të vitit 2018, të cilit i referohet kjo revistë. "Banka Botërore mati pasurinë e kombeve më 2018 dhe gjeti se shqiptarët kanë pasuri natyrore rreth 13,375 dollarë për frymë, nivel më i lartë se shumica e vendeve të Ballkanit. Madje shqiptarët gëzojnë më shumë pasuri të natyrës se grekët (12,546 USD) dhe turqit (12,854USD). Edhe italianët kanë me pak pasuri natyrore për frymë se shqiptarët, me vetëm 8,619 USD, dhe gjermanët gjithashtu, me vetëm 7071 USD. "[18]…"Gati dy të tretat e vendeve që

[17] https://www.monitor.al/paradoksi-kemi-nivelin-të-lartë-të-burimeve-natyrore-për-frymë-por-të-ardhurat-të-ulëta/?fbclid=IwAR2rIVV8xuB4vGJf16QrQ6RUMZDULUxUHxxXge7qe-rY5fbp9

[18] Revista "Monitor," WEDNESDAY/6 NOVEMBER 2019. *"Tek kapitali natyror Banka Botërore ka klasifikuar energjinë me (naftë, gaz, qymyri i fortë dhe i butë), mineralet (10 kategori), toka bujqësore (toka bujqësore dhe kullota), pyjet (druri dhe disa produkte pyjore jo të zeza), dhe zonat e mbrojtura tokësore. Aktualisht nuk janë përfshirë zonat e mbrojtura nga zonat detare.Burimet natyre janë një mallkim i hershëm që ka zënë njerëzimin, pasi vendet me pasuri natyrore janë edhe më të varfrat. Ndërkohë që Shqipëria ka nivelin më të lartë të pasurive natyrore për frymë ka të ardhurat disafish më të ulëta për banorë se vendet në fjalë. Por gjithsesi niveli i zhvillimit ekonomik të një vendi është i lidhur fort me përbërjen e pasurisë së saj kombëtare. Kapitali natyror është komponenti më i madh i pasurisë në vendet me të ardhura të ulëta (47 për qind në 2014).Të pasuruarit nuk ka të bëjë me likuidimin e kapitalit natyror për të ndërtuar pasuri të tjera. Rritja vjen nga përdorimi efikas i kapitalit natyror dhe investimi i të ardhurave nga burimet natyrore të kapitalit, si mineralet, në infrastrukturë dhe arsim. Ky investim pastaj rezulton në rritjen e pasurisë totale, referon me tej Banka Botërore.Burimet e ripërtëritshme, toka bujqësore, pyjet dhe zonat e mbrojtura mund të sjellin përfitime në përjetësi nëse menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, vlera monetare e aseteve të ripërtëritshme gati është dyfishuar në një dekadë, duke mbajtur konstant numrin e popullsisë. Në kontrast me burimet e ripërtëritshme, kapitali natyror siç janë lëndët*

kanë mbetur me të ardhura të ulëta që nga viti 1995 klasifikohen si shtete të pasura me burime natyrore, të cilat janë plot me konflikte dhe demokraci të pazhvilluar dhe nivel të ulët jetese. Kjo tregon se vetëm burimet nuk mund të garantojnë zhvillimin. *Banka Botërore këshillon se nevojiten institucione të forta dhe qeverisje e mirë për të siguruar përfitime të larta nga pasuritë natyrore."*[19]



Është fakt që qeveritë shqiptare gjatë tranzicionit nuk i janë bashkuar nismës së qeverisë britanike për transparencë, dhe as që do të ishin në një mendje me mendimtarët amerikanë në lidhje me shtrimin dhe asryetimin për këto çështje që, nuk janë thjesht ekonomike por që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, me proceset politike dhe me demokracinë liberale. ***"Qeveritë me thesare nën tokë, shkruan Fareed Zakaria, e fitojnë pasurinë fare lehtë. Ato janë shtete 'fond-mledhëse' (trust fund states). Pasurohen nga të ardhurat e mineraleve apo të shitjes së naftës dhe nuk u duhet aspak t'i përvishen punës për të ndërmarrë detyrën mjaft të vështirë të krijimit të kornizës ligjore dhe të institucioneve që gjenerojnë pasurinë kombëtare."***[20]

Në vendin tonë kemi për gati tre dekada një sjellje as kombëtare dhe as civile ndaj pasurive minerare e natyrore. Ato ose u janë dhënë kompanive të huaja shpesh krejt anonime që vetëm kanë grabitur, ose është punuar në mënyrë okulte me njerëz të biznesit vendas të cilët nga asgjëja janë shëndruar në pasunor të frikshëm. Kushti primordial i demokracisë liberale," *marrëveshja reciproke–mes taksimit dhe përfaqësimit"* nuk është zbatuar në realitetin e vendit tonë. Përkundrazi, herë hapur dhe më së shumti tinëz, është vepruar si edhe thotë Zakaria për qeveritë jo demokratike***: "Cilado qeveri që i mbledh të ardhurat e saj pa hedhur rrënjë në shoqëri, ajo nuk është shtet po veç një oborr dhe***

djegëse fosile dhe mineralet ofrojnë shanse të fragmentuara dhe të shtrira në një periudhë kohore."

[19] https://www.monitor.al/paradoksi-kemi-nivelin-të-lartë-të-burimeve-natyrore-për-frymë-por-të-ardhurat-të-ulëta/?fbclid=IwAR2rIVV8xuB4vGJf16QrQ6RUMZDULUxUHxxXge7qe-rY5fbp9R

[20] Fareed Zakaria, libri i cituar, faqe 72.

biznesmenët e saj nuk janë sipërmarrës por oborrtarë."[21]

Kam vite që jam i familjarizuar me librat e nobelistit amerikan Joseph Stiglitz, ua kam përcjellë dhe studentëve aq sa ata munden. Do dëshiroja të sjellë idetë e tij për keqkuptimet me tranzicionin në ish vendet komuniste, bazuar në librin e hershëm të autorit titulluar:"Making Globalization Work"(Duke e bërë Globalizmi të punojë, e kam studjuar sa doli në qarkullim.) Ja si shprehet ai për privatizimet dhe për terapin chock, që për dreq i dëgjuam dhe i provuam edhe në Shqipëri me një herë sa regjimi komunist ra, në hyrje të viteve 1990-të. E citoj***: "Shumë besuan, në mënyrë të gabuar, se "Terapia Chock" ishte e nevojshme, se tranzicioni në kapitalizmin të stilit perëndimor do të vendosej brenda natës përmes një privatizmi dhe liberalizimi të shpejtë."*** [22]

Cilat kanë qenë pasojat e këtij nxitimi?

Ekonomisti Stigltitz këshilltari për ekonominë i ish presidentit amerikan Bill Clinton, argumenton se kjo politikë solli disa pasoja të rënda që ndjehen në një kohë relativisht të gjatë edhe në Shqipëri. Liberalizimi i menjëhershëm i çmimeve solli me vete parashikimin e hiperinflacionit. Dhe dihet që çdo shfleftësim i monedhës ul fuqinë blerëse për konsumatorët dhe lë gjurmë dhe në sistemin bankar e monetar. Krijohet një ngushtim në politikat monetare e cila shprehet në nivelin e lartë të interesit bankar, në kushtet me një mundësi të vogël të kreditimit si dhe në ashpërsinë fiskale për shkak të një buxheti të shtrënguar që duke sjell një inflacion galopant dhe duke e rrëzuar ekonominë e cila rrëshqet në recesion dhe depresion. Edhe në vendin tonë kjo panoramë u krijua, një bazë materiale e gjerë e shtrirë në të gjithë vendin që nga industria nxjerëse përpunese dhe ajo e lehtë, si dhe mjetet e transportit dolën jashtë përdorimit. Ato ose u shitën për "pesë lekë" ose gjoja u privatizuan dhe shkuan në duart e disave që kishin lidhje me qeveritarët e kohës që ndihmuan në këtë shkatërrim të ekonomisë. Në analizat e tij sa teorike po aq edhe emperike dhe statistikore mendimtari i shquar amerikan Stiglitz shkruan***: "Ndërkohë që privatizimi i shpejtë (në ish vendet e lindjes PK) ishte duke dhënë qindra miliarda dollar, asetet më të vlefshme të vendeve ishin duke krijuar një klasë të re oligarkësh të cilët nuk nguruan t'i nxirrnin paratë jashtë vendeve,***

[21] Fareed Zakaria, libri i cituar faqe 73.
[22] Joseph Stiglitz, "Making Globalization WORK," Englisht version, Penguin Books, page 37.

shumë më shpejtë se futja e miliardave të FMN-s si ndihmë në këto vende." Bazuar në këtë përfundim, unë pyes sot. Ku shkuan paratë që u fituan nga shitja e armëve dhe municioneve, mjeteve të motorrizuara dhe atyre detare, të cilët u shitën gjatë tranzicionit? Ku shkuan të ardhurat që u përfituan nga privatizimi i flotës tregëtare? Kush mban përgjegjësi për shkatrimin dhe keqtrajtimin e të gjithë bazës materiale të krijuar gjatë periudhës së komunizmit? Kush bën analiza dhe mban përgjegjësi për terapin chock të zbatuar në ekonominë shqiptare? Askush! Në debatin që u shpërtheu në BB, Stiglitz, u rreshtua nga ata që kishin rezerva për këtë lloj privatizimi. Së paku për dy arsye shprehet ai në studimin e tij. ***E para se u gjeneruan të ardhura të ulëta për qeveritë.*** *(*Lexo… Ky është dhe rasti i Shqipërisë. Vetëm një fakt, Hotel Tirana sa kishte përfunduar një rinovim që kishte kushtuar 5 milion $ dhe u privatizua për një shumë gati 3 milion $. Fabrika Birra Tirana, gjatë procesit të privatizimit të saj u shpreh si blerës birra Peroni në Itali me një shifër prej 6 milion $, në fakt me marifet ky transaksion u pengua dhe u privatizua shumë herë më lirë duke e marë nga disa aksioner shqiptar, përfshirë edhe gruan e presidentit në detyrë zotit Ilir Meta. Mos flasim këtu për PPP-të e famshme që edhe kur ju mbyllet afati si ndodhi me Terminalin e aeroportit "Nënë Tereza", pa kaluar as edhe një ditë, pa bërë një bilanc ku ishim, ku jemi çfarë dhamë e çfarë fituam, iu kalua një partneri tjetër po koncesionar***) E dyta, nënvizon prof Stiglitaz u minua besimi në ekonominë e tregut.*** I gjithë procesi privatizimit u bë në kushtet e një kuadri ligjor ose të mangët ose të brishtë dhe në jo pak raste në mungesë të tij. Joseph Stiglitz, hapur godet kur shkruan: ***"Pa ligjet e duhura, në lidhje me qeverisjen e korporatave, është e mundur vjedhja masive e aseteve nga administratorët e tyre (si edhe ndodhi në Shqipëri,drejtorët vodhën ndërmarrjet), pra ka më shumë stimuj për të xhvatur pasuritë, se sa për t'i shtuar ato. Unë, shprehet mendimtari amerikan u shqetësova gjithashtu për pabarazinë e madhe që mund të krijonin këto privatizime."***[23] Edhe realiteti shqiptar i tillë është. Kontratat që firmosen nga ekzekutivi ynë janë të pakonsultuara, pa sisteme të tillë që të mbrojnë pasuritë tona kombëtare, si dhe të paraprijnë në rastet e vështira nëse shkohet në gjykatë apo në arbitrazh ndërkombëtar kur gjendesh në mosmarrëveshje që nuk zgjidhen dot me mirëkuptim mes

[23] Joseph Stiglitz, libri i cituar faqe38

palëve. Rasti tipik ishte me CEZ-in. Pa shkuar në arbitrazh ndërkombëtar u pagua në dorë për prishje kontrate një goxha shumë e majme. Këtë lloj kapitalizmi që u krijua në ish-vendet e Lindjes Komuniste, në librin e tij me titull: "Kriza e Kapitalizmit Global" George Soros, e quan "Kapitalizmi Grabitqar". Ish drejtorët apo menaxherët e ndërmarjeve dhe fabrikave, minierave apo qendrave të prodhimit, u shëndruan në pronarët e tyre, madje si edhe e shtyn më tej përfundimin e tij, autori: Ata nuk druhen të shprehen se e kanë bërë këtë pasuri me korrupsion, ose si edhe flitet rëndom në realitetin shqiptar, me marifet apo allishverish. ***Kulmi në Shqipëri është kur maksima e drejtuesëve në punët e shtetit në të gjitha nivelet dhe llojet e detyrave është KÇK (kap çfarë të kapësh), një mentalitet tipik orientalist ky i periudhës së sundimit Osman. Xhvat dhe mbathja!***

Po çfarë ndodh me këto privatizime, kur vala e presionit popullor rritet. Privati nuk ndjenë siguri, trembet dhe për fatin e atyre investimeve që mund të ketë bërë. Në këto kushte ka shumë nga ata që pjesën më të madhe të fitimeve e nxjerrin jashtë vendit, ku e drejta e pronës dhe siguria është më e lartë. Kjo ndodh me të gjitha bankat në Shqipëri të cilat përmes privatizimit blenë bankat shqiptare, dhe fitimet e tyre në pjesën dërrmues ikin jashtë Shqipërisë, pa çka që rezervat e tyre në monedhë janë paratë e qytetarëve shqiptar.

"Liberalizimi i tregut të kapitalit, mëton Stiglitz-e shtyu FMN-n t'i bënte me keq gjërat, sepse fondi monetar ua bëri më të lehtë oligarkëve që kishin asete të xhvatura nga korporatat të cilat ata i kontrollonin, që t'i merrnin paratë e tyre për t'i shpënë në bankat offshore, në vendet ku të drejtat e pronës së tyre ishin më të sigurta dhe të vendosura atje tashmë. Ata përfituan, fal kuadrit ligjor i cili ishte i dobët në vendet e tyre, dhe i shpunë paratë në vendet ku mbrojtja e pronave ishte më e sigurt." [24] Në ish vendet e lindjes ndodhën dy fenomene që dëmtuan zhvillimin. ***U rrit varfëria në mënyrë masive si edhe u prish një traditë e mirë e arsimimit që kishte në këta vende sepse shumë specialistë dhe profesorë u larguan si dhe fondet për zhvillimin e një arsimi modern mungonin.*** Të ardhurat e qeverive ranë, shpezimet për infrastrukturën dhe shëndetësinë, konludon Stiglitz, erdhën në rënie. Mjafton të shohim përqindjen që i takon arsimit dhe shëndetësisë në Shqipëri që të

[24] Libri i cituar faqe 39.

kuptosh se Stiglitz flet edhe për realitetin shqiptar të trazicionit. Është i saktë përfundimi i Stiglitzit. ***"Rezultatet ishin të zymta…" Kontrasti mes pretendimeve të avokatëve të tregut të cilët parashikonin çlirim të forcave të cilat do të sillnin prosperitet rekord dhe rritjes së pashoqe të varfërisë, e cila ndodhi në të vërtetë, nuk mund të ishte më i madh."***[25]

Në librin e tij "The Great Divide", (Çarja e Madhe) Joseph Stiglitz ka nënvizuar disa ide shumë të rëndësishme. Pse dhe si ndodh që të rritet pabarazia në ekonominë globale, por edhe çfarë ndodh në vendet ku mes shtresave shoqërore nuk ka politika publike por uljen e pabarazisë, shtimin e të ardhurave dhe perspektivës optimiste tek shtresat në nevojë. E citoj profesorin e preferuar." ***"Shumë nga pabarazia që vihet re në botë është e shoqëruar me kërkim të rentës (p.sh ushtrimi i pushtetit të monopoleve) dhe një pabarazi e tillë manifeston një dëmtim të eficencës ekonomike. Por ndofta dimesioni më i keq i pabarazisë është pabarazia e mundëësive,***[26] ***e cila si shkak dhe si pasjojë e pabarazisë së të ardhurave, dhe shkak i pamjaftueshmërisë ekonomike e zvoglon zhvillimin, sepse një numur i madh individësh nuk janë në gjendje të plotësojnë potencialet e tyre. Vendet me pabarazi të niveleve të larta, priren të investojnë pak në të mirat publike, të tilla si infrastruktura, teknologjia, dhe edukimi, të cilat kontribojnë për një rritje dhe prosperitet ekonomik afatgjatë. Reduktimi i pabarazisë, nga ana tjeter, ka përfitime të qarta sociale dhe ekonomike, e bën më të fortë kuptimin te njeriu se shoqëria është e drejtë, përmirëson kohezionin social dhe mobilitetin, duke e bërë atë më të mudshëm që më shumë qytetarë të jetojnë me potencialet e tyre; dhe e zgjeron mbështetjen për rritjen e iniciativës. POLITIKAT QË E DUAN RRITJEN POR E INJOROJNË PABARAZINË, në fund të fundit mund të jetë vetë-shkatruese, ndërsa politikat që ulin pabarazinë, për shembull, duke rritur punësimin dhe arsimin, kanë efekte të dobishme në kapitalin njerëzor për të cilin ekonomitë moderne kanë nevojë gjithnjë e më shumë."***[27] Joseph Stiglit ka botuar një studim të tij për pabarazinë bazuar në të dhëna për ekonominë amerikane dhe për të

[25] Joseph Stiglitz, po aty faqe 39.

[26] Këtë tezë e ka edhe sociologu anglez Anthony Giddens, në librin e tij "The third way and renewal of Social-Democracy"…Ai fomulon kështu tezën e tij. "Njerëzit duhet të jenë të barabartë në mundësinë e vetndryshimit."

[27] Joseph Stiglitz ...The Great Divide, page 288.

gjitha vendet që luajnë rol në tregun global. Analizat e tij shkojnë në përfundime shumë të rëndësishme për të gjithë realitetin në të cilin jeton shoqëria në shekullin XXI. Libri i tij titullohet: "The PRICE OF INEQUALITY" - (ÇMIMI I PABARAZISË).[28] ***Është me shumë rëndësi fakti se profesor Stiglitz e sheh pabarazinë edhe në raportet me "Rule of Law", madje në një nga kapitujt e tij ai pyet "Përse na duhet shteti ligjor"? Në analizën e tij ai shpjegon pse kjo pabarazi e rrënon shtetin ligjor dhe rolin e shtetit në kuptimin e mirfilltë të fjalës. Si devijon vendimmarrja politike dhe si braktiset interesi publik. Kjo sjellje është prenzente në realitetin vendimmarës edhe në Shqipërinë e tranzicionit si në nivel lokal dhe në nivel qëndror. Shoqëria nënvizon profesor Stiglitz drejtohet me rregulla me ligje dhe me procedura që pasqyrohen në rregullore. Por çfarë ka ndodhur realisht si pasojë e pabarazisë?***

Le ta shohim më nga afër tezën e profesorit amerikan.Ja si shkruan ai: ***"Ti përgjigjemi kësaj pyetje fundamentale, zhvillimi i shoqërisë, rregullat dhe rregulloret? Këto rregulla dhe rregullore, vijon arsyetimi i tij, së bashku kanë efekt tek efiçenca e sistemit të shpërndarjes, disa fitojnë në kurriz të të tjerëve. Ja përse pushteti 'pushteti politik' ka shumë rëndësi. Nëse pushteti ekonomik në një vend bëhet shpërndarës i pabarazisë së madhe atëherë do të kemi dhe pasoja politike. Ndërsa ne mendojmë në mënyrë tipike për "Shtetin Ligjor" i cili është dizenjuar për të mbrojtur të dobëtin kundër të fortit, qytetarin e zakonshëm kundër të privilegjuarit, ata me pasuri do duhet të përdorin pushtetin politik për ta formësuar shtetin ligjor që ai të sigurojë një kornizë brenda së cilës ata të mund të shfrytëzojnë të tjerët. Ata do të përdorin pushtet politike si të tyret, për të siguruar gjithashtu ruajtjen e pabarazisë më mirë, se sa arritjen e më shumë barazije dhe shoqërisë ekonomike të tillë. Nëse disa grupe kontrollojnë procesin politik, ata do ta përdorin atë për të formësuar një sistem ekonomik që favorizon vetëm ata, përmes ligjeve dhe rregullave që aplikohen në mënyrë specifike…që qeverisin falimentimin, konkurencën, pronësinë intelektuale, taksimin, dhe që në mënyrë indirekte edhe me***

[28] Është me shumë rëndësi të vëmë në pah se në librin e tij "The PRICE OF INEQUALITY" Stiglitz u referohet shume studimeve për këtë materie, mes tyre dhe studjuesit Thomas Piketty i cili ka botuar librin me titull;"Kapitali në shekullin XXI." Piketty vërteton se është shtuar shqetësimi në lidhje me rritjen e pabarazisë.(ky libër është përkthyer edhe në shqip)

koston që u lejon të kenë akses edhe në sitemin gjyqësor."[29]

Shkurt dhe me fjalë të tjera, Stiglitz thotë se ata që marrin pjesën më të madhe e detyrojnë shtetin ligjor që të braktisi interesin publik dhe shëndrohet me mjete ligjore në shërbim të tregut dhe zotëruesve të tij. Tek lexoj Stiglitzin, më vjen në mendje një kapitalist shqiptar më i pasuri sipas statistikave, i cili shkonte në një zyrë shteti dhe u thoshte punonjësve të saj. "Më thoni ju si e doni ligjin se ua bëj unë…!" Ka raste të panumurta në realitetin shqiptar të tranzicionit, që ligjet rregullat dhe rregulloret, procedurat, mekanizmat administrative dhe ato ligjor janë hartuar se si të pasurohen më të pasurit dhe se si të varfërohen më të varfërit.

Arsimi dhe punësimi në vitet e tranzicionit…

Gjatë periudhës së Mbretërisë dhe në sistemin totalitar u investua për arsimin, dhe nga një vend me shumicën e popullësisë analfabete u arritë që të shkonin në shkollë të gjitha shtresat e shoqërisë. U krijua një traditë e mirë e kultit të dijes, vlerësimit të intelektualit, profesionistit, shkencëtarit dhe eruditit. Shkollat ishin serioze, mësimi ishte i shenjtë dhe vlerësimet shumë rigoroze. Certifikata apo diploma që merrje, pasqyronin dijet dhe kompetencën kudo. Në perjudhën e tranzicionit kjo traditë u gërrye dhe sot jemi përball një situate fatale, aq kohë sa ka shitje note dhe diplomash. Cilësia e arsimit është shumë e ulët. Njerëzit janë ftohur me dijen dhe me librin. Kush e vrau librin? Kush i përbuz njerëzit e librit? Kush bëhet shok, ortak me hajnat, kriminelët dhe të korruptuarit? Sigurisht ai që nuk është mik me librin dhe kulturën. Hapja e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian do të duhet të kalonte nga shfletimi shoqëror i librit, jo nga analfabetizmi deri në foltoren e Kuvendit, ku sheh deputetë që nuk dinë të shkruajnë pa le më të lexojnë. Flitet me entuziazëm për Tetorin e librit...të lexuarit e librit, bëhet nami me dhe për librin, fal propagandës. Pallavra, gjendja eshte e tillë që po të shohësh shifrat tronditesh. Gënjeshtrat për librin dhe diturinë janë të modeluara, gjoja sipas kërkesave të BE-së ....Dilni shihni nëse deputetët apo ministrat, frekuentojnë bibliotekat apo blejnë libra brenda ose jashtë vendit. Ata mund të blejnë gjithçka por libra,ah ah, është herezi. Mundet ndonjëri prej tyre. Me padituri shkohet drejt tunelit të mbyllur, kjo është e sigurt.

[29] Joseph Stiglitz "The PRICE of INEQUALITY", page 238,239. W W Norton&Company, Inc.

Instituti për Matjen dhe Vlerësimin e Shëndetit në Universitetin e Uashingtonit (The Lancet) ka bërë krahasime të zhvillimit të kapitalit njerëzor në nivel global (195 vende) nga viti 1990 -2016. Studimi tregoi se Shqipëria kishte bërë regresin më të madh në Europë madje në rang global në këto 26 vite. Në vitin 1990 Shqipëria u rendit e 75 në botë për zhvillimin e kapitalit njerëzor, por në vitin 2016 ajo u rendit në vendin 91, duke humbur plot 16 pozicione në renditjen globale. Sigurisht kjo gjendje lidhet me degradimin e arsimit, largimini nga parametrat cilësor dhe sasior që karakterizojnë shoqëritë e zhvilluara.

"Modeli arsimor që kemi zgjedhur të ndjekim, ai i Finlandës, që është më efikasi në Europë, ka dështuar të ushtrohet në kushtet e Shqipërisë**.** ***Finlanda arriti në 2015 vendin e dytë në botë për njohurit e larta që 15-vjeçarët atje kanë për shkencat, matematikën dhe të lexuarit sipas Programit për Vlerësimin e Studentëve Ndërkombëtarë (PISA).*** Ndërsa Shqipëria u rendit shumë poshtë mesatares në rang botëror, duke u krahasuar me vende të Azisë dhe Afrikës, edhe pse vitet e fundit ka bërë përmirësime. Po rçfarë ka bërë Finlanda që është prijësi i arsimit në Europë? Në shtetin e vogël nordik prej rreth 5 milionë banorësh është më e vështirë të bëhesh mësues, se sa mjek, jurist apo ekonomist. Shkollat e larta të mësuesisë përzgjedhin 10 përqindëshin më të mirë të gjimnazistëve dhe kurrikulat e kanë të kombinuar në mënyrë të përsosur praktikën me teorinë. Teksa Shqipëria ëndërron Finlandën, për 29 vite rresht që kur ka rënë sistemi komunist, degët e mësuesisë ndiqen nga 20%-shi më i dobët i studentëve. Lëndët e mësuesisë ishin aq pak të zgjedhura sa prej vitesh degët e matematikës, biokimisë, jo vetëm që kanë thithur gjimnazistët e 10% më të ulët, duke u degdisur shpesh me kuota bosh. Modeli i Finlandës është një dështim, pa llogaritur faktin se Shqipëria sistematikisht gjatë tre dekadave të fundit ka financuar rreth 3% të PBB-së, teksa Finlanda modeli që ne ndjekim edhe sot e kësaj dite, jep 7% të fondeve për arsimin. Fëmijët në Finlandë nisin shkollën në moshën 7 vjeç, mësimi fillon pas orës 9. Në gjashtë vitet e para kanë vetëm një mësues dhe për më tepër shkolla nuk konceptohet si një detyrim. Gjithkush prej nesh e dimë se, Shqipëria nuk ngjan askund me modelin që ka zgjedhur."[30]

UNESCO (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Kulturë, Shkencë dhe

[30] Blerina Hoxha, Revista Monitor, https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit-3/

Arsim) së fundmi bëri një vlerësim për politikat arsimore në Shqipëri dhe gjeti se ende deri më 2017, mësimdhënia në vendin tonë ka dështuar të nxisë kreativitetin dhe aftësitë. Citoj nga përfundimet e gjetura në realitetin tonë arsimor. ***"Gjatë dekadave të fundit, shkollat duhet të ndryshonin rolin e tyre nga riprodhimi me saktësi i lëndëve drejt nxitjes së rritjes dhe zhvillimit të mendimit kritik dhe kompetencave dixhitale për pjesëmarrje në shoqërinë dhe ekonominë e Shqipërisë dhe përtej saj", – shprehen ekspertët e UNESCO-s.***[31] Sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT, numri i nxënësve që ndjekin arsimin e 9-vjeçar dhe të mesëm ra në 43 mijë e 700 nxënës në vitin 2018 nga 68 mijë e 600 nxënës që ishin në vitin 1991, ose 35% nxënës më pak. Rënia më e madhe ishte në arsimin 9-vjeçar, ku në vitin 2018, janë ulur në bankat e shkollës 260 mijë nxënës më pak nxënës se në vitin 1991. Vetëm në dy vitet e fundit, shkollën e vijuan 46 mijë fëmijë më pak. Rënia e numrit të nxënësve është shoqëruar edhe me reduktim të trupës arsimore. Në vitin 1991, numëroheshin 43.700 mësues në të gjithë vendin, ndërsa në fillim të këtij viti, numri i tyre ishte 29.000, me tkurrje 33% që nga viti i parë i tranzicionit. Gjithashtu numri i shkollave u ul me 35% që nga viti 1991. ***Shqipëria hyri në periudhën e tranzicionit me 2200 shkolla të arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm, dhe ka mbetur me 1134 shkolla.*** Afërisht, 150 shkolla u mbyllën vetëm këto dy vitet e fundit, për shkak se numri i nxënësve po bie në mënyrë të frikshme në disa qarqe të vendit. Numri i klasave është reduktuar më tej***. Nga 37 mijë klasa që ishin në fillim të viteve 1990, aktualisht janë rreth 11 mijë klasa.*** Numri i tyre është reduktuar me 70% përgjatë 28 viteve. Sipas INSTAT, ulja e numrit të nxënësve ka sjellë dhe një rënie të raportit nxënës për mësues, në 17.8 në vitin akademik 2017/2018, nga 19.1 në vitin akademik 2013/2017, për ciklin 9-vjeçar. Ministria e Arsimit pohoi se, prej vitit 2009 migrimi i brendshëm i popullatës nga fshatrat dhe qytetet e vogla drejt qendrave më të mëdha urbane, emigracioni dhe rënia e numrit të lindjes kanë bërë që shkollat në zona urbane të kenë më shumë nxënës se sa në ato rurale."[32] Kuptohet që ajo çka thotë Ministria e linjës është një justifikim. Shkaqet e kësaj gjendje janë më të thella dhe ndërfaktoriale. Pse po zbrazen shkollat, pyet revista

[31] Po aty. https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit-3/

[32] Po aty. https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit-3/

"Monitor" dhe jep këtë përgjigje që të tmeron. Rënia e numrit të nxënësve ka ardhur në proporcion të drejtë me tkurrjen e peshës së grupmoshave të reja. ***Sipas të dhënave të INSTAT, në vitin 1989, popullsia në moshën 0-14 vjeç ishte rreth 1 milion persona, ndërsa në vitin 2017, ka zbritur në vetëm rreth 522 mijë persona, pothuajse përgjysmim.*** *Pesha e popullsisë 0-14 vjeç ka zbritur në 18% të totalit, nga 32% që ishte në vitin 1989. Në të kundërt, teksa vendi ka përjetuar pas viteve '90 rënien e lindshmërisë dhe emigracionin masiv, ku janë larguar kryesisht moshat e reja, është rritur pesha e të moshuarve.* ***Popullsia mbi 65 vjeç zinte 13% të totalit në vitin 2017, nga vetëm 7.4% në vitin 2001, po sipas INSTAT. Norma e lindshmërisë ka rënë në 1.5 fëmijë për grua në fund të 2017-s nga më shumë se 5.6 fëmijë në fillim të viteve 1990***. *Kjo normë është nga më të ulëtat në Europë dhe do të thotë se nënat nuk zëvendësojnë as vetveten. Ky është një sinjal alarmues për rënie të pashmangshme të popullsisë së Shqipërisë në vitet në vijim. Ndryshimi i strukturës së popullsisë pritet të ketë efekte të rënda në një të ardhme të shpejtë, si në strukturën e forcës së punës, kërkesë-ofertën për punë (me ndikim në profilet e universiteteve) ashtu dhe në skemën e pensioneve dhe kostos për kujdesin e të moshuarve.* ***Rigjallërimi i ciklit të emigracionit është një tjetër faktor i rëndësishëm. Që nga viti 2013, rreth 157 mijë qytetarë shqiptarë kanë bërë kërkesë për azil, ku numri më i lartë ishte në 2015-n, me rreth 69 mijë persona, për të zbritur në 33 mijë persona në 2016-n dhe 26 mijë në 2017-n. Këto shifra shkruhen në Raportin Vjetor të Situatës së Azilantëve, të publikuar fillimisht nga Bashkimi Europian.Demografët e INSTAT kanë komentuar më parë se, një ndër faktorët kryesorë të rënies së lindjeve këtë vit, lidhet me emigrimin.*** Në vitin 2015, një valë emigracioni prej 67 mijë personash u regjistruan si azilantë në vendet e BE-së, një nivel rekord i viteve të fundit. ***Qendra kërkimore "PewResearch", që ka përpunuar të dhënat e Eurostat për emigracionin në vendet e BE-së në vitin 2015, tregoi se 80% e azilkërkuesve shqiptarë ishin nën 35 vjeç, moshë e cila realizon 90% të riprodhimit.*** Karakteristikë themelore e valës së emigracionit këtë herë ishte ikja e familjeve, ndryshe nga vendet aziatike ku emigrojnë kryesisht vetëm meshkujt. Azilkër-kuesit nga vende si Rusia, Serbia, Ukraina dhe Shqipëria kanë tendencë për t'u zhvendosur si familje. ***Edhe numri i aplikimeve për Lotarinë Amerikane nga shqiptarët është i***

lartë. Rreth 367 mijë shqiptarë, (apo rreth 13% e shqiptarëve) i varën shpresat e tyre tek "ëndrra amerikane" duke aplikuar për Lota-rinë Amerikane dhe duke u renditur të parët në Europë që kanë përqindjen më të lartë të popullsisë që aplikojnë për lotari. Krahasuar me vitin 2007, numri i shqiptarëve që aplikuan për Lotarinë Amerikane është dyfishuar, nga 173 mijë shqiptarë që aplikonin në 2007-n, në 2018 numri i aplikimeve kapi shifrën rekord 367 mijë, sipas statistikave të Departamentit Amerikan të Shtetit. Rritja e aplikimeve në Lotarinë Amerikane ka qenë e lartë, veçanërisht pas vitit 2013.









"UNESCO rekomandoi se Shqipëria duhet të përdorë më mirë procedurat e emërimit të mësuesve për të trajtuar pabarazitë në sistemin arsimor. Një analizë e rezultateve të PISA 2009 tregoi se nxënësit shqiptarë në zonat rurale kishin më pak të ngjarë të kishin mësues që përdornin praktika të efektshme të mësimdhënie. Për vitin shkollor 2015-2016, disa Drejtori Arsimore Rajonale, sidomos në pjesën verilindore të vendit, raportuan një numër të konsiderueshëm vendesh të lira të paplotësuara me aplikantë. UNESCO i ka kërkuar Shqipërisë që punojë për të siguruar numrin e nevojshëm dhe shpërndarjen e duhur të mësuesve, për të trajtuar çdo pabarazi në sistemin e arsimit. UNESCO paralajmëron se nuk ka zgjidhje të thjeshtë për këtë problem."[33]. Le të shohim tani se si është kurba e financimit për arsimin duke ju referuar disa shifrave dhe cila është prirja. Një arsim i përparuar dhe modern ka nevojë edhe për mbështetje financiare, nëse realisht kemi bindjen se "arsimi ndryshon veten me qëllim për t'i hapur rrugën ndryshimit të shoqërisë në tërësi."[34] Shqipëria financonte më shumë se 4-5% të PBB së saj para viteve 1990 për sektorin e arsimit, ky nivel ishte i krahasueshëm me financimet që edhe vendet e tjera të OECD jepnin në atë kohë. Por gjatë viteve të tranzicionit, sektori është financuar më pak se 3% e PBB-së, nivel gati 40% më i ulët se financimet që vendet e zhvilluara kanë dhënë në këtë periudhë dhe 20% më pak se financimet që japin vendet e rajonit. Sipas UNESCO-s Shqipëria vijon të ketë financim të ulët për arsimin në raport me PBB krahasuar me vendet

[33] https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit-3/

[34] Për më shumë, në lidhje me këtë tezë, shiko studimin me titull;"Për një arsim modern të një shoqërie që kërkon të integrohet në BE." Përparim Kabo, "Autoritarizëm në Tranzicion"- Antropologjia shqiptare përmes globalizmave, faqe 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347.

e tjera të kontinentit. Historikisht, në Shqipëri, shpenzimet e qeverisë për arsimin kanë qenë të ulëta, dhe përgjatë 15 viteve të fundit mbeten kryesisht derinën 3.5% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB). Në vitin 2007, një vit përpara krizës ekonomike financiare dhe recesionit ekonomik, përqindja përkatëse mezi arriti ne 3.2%. Pas krizës, financimet për arsimin kanë qenë sistematikisht poshtë 3% të PBB-së. Shpenzimet private/familjare për arsimin si përqindje e PPB-së kanë qenë në rritje që në 2011, dhe, duke ruajtur këtë tendencë, arriti në 0.9% në fundin e vitit 2015 dhe pak më shumë se 1% më 2017. Financimi i pamjaftueshëm i arsimit ndikon negativisht në cilësinë e shkollimit, sidomos shtresat pavaforizuara të popullsisë. ***Në vend që hendeku i financimeve në arsim të plotësohet, qeveria ka planifikuar të kundërtën, fondet do të ulen më tej gjatë tre viteve në vijim. Sipas planifikimit afatmesëm të Ministrisë së Finan-cave, shpenzimet për arsimin nga 3.1 – 3.3% e PBB-së më 2018-2019 do të zbresin në 3% në 2020 dhe 2021.*** Shqipëria u rendit e fundit në rajon për shpenzimet dedikuar arsimit gjatë vitit të kaluar. Shqipëria shpenzoi 3.1% të PBB-së për arsimin teksa vendet e tjera të rajonit ky tregues është në intervalin 4-4.5% të PBB-së. ***Të dhënat e fundit e INSTAT, për matjen e nivelit të jetesës, treguan se pesha e shpenzimeve për arsim arriti në një nivel rekord, prej 4.4% të totalit të konsumit më 2016, nga 1.7% që ishte një dekadë më parë.*** Të dhënat krahasuese nga anketat e buxhetit të familjeve të vendeve të rajonit dhe Eurostat, të përpunuara nga "Monitor", tregojnë se familjet shqiptare kanë peshën më të lartë të shpenzimeve për arsim nga vendet e rajonit dhe ato të Bashkimit Europian.Mesatarja e Bashkimit Europian është 2.1%, ndërsa një familjeje në rajon i kushton shumë më pak (në termin relativ ndaj shpenzimeve totale) që të shkollojë fëmijën. Serbia, Maqedonia, Bosnjë-Hercegovina e kanë këtë raport midis 0.6-0.7%, ndërsa në Kroaci arrin në 1.1%. Instituti i Statistikave të Kosovës raporton në anketën e fundit të buxhetit të familjeve për vitin 2016, se pesha e shpenzimeve për arsim në totalin e buxhetit është zero.[35]

[35] Të dhenat e INSTAT janë marë nga revista "Monitor". https://www.monitor.al/tranzicioni-tkurr-35-sektorin-e-arsimit-3/

Le të shohim treguesin tjetër, punësimin.

Në një shoqëri të shëndetshme me ekonomi funksionale treguesi kryesor i rritjes dhe zhvillimit është punësimi dhe kryesisht i gjeneratave të reja, pra i pjesës vitale të shoqërisë, e cila presupozohet që të këtë arsimim më të mirë se brezat e mëparshëm, të jetë ithtare e ritmit të lartë të ndryshimit si dhe të zotrojë teknologjitë e reja që kushtëzojnë ecjen e përshpejtuar të një shoqërie në veçanti; dhe të asaj globale në tërësi. Deri para viteve 90-të popullësia në Shqipëri ishte e re. Mosha mesatare ishte shumë e ulët dhe nga më të mirat në Europë dhe më gjërë. "Para viteve '90 Shqipëria kishte një moshë mesatare shumë të re, 27 vjeç duke qënë në këtë mënyrë dhe popullsia me moshë mesatare më të re në Evropë. Por vit pas viti ajo ka ndryshuar, për të ardhur në 2015 me 8 vjet rritje (pra 35 vjeç.) Plakja e popullsisë është një fenomen shqetësues në pjesën më të madhe të botës. Kjo ka rritur frikën se shumë vende nuk do të kenë kapacitete të mjaftueshëm punonjësish për të mbajtur një numër gjithnjë e në rritje të moshuarish. ***Për shkak të lindshmërisë shumë të ulët të regjistruar aktualisht në Shqipëri dhe vijimit të emigrimit të të rinjve, parashikimet janë që popullsia do të vijojë të plaket."***[36] Ja sa ka qenë popullësia në Shqipëri ndër vite, sipas statistikave zyrtare.

Viti	Mijë banorë
1923	814
1945	1122
1989	3182
2014	2884

Tabela e mësipërme tregon numurin e popullësisë në Shqipëri që nga censusi i parë i organizuar në vitin 1923.[37] Si paraqitet punësimi i të rinjëve në Shqipëri? Le ti referohemi të dhënave të ILO-Organizata Ndërkombëatre e Punës. Në bazë të një studimi që ka kryer kjo organizatë në lidhje me punësimin e të rinjëve në vendet e Europës, dhe nivelin e papunësisë; shifrat për Shqipërinë janë alarmante." Në të gjithë Europën, Shqipëria ka normën më të lartë të të rinjve të cilët nuk janë të punësuar dhe nuk po ndjekin shkollën apo ndonjë trajnim***. Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka ilustruar me një hartë se si është situata e punësimit të të rinjve në***

[36] http://www.respublica.al/2015/09/19/shqip%C3%ABria-prishet-balanca-lindje-vdekje-rritet-mosha-mesatare-e-popullsis%C3%AB-nga-27-n%C3%AB-35

[37] Ilia Telo "Moshimi, shteti dhe shoqëria". Tiranë, 2011, fq 39.

Europë me të dhënat e vitit 2018 dhe Shqipëria fatkeqësisht renditet në krye të Europës për përqindjen më të lartë të të rinjëve të pa punë, të pa arsimuar dhe të pa trajnuar, me 32.8% të totalit, duke ia kaluar edhe Moldavisë, vendit më të varfër të Europës. Papunësia e të rinjëve është një fenomen shqetësues në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, përveç Malit të Zi. Në Bosnje dhe Hercegovinë përqindja e të rinjëve të papunë ishte 26.4, ndërsa në Maqedoni dhe Serbi, përkatësisht 24.9 dhe 23.8 për qind. Në Kosovë norma e papunësisë përllogaritet rreth 30.1%. Për të rinjtë e papunë, rrugëzgjidhje mbetet emigrimi në vendet, ku norma e papunësisë së të rinjëve është shumë më e ulët. Ballkani Perëndimor, veçanërisht Shqipëria, po përjeton një valë emigrimi të grupmoshave të reja drejt vendeve të Europës Perëndimore. Norma e papunësisë së të rinjve është më e ulët në vendet e Europës Perëndimore dhe Veriore. Holanda ka përqindjen më të ulët të të rinjëve të papunë, me vetëm 4%. Pas saj renditet Norvegjia ku papunësia të të rinjtë në 2018-n ishte 4.6%.Në Gjermani, Çeki, Zvicër, Austri dhe Suedi, norma e papunësisë varon nga 6-6.5%.Në hartën mëposhtë janë ngjyrosur me ngjyrosur me blu dhe të kuqe, nga norma më e ulët e papunësisë, deri te norma më e lartë, Shqipëria.Të rinj janë cilësuar individët e moshës 15-24 vjeç.[38]

[38] https://www.monitor.al/shqiperia-thyen-rekord-në-europë-për-përqindjen-më-të-lartë-të-të-rinjve-të-papunë/



V.o Shif tabelën [39]

"Politika dhe ekonomia janë pandashmërisht të lidhura.Nga të dyja kërkohet që të frenohet rritja e diferencës midis të varfërve dhe të pasurëve, të ndërtohet një shtet më social dhe me një angazhim më serioz në përmbushjen e këtij objektivi. Qeverisja e ka për detyrë të punojë fort për të siguruar çdo të drejtë civile të qytetarëve të vet, por njëkohësisht ajo duhet të ketë njërin sy tek të drejtat ekonomike, duke theksuar jo vetëm të drejtën e pronës, por edhe luftën e vazhdueshme ndaj

[39] https://www.monitor.al/shqipëria-thyen-rekord-në-europë-për-përqindjen-më-të-lartë-të-të-rinjve-të-papunë/

pabarazisë ekonomike. Modifikimi paksa i kursit të zhvillimit të vendit drejt një shteti social, duket se është i pashmangshëm për të zbutur sa do pak kundërshtinë e dukshme ndaj reformave të ashpra që qeveritë ndërmarrin."[40]

Shoqëria duket si e kapur në kurth. Nga njëra anë që të ndryshojë gjendjen e varfërisë dhe që t'i hapi rrugë zhvillimit duhet të rrisi arsimimin dhe të ketë të garantuar punësimin, nga ana tjetër ky lloj ndryshimi kërkon investim nga familjet për arsimimin e fëmijëve dhe sigurimin e një jetese më të mirë e më dinjitoze. Me pak fjalë, duhen më shumë të ardhura për të investuar për edukimin e fëmijëve dhe ato realisht nuk janë. ***Si mund të dilet nga kjo gjendje, që Joseph Stiglitz e quan "Çmimi i Pabarazisë," në librin e tij me të njëjtin titull.*** Mungesa e të ardhurave nënvizon ai, e bën të vështirë mundësinë e familjeve për të qenë produktiv në mënyra të ndryshme. Mungesa e mundësive monetare i redukton aftësitë e tyre për të investuar për fëmijët dhe jetën e tyre. Atyre ju duhet një banesë më e mirë dhë për këtë duhet të marin kredi në bankë e cila kërkon një kolateral si garanci, përndryshe kushtet e kreditimit nuk mund të jenë të favorshme. Nëse në shoqëri shumica e popullatës është e varfër dhe në pamundësi për mbështetur edukimin e fëmijëve të tyre, atëhere problemi është mbarëshoqëror.***''Pasoja më e rëndësishme e këtij jo perfeksioni është se në këtë botë ku shumë familje kanë pak mundësi monetare ose nuk kanë hiç, dhe ku qeveritë kanë mundësi të kufizuara për të ofruar për shkollimin, atje ka një mungesë investimesh për kapitalin njerëzor."*** [41]

Në periudhën e tranzicionit në ish vendet komunsite si edhe Shqipëria, sfidë ka qenë dhe ngritja e institucioneve të reja. "Institucionet në periudhën e tranzicionit kanë një rol të dyfishtë. Nga njëra anë ato do duhej të stablizonin rregullat, në mënyrë të veçantë ato që ndikojnë në jetesën; nga ana tjetër, për të krijuar rregullat e reja të cilët janë më të përshtatshme për ekonominë e tregut. Nëse roli i parë i institucioneve është neglizhuar, ato dështuan përpara agjenteve ekonomik. Kjo gjendje i shtrëngon ato që të ndërmarin vendime afat-shkurtëra në nivel lokal. Nëse roli i dytë i institucioneve, ai që lidhet me rritjen ekonomike dhe me zhvillimin

[40] Ylli Çabiri, "Shqipëria do të bëhet", faqe 440. Shtëpia botuese "Onufri."

[41] The PRICE of INEQUALITY, Joseph E. Stiglitz page 135; W. W. Norton & Company New York London

e saj neglizhohen, atëherë sipërmarësit dhe individët nuk bëjnë dot investime apo aktivitete në kërkim të zgjerimit të ekonomisë."[42]

Mathias François Dewatripont,[43] profesor në ekonomi, kur analizon rolin e institucioneve në shoqërinë e tranzicionit shprehet. "Në terma të përgjithshëm reformimi i institucioneve përgjatë periudhës së tranzicionit, nuk ka pse të jetë "çlirimi energjive të fshehura, si edhe është implementuar në më të shumtën e rasteve në ish vendet socialiste. Më i rëndësishëm është fakti se si institucionet ndërtohen dhe përshtaten me mjedisin specifik të çdo vendi, si edhe në mënyrë plotësonjëse. ***Në rastin e trazicionit, çdo ndryshim në institucione nuk mund të jetë spontan, si partizan të terapisë chock. Institucionet do të duhet të ndërtohen me shumë kujdes në kuadrin e reformave të përgjithshme."***

Fatkeqësisht tranzicioni po stërzgjatet në Shqipëri sepse nuk udhëhiqet nga ide të qarta, nga mendim shkencor dhe nga njerëz që kanë vizione. Ai ka mbetur në duart e të njëjtëve politikanë që thjesht ndërojnë stafetën pa ditur dhe pa mundur që të ndërtonin një ekonomi dhe demokraci funksionale në këto tre dekada.

Në vend të bashkëpunimit gjatë kësaj periudhe zuri vend përjashtimi, në vend të bashkëjtesës politike hodhi rrënjë lufta e ndërsjelltë, deri në një lloj antagonizmi mes institucioneve dhe pushteteve. Nuk u konceptua dhe u drejtua procesi i tranzicionit në Shqipëri duke i inkuadruar reformat në stradegji kombëtare. Fatkeqësisht partite politike e trajtuan garën në demokraci si një ndeshje që nuk mungoi të merrte ngarkesa emotive edhe nga sfondi historik i luftës së dytë botërore dhe periudhës së komunizmit, si rrjedhojë tranzicioni demokratik mori trajtën e një lufte klasore apo ndeshje shkollash politike në duelin"komunist dhe antikomunist". Kjo qasje u ndje në ndërtimin e institucioneve, ku sipas rradhës secila parti politike që vinte në pushtet sillte atje njerëzit e saj duke përjashtuar ata që gjente***. Gëloi partitizmi politik mbi meritokracinë. Emërimet u bën mbi baza njohjesh personale, të nepotizmit familjar apo partiak, deri me ryshfet. Edhe ndryshimet e fundit duke mbushur administratën me studentë të "exelencës", ishte një gjest populist***

[42] The Great Transformation-(Eastern Europe-The collapse of socialism…The dilemas of capitalism.

[43] Mathias François Dewatripont, profesor në ekonomi, belgë, por që ka studjuar edhe në SHBA, dhe mori një Ph.D. në Universitetin e Harvardit në 1986;

që nëpërkëmbi rregullat dhe kriteret e rekrutimit në administratën publike dhe që dëmtoi jo pak ekspertizën, tingëlloi më shumë një gjest i pastër i urdhërit politik të udhëheqësit.

Nga sistemi monokratik diktatorial u kalua në një sistem me monokraci të dyfisht. Çdo parti politike që vjen në pushtet nga zgjedhjet, me çdo mjet dhe çdo kusht zotron të gjitha pushtetet dhe institucionet. Demokracia në Shqipëri në vitet e tranzicionit nuk ndërtoi dot "Political cohabitation" –Bashkëjetesën Politike. Kjo gjendje ka edhe shkaqe historike.

Në studimin tim për antropologjinë shqiptare,[44] kam mbërritur, siguristt sipas qasjes sime, në përfundimin se ne shqiptarët kemi qenë: "Historikisht të bashkuar për të lufuar dhe historikisht të ndarë për të bashkëqeverisur." Është e vështirë për të mos thënë shpesh e pamundur që ne të bashkëjetojmë dhe të bashkëverojmë me të kundërtën. Jemi refuzues dhe madje nuk ndalemi të jemi armiqësor. Pikërisht për këtë arsye në filozofinë tonë të sjelljes gjen urrejtje në vend që të takosh dorën e shtrirë, gjen shpagim në vend që të gjesh bashkëjetesë.

E kundërta, apo ajo çka është e ndryshme, tek realiteti shoqëror në Shqipëri nuk është pjesë e tërësores sinergjike. Ja përse ka kaq energji të humbur në shoqërinë shqiptare të tranzicionit. Multikulturalizmi dhe pluralizmi politik që duhet të kishin karakterizuar shoqërinë demokratike rezultuan jo të motivuar nga ana antropologjike. Edhe niveli i kreativitetit mbeti i ulët. Ne mburremi vetëm me energjinë tonë luftarake, të cilën nuk ngurojmë ta veshim edhe me kostum folkorik hera herës. Shoqëria jonë ka nevojë që të kurrohet dhe për këtë qëllim sygjeroj që t'i referohemi një autori amerikan shumë të shquar, Stephen R. Covey.[45] Në librin e tij "7 zakonet e njeriut me efektivitetin më të lartë", kur analizon njërën prej zakoneve, autori shtjellon gjërësisht ç'është sinergjia, kultura sinergjike dhe si ndërtohet ajo. Po çfarë është sinergjia? Sipas Covey, ***"Sinergjia është thelbi i përqëndrimit të principeve udhëheqëse."... "Thelbi sinergjisë është të vlerësosh të ndryshmet, t'i respektosh ato, për të ndërtuar të fortën, e të kompesosh***

[44] Shiko librin, Përparim KABO, "Autoritarizëm në Tranzicion"-Antropologjia shqiptare përmes globalizmave, Shtëpia botuese Plejad, viti i parë i botimit 2006.

[45] Stephen R.Covey," the 7 Habits of Highly Effective People". Ky është studimi që ka një impakt shumë të gjërë në publikun amerikan dhe atë botror.

të dobtit." [46] ***Le të ndalemi tani pak më gjërë për të sqaruar këtë përkufizim.***

Në punën dhe aktivitetin tonë individual dhe shoqëror nuk mund të punohet pa parime, pa drejtim dhe pa bashkëpunim. Çka na drejtojnë do të duhet të jenë principet dhe jo komandimi i individëve në varësi nga posti që ai mban. Ky është dallimi i madhë që ka realiteti ynë nga realitetet që drejtohen sipas principeve të demokracisë liberale. Në qendër tek ne është drejtuesi, udhëheqësi apo komanduesi. Një sjellje e tillë është e trashëguar nga antropologjia feudale me binomin 'Prijësi dhe Turma'. Edhe kur dëgjon të flasin drejtuesit tanë partiak apo shtetëror, ata nuk përmendin se në këtë rast apo në këto rrethana janë shkelur këto parime. Edhe në vitet e tranzicionit nuk drejtohet, por komandohet. E tillë është jeta institucionale si brenda partive politike ashtu edhe në institucionet shtetërore. ***Si sjellje, sinergjia ndërtohet vetëm nëse kupton dhe pranon, se në një shoqëri demokratike mendohet jo në mënyrë të njëjtë apo dogmatike si edhe në sistemin totalitar. Prandaj parimi thelbësor është vlerëso të ndryshmen. Realiteti shqiptar i trazincionit ka raste gati të dhunshme qoftë kjo verbale, organizative madje dhe fizike ndaj të ndryshmes edhe brenda vetë familjes politike. Si në një realitet të separatizmit feudal të ndryshimit janë nxjerrë jashtë strukturës dhe janë identifikuar si shkelës të unitetit apo edhe si tradhëtar.***[47]

Sinergjia nuk mund të krijohet nëse nuk komunikojmë, mëton Covey. Sigurisht përgjatë këtij komunikimi nuk është se jemi të sigurt për atë se si do të funskionojnë gjërat, por vetëm përmes komunikimit çlirohet ajo energji e nevojshme që na shtynë që të veprojmë se bashku, me besimin se përfudimi do jetë më i mirë se gjendja ku ndodhemi. Njerëzit që mbeten pasiv, që nuk futen në bashkëpunim, apo më keq akoma janë të ndrojtur e të trembur dhe ngurtësohen në pozita mbrojtëse, (sepse kështu mund të jenë të edukuar në familjet e tyre, apo se janë të trembur atje ku punojnë dhe militojnë, nga drejtuesit arrogant dhe hakmarrës;) pikërisht këta njerëz e kanë shumë të vështirë të hynë në një komunikim për të krijuar sinergjinë e ndryshimit. ***"Kjo gjendje-shprehet mendimtari i shquar amerikan Stephen R. Covey-përfaqëson një nga tragjeditë më të***

[46] Po aty, faqe 275.

[47] Rasti mocionistëve në Partinë Demokratike, dhe grupi Ilir Metës brenda Partisë Socialiste.

mëdha dhe më të gjëra të jetës, sepse një potencial kaq i madh mbetet i pa shfrytëzuar dhe i papërdorur." Komunikimi që pranon të ndryshmen, respekton tjetrin por respekton edhe veten. Kemi të bëjmë me A=-A, pra të barabartë si të ndryshëm. ***Ky komunikim duhet të bazohet, nënvizon Covey tek empatia, dhe jo te simpatia, e cila shpesh sillet si një kurth ku njeriu mbetet në pozitat e një investimi shpirtëror të pandryshuar. Empatia pranon të ndryshmen, dëgjon atë sipas parimi, se nuk mund të kuptohesh nga të tjerët nëse nuk ti vet nuk përpiqesh t'i kuptosh ata.*** Kur komunikojmë edhe kur kemi mendime apo opsione të ndryshme për një situat apo për një zgjidhje, si edhe shkruan Covey ndodh që ***"…pothuaj në gjysmën e fjalisë, shpesh jo koherente, ata takojnë mendimet e njëri tjetrit shumë shpejt…ide të reja të mbetura në ajër, zakonisht ato vijnë të tilla kaq të afërta, duke qenë praktike dhe të përdorshme."*** Vetëm në këto rrethana lëshohet energjia e ndryshimit dhe takohet kreativiteti, influenca reciproke për të bashkëpunuar në gjetjen e opsioneve dhe njohurive të reja.

Trishtohesh kur lexon këta argumente shkencore dhe kaq aplikative të këtij autori të shquar amerikan, dhe përball tyre vë realitetin shqiptar të trazicionit, kaq refraktar dhe abraziv. Energjia e ndarjes dhe jo ajo e bashkimit është prezente tek tranzicioni shqiptar i demokracisë. Është e kuptueshme mëton profesor Covey se ***"Ka disa rrethana në të cilat sinergjia mund të mos realizohet dhe nuk gjendet një marrëveshje. Por edhe në këto rrethana shpirti i sinqeritetit do të duhet të përpiqet që të këtë si rezultat një kompromis shumë më efektiv."*** Në shoqërinë tonë, ky çelës që quhet shpirti i sinqeritetit, më duket si një herezi, si diçka që nuk i takon këtij realiteti moral, kulturor, antropologjik dhe institucional. Nuk mund të harrohet ajo që tha ish kancelari austriak Vranincki, gjatë krizës politike shoqërore ekonomike dhe ushtarake të vitit 1997, në Shqipëri. Ai takonte brenda ditës të gjitha palët në lojën politike të asaj kohe. Gjendja ishte shumë e rëndë, tragjike me armët sheshit por edhe në këto rrethana gjuha e kompromisit nuk po gjendej. Palët përbetoheshin në sinqeritetin e tyre parcial. Në ato rrethana dëshpëruese, Zoti Vranincki u shpreh:" Atje është e vështirë të kuptosh se cili është ëngjëlli cili është djalli." ***Me sa duket ende si shoqëri ne nuk kemi dal nga inkubacioni i totalitarizmit. Në sistemin komunist, njerëzit të tjera gjëra mendonin dhe***

të tjera gjëra thonin sepse ishin nën peshën e frikës. Nëse kjo mënyrë komunikimi ende është e pranishme, kjo ndodh se ende ushtrohet pushtetit i frikës por edhe për faktin se pesha e lirisë si kulturë dhe sfida të zhvillimit nuk mbahen dot nga shoqëria shqiptare të tranzicion. Nëse ata që duhet të jenë 'public servant' "nuk u thonë zgjedhësve të tyre atë që ata janë në gjendje të bëjnë realisht, por ju thonë pasinqerisht atë që ata kanë nevojë të dëgjojnë"-vë në dukje George Soros, atëhere në këto rrethana demokracia shërben si mjetë për të ardhur në pushtet dhe pushteti si mjetë për të qëndruar në pushtet. Edhe në vendin tonë, përgjatë trazicionit nëse krahasojmë përbetimet kur forca politike është në opozitë me ato që thotë kur është në pushtet, kuptohet qartazi si "shpirti sinqeritetit" është shëndruar në "shpirtin gënjeshtar"! ***Duhet të shmanget sinergjia negative e cila është prezente nëvizon profesor Covey, "…kur njerëzit përpiqen t'i zgjidhin problemet dhe t'I marrin vendimet në një realitet ndërvarësie. Kjo sjellje është si ta ngasësh makinën duke mbajtur një këmbë te pedali i gazit dhe tjetrën tek frenat."***[48] ***Ndërvarësia si urdhër, si autoritet burokratik, si bllokim i iniciativës apo qasjes ndryshe për të gjetur një zgidhje alternative, janë sjellje tipike të një shoqërie pa liri, pa kreativitet, pa sinergji pozitive.*** Uniformiteti është shoqëria pa mendim ndryshe, pa liri, pa njerëz që kurajojnë të ndryshojnë gjendjen. Ja një rast që ka provokuar shumë diskutime kohët e fundit në vendin tonë. Kryeministri Rama mblodhi njerëz të kulturës të artit dhe të arkitekturës për t'Ju treguar modelin e godinës së re të Teatrit Kombëtar duke mos pranuar as një sygjerim, mendim ndryshe apo kundërshtim. Edhe kur ata u shprehën në forume të tjerë, ai ju kthye atyre me arrogancë pa pranuar as edhe një alternativ tjetër.[49] ***Thelbi i sinergjisë–nxjerr përfundimin mendimtari amerikan-është të vlerësojmë dallueshmërinë gjithëpersonale, kjo shtë sinergjia e të gjithëve."*** Ky është ndryshimi mes shoqërisë totalitare ku individi nuk mendonte me kokën e tij, nuk e thoshte dot mendimin e tij dhe nuk kishte kurajo që ta mbronte mendimin e vet, me shoqërinë e demokracisë liberale, ku njeriu është i lirë të mendoj me kokën e tij, është i lirë të shprehet dhe nuk ka frikë ta mbrojë mendimin hapur. Ka rëndësi

[48] Steven R. Covey, libri i cituar, faqe 287

[49] Çështja e debatuar e godinës së Teatrit Kombëtar.

të dimë atë që në mënyrë lakonike profesor Covey e formulon, e citoj: ***"Të gjithë njerëzit e shohin botën jo si ajo është por si ata janë."***[50] Të vlerësojmë të ndryshmen ky është thelbi i sinergjisë, dallimet mund të jenë mentale, emocionale dhe psikologjike mes njerëzve. Të gjitha janë të vlefshe dhe duhet të bashkohen në një të tërë. Komunikimi nuk është koformizmi, ose të bijem në një mendje formalisht, si një lloj bindje pa dinjitet. Ne na duhet mendja ndryshe. Unë dua të komunikoj me ju se sepse ju i shikoni gjerat zgjidhjet dhe realitetet ndryshe. ***Edhe kur kemi të bëjmë me forca negative, komunikimi dhe bashkëpunimi duhet sepse ato punojnë kundër rritjes dhe ndryshimit. Nëse i lëmë edhe këto forca vepruese jashtë bashkëpunimit nuk mbrijmë dot tek qëllimet që i kemi vënë vetes. Vetëm duke i përfshirë do të jetë e mundur të krijohet kultura e sinergjisë. Kur e ftojmë dikë apo një subjekt të caktuar që të përfshihet, procesi duhet të jetë real, i sinqertë nga të gjitha palët dhe kjo shprehet nëse e mbështesim atë pjesmarrje duke i dhënë të gjitha mundësitë që të jetë aktive në analizën dhe zgjidhjen e problemeve. Vetëm në këto rrethana, shkruan Covey," kreativiteti i çlruar për cilindo është edhe më i madh,po ashtu çfarë ata krijonë."***[51] Në një shoqëri pa liri, përjashtimi dhe trajtimi i tjetrit si i gabuar janë tipare normale. Ka në to një lloj paganizmi shpagues antropologjik dhe institucional. Në shoqërinë liberal demokrate ndodh e kundërta. Për zgjiidhjen e një problemi apo një situate mund të ketë më shumë se një alternativ. ***Nëse ajo që ti ke të pëlqen dhe tjetra që nuk e ke të duket e gabuar, ka sërisht një zgjidhje edhe në këto rrethana. Kërkohet një alternativ e tretë që quhet ajo e sinergjisë së zgjidhjes.*** Pra është një marërzi të jesh peng e asaj që ndodh në realitetin shqiptar të tranzicionit, ku ende vazhdon të udhëheqi sjelljen politike, parimi përjashtues, "O me mua o kundra meje".

Më pëlqen ajo që sygjeron profesor Covey, tek shkruan: ***"Ka pothuaj gjithnjë një alternativ e tretë, dhe nëse Ju punoni me filozofinë win/win-(fitoj unë fiton dhe ti) dhe kërkoni realisht t'Ju kuptojnë, ju zakonisht mund të gjeni një zgjidhje e cila do të jetë më e mirë se cilido shqetësim."*** [52]

* * *

[50] Steven R.Covey, libri cituar page 289.

[51] Po aty faqe page 295.

[52] Steven R.Covey, libri cituar faqe 296.

Kontributi i SHBA-ve në fatin historik të Shqipërisë ka qenë i gjithanshëm dhe vendimtar. Zhvillimi demokracisë liberale dhe krijimi një shoqëri të shtetit ligjor nuk mund të realizohen pa u konsultuar dhe udhëhequr nga mendimi i dijetarëve amerikan.

Nga: Prof.Asoc.Dr.Përparim KABO

NJË PAMJE MBI ELEMENTIN FUNDOR STOKASTIK DHE GJEOSTATISTIKËN PËR VLERËSIMIN E PARAMETRAVE NË BURIM

Shumë fenomene dhe procese fizike modelohen matematikisht nga ekuacionet diferenciale të pjesshme (PDE). Të dhënat e kërkuara nga modelet e PDE si parametrat e burimeve dhe materialeve në praktikë janë objekt i pasigurisë për shkak të gabimeve të ndryshme ose supozimeve të modelimit, mungesës së njohurive dhe informacionit.

Nga: Prof.Dr. Skënder Osmani[1], Prof.Dr.Mihallaq Kotro[2], Ervin Toromani[2], Aida Bode[1], Arben Boçari[2]

Abstrakt

Vlerësimi i parametrit të burimeve duke përdorur elementin fundor stokastik, gjeostatistikën, etj është një pikë kyçe mbi pasigurinë, analizën e riskut, optimizimin [1-5] etj. Në këtë këndvështrim, punimi paraqet disa reflektime në lidhje me: 1) Vlerësimin stokastik të elementeve të fundme. Koncepti i elementit të rastit thjeshtësohet si një element i fundëm stokastik (SFE) duke marrë parasysh një element paralelpiped me tetë nyje, në të cilat jepen funksionet e densitetit të probabilitetit (pdf) në pikën e tij mbështetëse. Në këtë kontekst tregohet: *a* elementi i fundëm stokastik është një interpolator linear, që lidhet me shpërndarjet e dhëna në secilën nyje; *b* shpërndarja pdf në çfarëdo pike X ϵ V; c — vlerësimi i vlerës mesatare të Z (x); 2) Llogaritja e integraleve të vëllimit; 3) SFE në qasjet gjeostatistikore; 4) SFE në zgjidhjen PDE. Më në fund, disa përfundime janë paraqitur duke nënvizuar rëndësinë e aplikacioneve SFE.

Fjalë kyçe: Vlerësimi i parametrave; SFE; gjeostatistika; Kriging; Analiza e riskut; optimizimi

1. Hyrje

Shumë fenomene dhe procese fizike modelohen matematikisht nga

[1] *Universiteti Politeknik i Tiranës*

[2] *Universiteti Bujqësor i Tiranës*

ekuacionet diferenciale të pjesshme (PDE). Të dhënat e kërkuara nga modelet e PDE si parametrat e burimeve dhe materialeve në praktikë janë objekt i pasigurisë për shkak të gabimeve të ndryshme ose supozimeve të modelimit, mungesës së njohurive dhe informacionit. Në këtë këndvështrim parametrat janë (jo përcaktues), stokastikë [6].

Vëmendja e konsiderueshme që elementi stokastik i fundëm (SFE) mori gjatë dekadës së fundit [7-9] i atribuohet kryesisht rritjes spektakolare të fuqisë informatike, duke bërë të mundur trajtimin eficient të problemeve në shkallë të gjerë në dinamikën e proceseve etj. Çështja themelore në SFE është vlerësimi i parametrave dhe rezervave. Metoda më e jashtëzakonshme për zgjidhjen e përafërt të një SPDE është metoda MONTE CARLO [10]. Nga ana tjetër, gjeostatika është një disiplinë e dobishme për të nxjerrë konkluzione për fenomenin (proceset) e riskut hapësinor [11].

2. Një Pamje mbi Elementin Rastësor

Le të përcaktohet një hapësirë fikse e probabilitetit (Ω, A, P) [7], ku Ω është një grup jo bosh i "rezultateve" ose ngjarjeve elementare ", *A* një algjebër σ e nënplasjeve të Ω ("Ngjarje të rastësishme") dhe *P* është një masë e mundësisë në hapësirën e matshme (Ω, A).

Nëse (χ, S_x) është një hapësirë tjetër e matshme, atëherë një element i rastësishëm X në χ është një hartë e matshme nga (Ω, A, P) në (χ, S_x) d.m.th. ai mban X: Ω → χ me

$$X^{-1}(B) := \{X \in B\} := \{\omega \in \Omega : \chi(\omega) \in B\} \in A, \ \forall B \in S_x$$

me secilin element të rastit X: Ω → χ, Px është një probabilitet mase (χ, Sx) e lidhur me shpërndarjen e elementeve të rastit. Përcaktohet nga:

$$P_x'(B) := P\{X \in B\} := P\{\omega \in \Omega : \chi(\omega) \in B\}, (B \in S_x)$$

Një element i rastësishëm X me vlera në X quhet element i rastësishëm, nëse vargu është një grup jo i caktuar i kufizuar në X, ku ekziston një ndarje [4,12] e hapësirës së probabilitetit.

$$\Omega = \bigcup_{k=1}^{N} \Omega_k$$ me grupe të matshme

$$\Omega_k \in A \quad k = 1, 2, \cdots, N \ (N \in \mathbf{N})$$

të tilla si:

$$X(\omega) = x_k \quad \text{for} \quad \omega \in \Omega_k .$$

Probabilitetet përkatëse janë:

$$P(\Omega_k) = p_k, \ p_k \geq 0, \ k = 1, 2, \cdots, N$$

$$\sum_{k=1}^{N} p_k = 1$$

Shpërndarja e një elementi të thjeshtë rastësor është diskrete dhe masa e probabilitetit në (X, Sx), mund të shkruhet si:

Shpërndarja e një elementi të thjeshtë rastësor është një masë diskrete probabilitet në (X, SX) që mund të shkruhet si:

$$P_x = \sum_{k=1}^{N} p_k \delta_{xk} \,,$$

ku: δ_{xk} masa Dirac

$$\delta_{xk}(B) = \begin{cases} 1 & \text{if } x_k \in B \\ 0 & \text{otherwise} \end{cases}$$

3. Element i fundëm stokastik [13]

Edhe pse ky është një koncept i përgjithshëm [7,14] ne do të paraqesim disa konsiderata në këndvështrimin e aplikimeve në vlerësim të parametrave të fenomeneve të ndryshme dhe proceseve.

Le të shqyrtojmë një zonë V ϵ R3 dhe një funksion të rastit Z (x), x ϵ V. Zona V ndahet në blloqe v_i nga një rrjet paralelipiped:

$$V \models \bigcup v_i$$

ku: v_i është një element paralelipiped me tetë nyje.

Në secilën nyje, funksioni i rastit Z (x) është i njohur, me fjalë të tjera është dhënë funksioni i densitetit të probabilitetit (pdf) në pikën mbështetëse të tij (Figura 1). Kërkohet:

Shpërndarja pdf në çfarëdo pike x ϵ V.

Vlerësimi i vlerës mesatare

$$z_{vi} = \frac{1}{v} \int_V Z(x)\,\mathrm{d}x$$

mbi domenin v. (2)

Ne përcaktojmë një element stokastik si një bllok, me funksionin e rastit Z (x), $x \in x_i$.

Le të konsiderojmë një element referimi w_i në sistemin bashkërendues s_1 s_2 s_3. Nëse zgjedhim një bazë jo të plotë [15]:

$$P(s) = \langle 1, s_1, s_2, s_3, s_1 s_2, s_2 s_3, s_3 s_1, s_1 s_2 s_3 \rangle \quad (3)$$

Atëherë funksioni Z (x) mund të paraqitet si një kombinim linear:

$$Z(x) = Z(s_1 s_2 s_3) = \langle P(s) \rangle [P_8]^{-1} \{Z_s^8\} = \langle N(s) \rangle \{Z_s^8\} \quad (4)$$

Ku:

$[P_S]^{-1}$ është matrica, elementët e së cilës janë vlerat bazë të polinomit në nyjet.



Figura 1. Elementet e paralelpipedit

$\{Z_S^8\}$ është vektor i shpërndarjeve në nyje

$\langle N(s)\rangle$ është vektor i funksioneve të formës

N_i, i=1,2,....,8

$$N(s)=\langle N_i(s)\rangle=\langle N_1(s),N_2(s),\cdot$$

$$N_i(s)=\left(1+s_1s_1^i\right)\left(1+s_2s_2^i\right)\left(1+s_3s_3^i\right)$$

Në formulën (5), "*eksponenti i*" nuk është një variabël. Ajo tregon vetëm shenjën brenda kllapave.

3.1. Vlera mesatare

Të llogaritet vlera mesatare $z_{vi}=1/v\int_V Z(x)\,dx,$

,

ne konsiderojmë transformimin përcaktues:

$$X_i(s)=\langle N_i(s)\rangle\langle x_i^8\rangle \quad i=1,2,\cdots,8 \qquad (6)$$

Prandaj [13]

$$Z_{vi}=\frac{1}{v}\int_v Z\left(x_1(S_1S_2S_3),x_2(S_1S_2S_3),x_3(S_1S_2S_3)\right)\det J ds_1ds_2ds_3$$

$$=\sum_{i=1}^{8}H_iZ_i(x)$$

$$H_i=f\left(a_{ij},b_{ij},c_{ij},d_{ij}\right)$$

Koeficientët a_{ij}, b_{ij}, c_{ij}, d_{ij}, i, j = 1, 2, 3 varen vetëm nga koordinatat e nyjeve. Duke ditur koeficientin e mësipërm mund të llogarisim [13] koeficientin e peshës H_i (i=1,..., 8) si për shembull për H_2

$$\begin{aligned}H_2 &= 8/3\,c_{21}a_{32}c_{13}+8/9\,d_{21}a_{32}a_{13}+8/27\,c_{21}c_{32}d_{13}\\ &+8/27\,d_{21}c_{32}b_{13}+8/9\,a_{21}b_{32}c_{13}+8/9\,b_{21}b_{32}a_{13}\\ &+8/27\,a_{21}d_{32}d_{13}+8/27\,b_{21}d_{32}b_{13}+8/9\,c_{11}a_{22}d_{33}\\ &+8/9\,d_{11}a_{22}a_{33}+8/9\,a_{11}b_{22}c_{33}+8/9\,b_{11}b_{22}a_{33}\\ &+8/27\,c_{11}a_{22}d_{33}+8/27\,d_{11}c_{22}b_{33}+8/27\,a_{11}d_{22}d_{33}\\ &+8/27\,b_{11}d_{22}b_{33}+8/9\,a_{12}a_{23}d_{31}+8/9\,b_{21}a_{23}b_{31}\\ &+8/27\,c_{12}b_{23}d_{31}+8/27\,d_{12}b_{23}b_{31}+8/9\,a_{12}c_{32}c_{31}\\ &+8/9\,b_{12}c_{23}a_{31}+8/27\,a_{21}d_{32}c_{31}+8/27\,d_{12}d_{23}a_{31} \qquad (7)\\ &+8/9\,a_{13}a_{22}d_{31}+8/9\,c_{13}a_{22}c_{31}+8/9\,a_{13}b_{13}b_{31}\\ &+8/9\,c_{13}b_{22}a_{31}+8/9\,b_{13}d_{22}d_{31}+8/27\,d_{13}c_{22}c_{31}\\ &+8/27\,b_{13}d_{13}b_{31}+8/27\,d_{13}d_{22}a_{31}+8/9\,c_{21}a_{12}c_{33}\\ &+8/9\,d_{21}a_{12}a_{33}+8/9\,a_{12}b_{12}c_{33}+8/9\,b_{21}b_{12}a_{33}\\ &+8/27\,c_{21}c_{12}d_{33}+8/27\,a_{13}a_{22}d_{31}+8/27\,a_{12}d_{12}d_{33}\\ &+8/27\,b_{21}d_{12}b_{33}+8/9\,c_{11}a_{32}c_{23}+8/9\,d_{11}a_{32}a_{23}\\ &+8/9\,a_{32}b_{32}c_{23}+8/27\,b_{11}b_{32}a_{13}+8/9\,c_{11}c_{32}d_{23}\\ &+8/27\,d_{11}c_{32}b_{23}+8/27\,a_{32}d_{32}d_{23}+8/27\,b_{11}d_{32}b_{23}\end{aligned}$$

Dihet se:

$$\sum_{i=1}^{8}H_i=1 \qquad (8)$$

Kështu që, koeficientët H_i janë peshat e shpërndarjes. Me fjalë të tjera, ata bëjnë mesataren e ponderuar të shpërndarjeve të dhëna në nyjet.

Kështu, vlerësuesi i përmendur stokastik i elementit të fundëm është një ndërmjetës linear, në lidhje me shpërndarjet e dhëna në nyjet e tij [13].

Duke marrë parasysh që procesi mesatar është një nga konceptet më të përdorura në teknikat e llogaritjes në elementin e fundëm dhe gjeostatistikën, më poshtë janë paraqitur dy procedura të vlerësimit integral, të cilat janë pika kyçe në vlerësimin e matricave në SFE dhe matricat kriging, cokriging, kovariance në gjeo-statistikat [11,16,17].

4. Integralet e vëllimit brenda Polyedras [18]

Le të bëjmë një funksion u (x_1, x_2, x_3) në një sistem koordinativ x_1, x_2, x_3. Integrali i vëllimit V do të vlerësohet:

$$\int_v u(x_1, x_2, x_3)\,\mathrm{d}v$$

ne do të ndërtojmë një vektor $\varphi\ (x_1, x_2, x_3)$ që do të kënaqë:

$u = div\widehat{\Phi}$ (10)

ku:

$\varphi = \varphi_1\hat{\imath}_1 + \varphi_2\hat{\imath}_2 + \varphi_3\hat{\imath}_3$ (11)

i_1, i_2, i_3 është sistemi i vektorit të njësisë përgjatë drejtimeve koordinuese.

Le të supozojmë se sipërfaqja kufitare S e vëllimit V është e përbërë nga k plane poligonalë të rrafshit S_i (i = 1, 2k). Duke aplikuar teoremën e divergjencës gjejmë:

$$\int_v u(x_1, x_2, x_3)\,\mathrm{d}v = \sum_{j=1}^{k} \iint u(x_1, x_2, x_3)\,\mathrm{d}x_1\,\mathrm{d}S_j^1 \quad (12)$$

ku: zona e parashikuar dS_j^1 është pingul me $\hat{\imath}$ dhe shtrihet në rrafshin (x_2, x_3).

Ekuacioni dS_j mund të shprehet si:

$$x_1 = x_1^{(j)}(x_2, x_3) = \alpha_1^{(j)} + \alpha_2^{(j)}x_2 + \alpha_3^{(j)}x_3$$

kështu që ana e djathtë e ekuacionit (12) mund të thjeshtohet që të jetë:

$$\int_V u(x_1, x_2, x_3)\,\mathrm{d}V = \sum_{j=1}^{k} \int_{S_j} \varphi^{(j)}(x_1, x_2)\,\mathrm{d}S_j \quad (13)$$

ku: sipërfaqja S_j^1 është një shumëkëndësh në (x_2, x_3), në të cilin funksioni $\varphi^{(j)}$duhet të jetë i integruar për j = 1,2, ...,k.

Në këtë mënyrë, llogaritja e integralit të vëllimit është një procedurë për të integruar një funksion arbitrar brenda një poligoni. Duke përsëritur edhe më tej procedurën e lartpërmendur mund të gjejmë:

$$\int_{\Omega} V(x_1,x_2)\mathrm{d}\Omega = \int_{T} \Psi(x_1,x_2)n_1\mathrm{d}T = \sum_{j=1}^{k}\int_{T} \Psi(x_1,x_2)n_1\mathrm{d}T = \sum_{j=1}^{k}\int_{T_j} \Psi\left(x_1^{(1)},x_2\right)n_j^{(j)}\mathrm{d}T \quad (14)$$

ku, perimetri T është një koleksion i vijave të drejta

T_j, j=1,....,k

Ndërsa,

$$x_1 = x_j^{(j)}(x_2) \quad (15_1)$$

$$n_1^{(j)}\mathrm{d}T = \mathrm{d}x_2 \quad (15_2)$$

Le të jenë x_2 koordinatat për anën j^{th} x_2^{js} dhe x_2^{je}. Kështu që:

$$\int_{T_j} \Psi_1(x_1,x_2)n_1\mathrm{d}T = \int_{x_2^{js}}^{x_2^{je}} \Psi\left(x_1^{(j)}(x_2),x_2\right)\mathrm{d}x_2 = \int_{x_2^{js}}^{x_2^{je}} \gamma_j(x_2)\mathrm{d}x_2 \quad (16)$$

Më në fund, integrali i mësipërm mund të vlerësohet nga skema Gausiane. Është për tu theksuar se integrali i zërit është një procedurë përcaktuese, por nëse ω = v dhe X (ω) = u, atëherë mund të vlerësohet si një element i fundëm stokastik duke përdorur metodën Monte-Carlo.

Paralelisht nëse u(x), $X\epsilon R^n$ është një funksion i rastësishëm (RF)

atëherë integrali $1/v\int_v u(x)\,dv$ mund të trajtohet në pikëpamje gjeo-statistikore si një vlerë mesatare.

5. Qasja Gjeostatistikore

5.1. Variograma

Gjeostatistikat bazohen në teorinë e variablave të rajonalizuara [2] me supozimin se të dhënat janë vëzhgime të variablave stokastikë. Elementi qendror i gjeostatistikës është funksioni variogram ose funksion gjysmë variabël, i cili është një strukturë që përshkruan varësinë hapësinore të variablës hapësinore [11].

Formula e mëposhtme është më shpesh e përdorur për llogaritjet e variogramit (gjysmëvariablës):

$$\gamma(h) = \frac{1}{2N}\sum_{i=1}^{N}\left[Z(x_i) - Z(x_i+h)\right]^2 \quad (17_1)$$

ku:

x_i është një vendndodhje e të dhënave, h është një vektor log, z (x_i) është vlera e të dhënave në vendndodhjen x_i, N është numri i çifteve të të dhënave që ndahen në njësi në distancë dhe në drejtim h.

Llogaritjet e gjysmëvariancës mund të bëhen gjithashtu me të dhëna nga imazhet e RS për shembull si një variant kryq. Është përkufizuar si gjysma e produktit mesatar të distancës log në krahasim me dy variablat Z dhe Y.

$$\gamma_{xy}(h) = \frac{1}{2N}\sum_{i=1}^{n(h)}\{[Z(x_i)-Z(x_i+h)][Y(x_i)-Y(x_i+h)]\} \quad (17_2)$$

ku:

Z (x_1) dhe Y (x_1) janë vlerat e të dhënave në pikën x_1 për dy shirita (profile);

N është numri i të dhënave të ndara sipas gjatësisë së vektorit h;

Një variogram zakonisht karakterizohet nga tre parametra [2]:

- Sill — pllaka që arrin semi-variogramën;
- Gama — distanca në të cilën dy pika të të dhënave janë të palidhura;
- Nugget — shkëputje vertikale në origjinë.

Zakonisht aplikimi i semi-variogramave kërkon që të dhënat të përmbajnë hipotezën e brendshme për një variabël të rajonalizuar. Me fjalë të tjera, një funksion i rastit Z (x) thuhet se është i brendshëm kur:

pritja matematikore ekziston dhe nuk varet nga mbështetja x

$$E\{Z(x)\} = m\forall(x) \qquad (18)$$

për të gjithë vektorët h, pika e ndryshimit Z (x + h) - Z (x) ka një variancë të caktuar, e cila nuk varet nga x

$$Var[Z(x+h) - Z(x)] = E\{[Z(x+h) - Z(x)]^2\}\forall(x) \qquad (19)$$

ku:

Z (x) është një funksion i rastësishëm, d.m.th lokalisht në një pikë x_1, Z (x_1) është një variabël i rastësishëm dhe Z (x_1) dhe Z (x_1 + h) janë përgjithësisht të pavarura, por janë të lidhura nga një korrelacion që shpreh strukturën hapësinore të variablave fillestarë të rajonalizuar Z (x). Variogramat eksperimentale përafrohen nga modele të ndryshme si: sferike, eksponenciale, gausiane, rrethore, tetrasferikale, pentasferikale, Efekti i Vrimës, K— Bessel etj [2,16,18].

5.2. Kriging në pamjen SFE [13]

Le të jetë Z (x) funksioni rastësor dhe vlerësimi i vlerës mesatare:

$$Z_V = \frac{1}{v}\int_V Z(x)\,dx \qquad (20)$$

mbi një domen të caktuar v kërkohet të njihet një mbështetje e vlerave diskrete, $Z_\alpha, \alpha = 1, \dots n$.

Sipas qasjes Kriging (2) vlerësuesi linear Z_α^* i n vlerave të të dhënave konsiderohet:

$$Z_k^* = \sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha Z_\alpha \qquad Z_\alpha = \frac{1}{v_\alpha}\int_{v_\alpha} Z(x)\,dx \qquad (21)$$

Peshat n λ_α llogariten nën hipotezën klasike të momentit:

$$E\{Z(x)\} = m$$
$$E\{Z(x+h)Z(x)\} - m^2 = C(h) \text{ or}$$
$$E\{Z(x+h) - Z(x)\}^2 = 2\gamma(h) \qquad (22)$$

Ne duhet të jemi të sigurtë se vlerësuesi është i paanshëm, si dhe varianca është minimale. Le të supozojmë se njëra (ose të dyja) nga dy hipotezat nuk janë realizuar dhe të dy pritjet e Z (x) dhe kovariancës varen nga x:

$$E\{Z(x)\} = m(x)$$
$$C(x,h) = E\{Z(x+h)Z(x)\} - m(x+h)m(x) \qquad (23)$$

Para se të merret në konsideratë kjo hipotezë, ajo duhet të nënvizohet, cilado qoftë në momentin që funksionet do të jenë, ato gjithmonë duhet të çojnë në një ndryshim pozitiv. Gjithashtu, ne do të tregojmë llogaritjen e zgjidhjes Kriging duke përdorur SFE, por pa marrë parasysh ekzistencën dhe unitetin e saj (Ai nuk është qëllimi i këtij punimi). Për të siguruar që vlerësuesi është i paanshëm, ne vendosim kushtin:

$$\sum_{\alpha=1}^{n} \lambda_\alpha m_\alpha - m_v = 0 \qquad (24)$$

Me

$$m_v = E\{Zv(x)\} = E\left\{\frac{1}{v}\int_V Z(x)\mathrm{d}x\right\},$$
$$m_\alpha = E\{Z(v_\alpha)\} = E\left\{\frac{1}{v_\alpha}\int_{V_\alpha} Z(x)\mathrm{d}x\right\} \quad \alpha = 1,\cdots,n \qquad (25)$$

Varianti i vlerësimit është:

$$E\left\{\left[Z_v - Z_k^*\right]^2\right\} = E\{Z_v^2\} - 2E\{Z_v Z_k^*\} + E\{Z_k^*\} \qquad (26)$$

Duke marrë parasysh shprehjen e $E\{Z_v^2\}$ kemi:

$$E\{Z_v^2\} = E\left\{\frac{1}{v^2}\int \mathrm{d}x \int Z(x)Z(y)\mathrm{d}y\right\}$$
$$= \sum_{i=1}^{8}\sum_{i=1}^{8} c_{i,j} E\{Z_v(x_i)Z_y(y_i)\} \qquad (27)$$

Gjithashtu

$$\sum_{i=1}^{8}\sum_{i=1}^{8} c_{i,j} \cdot E\{Z_v(x_i)Z_y(y_i)\}$$
$$= \sum_{i=1}^{8}\sum_{i=1}^{8}\{c_{i,j}\left[C(v_i,v_j) + m_{vi}m_{vj}\right]\} \qquad (28)$$
$$= \check{C}(v,v)$$

ku:

m_{vi} është pritja e Z (x_i) në nyjen i,

$\check{C}(v,v)$ është kovariacioni në varësi jo vetëm të distancës **h**, por edhe nga **x**. Nga kryerja e veprimeve të tjera dhe nga zëvendësimi i vlerësimit variancë, ne do të marrim:

$$E\left\{\left[Z_v - Z_k^*\right]^2\right\} = \check{C}(v,v) - 2\sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha \check{C}(v,v_\alpha)$$
$$+ \sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha \sum_{\beta=1}^{n}\lambda_\beta \check{C}(v_\beta,v_\alpha) \qquad (29)$$

Tani problemi qëndron në llogaritjen e peshës λ_α, ku α=1,....,k të cilat minimizojnë vlerësimin në kushte të paanshme:

$$\sum_{\alpha=1}^{n}\left(\lambda_\alpha - \frac{1}{n}\right)m_\alpha = 0 \qquad (30)$$

Për këtë arsye, ne përdorim metodën e Lagranzhit, sipas së cilës duhet të marrim derivatet e:

$$F = \overset{v}{C}(v,v) - 2\sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha \overset{v}{C}(v,v_\alpha) + \sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha \sum_{\beta=1}^{n}\lambda_\beta (v_\beta, v_\alpha) + 2\mu\sum_{\alpha=1}^{n}\left(\lambda_\alpha - \frac{1}{n}\right)m_\alpha \qquad (31)$$

Kjo procedurë siguron sistemin Kriging të n + 1, ekuacionet e barazimeve lineare në (λ_α,μ):

$$\sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha \overset{v}{C}(v_\beta, v_\alpha) - \mu m_\alpha = \overset{v}{C}(v, v_\alpha)$$

$$\sum_{\alpha=1}^{n}\lambda_\alpha m_\alpha = e, \qquad e = \sum_{\alpha=1}^{n}\frac{1}{n}m_\alpha \qquad (32)$$

e cila mund të shprehet në formën e matricës:

$$[K]\{\lambda_\alpha\} = \{M\}$$

$$[K] = \begin{bmatrix} c(v_1v_1) & c(v_1v_2) & \cdots & c(v_1v_n) \\ c(v_2v_1) & c(v_2v_2) & \cdots & c(v_2v_n) \\ \vdots & \vdots & \ddots & \vdots \\ c(v_nv_1) & c(v_nv_2) & \cdots & c(v_nv_n) \end{bmatrix}$$

$$\{\lambda\} = \begin{Bmatrix} \lambda_1 \\ \lambda_2 \\ \vdots \\ \lambda_n \end{Bmatrix} \quad \{M\} = \begin{Bmatrix} c(v_1v) \\ c(v_2v) \\ \vdots \\ c(v_nv) \end{Bmatrix} \qquad (33)$$

Le të supozojmë se zgjidhja e sistemit (33) ekziston dhe është unike. Në këtë situatë, është mjaft e qartë se ai sistem (33) është i përgjithshëm, në kuptimin e të ashtuquajturit sistemi Kriging.

Shembulli 1

Në figurën 2 shikohet një strukturë me 3 blloqe: v_1 = 1 × 1, v_x = 1 × 1, v_2 = 2×2 me zona të kontaminuara(radioaktivitet, vaj, gaz etc). Ekuacioni i variogramit është γ (x) = 4h dhe parametrat e matur në blloqet v_1, v_2 janë përkatësisht:

$E(Z_1(x))=0.590 \qquad E(Z_2(x))=0.409$

Le ta vlerësojmë parametrin Z (x) në bllokun v_x që zgjidh sistemin Kriging duke përdorur element të fundëm. Sipas qasjes Kriging kemi:

$Z = \lambda_1 + Z_1 + \lambda_2 + Z_2$ ku λ_1, λ_2 janë parametrat e sistemit Kriging:

$$\begin{bmatrix} \bar{\gamma}(v_1,v_1) & \bar{\gamma}(v_1,v_2) & 1 \\ \gamma(v_2,v_1) & \gamma(v_2,v_2) & 1 \\ 1 & 1 & 0 \end{bmatrix}\begin{bmatrix} \lambda_1 \\ \lambda_2 \\ \lambda_3 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} \gamma(x_1x_x) \\ \gamma(x_2x_x) \\ 1 \end{bmatrix}$$

Zgjidhja është $\lambda_1 = 0.5906$, $\lambda_2 = 0.409$, $\lambda_3 \approx 0$.

Shembull 2

Në figurën 3, paraqitet një profil në një zonë, në të cilën është matur një parametër duke përdorur një hap të vazhdueshëm **h**. Varianogrami përkatës i paraqitur në Figurën 4 ka qenë i përafruar nga një model sferik:



Fig.2 Zona e kontaminuar me tre blloqe



Figura nr.4 Variograma e diametrave në varësi të distancës midis zonave të modelit.

$$\gamma(h)=\begin{cases} c\left(\dfrac{3h}{2a}-\dfrac{1}{2}\dfrac{h^3}{a^3}\right) & h\le a \\ 0 & h\ge a \end{cases}$$

me c = 1 dhe a = 4h (diapazoni). Forma parabolike e variogramës rreth origjinës tregon se është homogjen [2].

6. SFE në ekuacionet diferenciale të pjesshme

Parametrat e ekuacioneve diferenciale të pjesshme në shumë raste nuk janë përcaktuese por stokastike. Në këtë pamje, le të shohim një PDE. Së pari pika jonë fillestare është problemi i vlerës së kufirit eliptik të rendit të dytë:

$$\begin{aligned} -\bar{V}*\left(T\bar{V}p\right)&=F && \text{in } D \\ p&=g && \text{on } \partial D_D\neq 0 \\ n*\left(T\bar{V}p\right)&=0 && \text{on } \partial D_N \end{aligned} \qquad (34)$$

pozuar në një domen poligonal të kufizuar $D\subset R^2$, kufiri i të cilit është i ndarë në dy pjesë, $\partial D=\partial D_D\cup\partial D_N$ (Dirichle dhe Neumman). Ky problem i difuzionit të gjendjes së qëndrueshme mund të riformatohet duke prezantuar variablin $u=-T\overline{Vp}$ si:

$$\begin{aligned} T^{-1}u\big|+\bar{V}p&=0 \\ \bar{V}*u&=F && \text{in } D \\ p&=g && \text{on } \partial D_D \\ n*u&=0 && \text{on } \partial D_D \end{aligned} \qquad (35)$$

Në kontekstin e modelimit të rrjedhës së ujërave nëntokësorë, p është kreu hidraulik dhe u është përkatësisht fluksi vëllimor. Në shumë aplikacione, vetëm informacioni i kufizuar në lidhje me koeficientin e difuzionit T ose termin burim F është i disponueshëm.

Supozojmë se T = t (x, ω) (dhe F = F (x, ω) janë fusha të rastësishme, d.m.th një familje me variabla të rastësishme T (x, ω) me variabel indeksi $x \in \bar{D}$. Çdo variabël i rastësishëm merr vlera në R dhe është përcaktuar në një hapësirë të plotë të probabilitetit (Ω,ɯ, P), ku Ω tregon grupin e ngjarjeve elementare, **ɯ** është një ∂ --- algjebër në Ω e gjeneruar nga variablat e drejtimit T (x,), (dhe F (x,)) dhe P është një masë probabiliteti.

Një pasojë e rastësisë në termin koeficient dhe shpërndarës është se variablat e daljes p dhe nëse janë të pranishme, janë fusha të rastësishme. Forcimi primar [12] shndërrohet në problemin e gjetjes së një fushe të rastit:

$u = u(x,\omega)$, $p = p(x,\omega)$, i tillë që, P pothuajse me siguri

$$\begin{aligned} &\bar{V}*\left(T(x,\omega)\bar{V}p(x,\omega)\right) = F(x,\omega) && \text{in } D\times\Omega \\ &p(x,\omega) = g(x) && \text{on } \partial D_D \times\Omega \\ &n*\left(T(x,\omega)\bar{V}p(x,\omega)\right) = 0 && \text{on } \partial D_N \times\Omega \end{aligned} \quad (36)$$

Në mënyrë analoge në formulimin e përzier [12] ne tani kërkojmë fusha të rastësishme $u = u(x,\omega)$ dhe $u = u(x,\omega)$ të tilla që: p — pothuajse me siguri (si):

$$\begin{aligned} &T_{-1}(x,\omega)u(x,\omega) + \bar{V}p(x,\omega) = 0 \\ &\bar{V}u(x,\omega) = F(x,\omega) && \text{in } D\times\Omega \\ &p(x,\omega) = g(x) && \text{on } \partial D_D \times\Omega \\ &n*u(x,\omega) = 0 && \text{on } \partial D_N \times\Omega \end{aligned} \quad (37)$$

Si një shembull i thjeshtë le të hedhim një vështrim në elementin stokastik të fundëm në ekuacionin difuzion-konvekcion [5,6,12,19]:

$$\begin{aligned} &\frac{\partial}{\partial x}\left(k_x \frac{\partial \varphi}{\partial x}\right) + \frac{\partial}{\partial y}\left(k_y \frac{\partial \varphi}{\partial y}\right) \\ &+V_x \frac{\partial \varphi}{\partial x} + V_y \frac{\partial \varphi}{\partial y} + Q = C\frac{\partial \varphi}{\partial t} \end{aligned} \quad (38)$$

duke përdorur algoritmin Crack-Nickolson me $0 < \theta \leq 1$:

$$\begin{aligned} &\varphi_{i,j}^{n+1} a_1 \varphi_{i-1,j}^{n+1} + a_2 \varphi_{i,j}^{n+1} + a_3 \varphi_{i+1,j}^{n+1} \\ &+ a_4 \varphi_{i,j-1}^{n+1} + a_5 \varphi_{i,j+1}^{n+1} = \varphi_{i,j}^{n} + bQ_{i,j}^{n} \end{aligned} \quad (39)$$

Ku:

C--- solucioni i përqëndruar, x,y ---- kordinatat hapsinore, t-- koha e kordinatës, V--- shpejtësia e rrjedhshme e vektorit me komponentet V_x , V_y, D--- koeficienti i difuzionit, a_i $i = 1,5$ dhe b janë koeficientët e varur në koeficientët e përmendur, $\Delta x, \Delta y$ hapi në kohë, Δt koha e hapave.

Më poshtë po paraqesim një zonë të lumit të kontaminuar nga një pikë burimi të ndotur Figura 5, të vendosur në anën e majtë të nyjes 13.

Komponentët V_x dhe V_y janë matur në një interval kohe. Komponenti i Vy është pozitiv në lidhje me rreshtin 13 - 18 dhe negativ nën këtë. Për të ilustruar idenë, është paraqitur më poshtë një zgjidhje e pjesshme e përqendrimit të ndotësit në hapin st = 5 për një problem të thjeshtë të rrjedhës jo të palëvizshme (kushtet e Dirichle— Neëman). Using *q* = 1, *Kx* = 1, *Ky* = 1, *Vx* = 1,



Figura 5 Zona e lumit të kontaminuar





Figura 6 Koncentrimi dinamik i kontaminimit

Vy = 0.01, vlerat e mëposhtme të mjeteve pa dimension nga një procedurë Monte Carlo [10] rezultuan:

xx [1] = 0.0012	xx [2] = 0.003	xx [3] = 0.004
xx [4] = 0.0043	xx [5] = 0.0036	xx [6] = 0.0029
xx [7] = 0.0410	xx [8] = 0.069	xx [9] = 0.074
xx [10] = 0.073	xx [11] = 0.051	xx [12] = 0.053
xx [13] = 0.9000	xx [14] = 0.770	xx [15] = 0.590
xx [16] = 0.450	xx [17] = 0.250	xx [18] = 0.290
xx [19] = 0.0410	xx [20] = 0.069	xx [21] = 0.074
xx [22] = 0.073	xx [23] = 0.051	xx [24] = 0.053
xx [25] = 0.0012	xx [26] = 0.003	xx [27] = 0.0041
xx [28] = 0.0043	xx [29] = 0.0036	xx [30] = 0.0029

Në figurën 6, është paraqitur dinamika e përqendrimit të ndotësit për periudha të ndryshme të rrjedhës.

Siç pritej zgjidhja është simetrike. Ekzistojnë ngjashmëri të thjeshta midis koncepteve të ndryshme dhe operatoreve në gjeostatistikë dhe SFE si për shembull: blloqet, operatori i

ndërhyrjes, minimizimi i variancës (energjisë).

7. Konkluzione

Aplikimet SFE dhe Gjeostatistike kanë një rëndësi të madhe në burimet mjedisore, energjinë bërthamore dhe të rinovueshme, ekologjinë, pyjet, gjeologjinë, klimën, ndotjen e ujit dhe ajrit, hartat, si dhe në pasigurinë e tyre, analizën e rreziqeve dhe optimizimin [1,5,14, 15,20,21].

Referencat

1) C. Busby, *et al*., "2010 ECRR Recommendations of the European Committee on Radiation Risk Brussels," BEL-GIUM, 2010.
2) A. G. Journel and Ch. J. Huijbreght, "Mining Geostatistics," Academic Press, London, 1979.
3) E. Guastaldy, "Geostatistical Modeling of Uncertainty for the Risk Analysis of a Contaminated Site in the Northern Italy," Geophysical Research Abstract, European Geo-science Union, Vol. 7, 2005.
4) M. Kleiber and T. D. Hien, "The Stochastic Finite Ele ment Method," Wiley, Chichester, 1992.
5) S. Osmani, "Some Consideration on Finite Element Solution of Diffusion—Convection Equation and Its Application on Water Pollution," Proceedings of Internaional Conference on Ëater Problem in the Mediterranean Countries, North Cyprus, 1997.
6) S. Osmani and M. Qirko, "Stochastic Finite Elements in a Complex System: Nonstationary Fluid Flow, Mass Trans- port, Heat Conduction and Vibrating," International Con ference in Scaling up in Fluid Flow in Porous Medium CROATIA 2008 as well as (Second Part) in 5th Asian Rock, Symposium Tehran, Tehran, 2008.
7) R. Ghanem and P. Spanos, "Stochastic Finite Elements: A Spectral Approach," Springer-Verlag, Berlin, 1991.
8) R. Ghanem, "Ingredients for a General Purpose Stochas tic Finite Element Formulation," Computer Methods in Applied Mechanics and Engineering, Vol. 168, No. 19, 1999.
9) A. Keese, "A Review of Recent Developments in the Numerical Solution of Stochastic Partial Differential Equations (Stochastic Finite Elements)," Institut für Wissen- schaftliches Rechnen, Brunswick, 2003.
10) K. Saberfield, "Monte Carlo Methods for Stochastic PDEs," Institute for Applied Analysis and Stochastic, Berlin, 2007.

11) J. P. Chiles and P. Delfiner, "Geostatistics, Modeling Spatial Uncertainty," Wiley, Neë York, 1999.doi:10.1002/9780470316993

12) A. Bode and S. Osmani, "Using Stochastic Finite Element in Geostatistics and Difusion Convection Equations. MAMERNO9," Third International Conference on Approximation Methods and Numerical Modeling in Environment and Natural Resources, Pau, 8-11 June 2009.

13) S. Osmani, "Energy Distribution Estimation Using Sto chastic Finite Element," Renewable Energy, Elsevier, London, 2002.

14) G. Stefanou, "The Stochastic Finite Element Method: Past, Present and Future," Computer Methods in Applied Mechanics and Engineering, Elsevier, London, 2009.

15) O. C. Zienkiewitz and R. L. Taylor, "The Finite Element Method," 5th Edition, The Basic, Elsevier, Oxford, 2000.

16) P. Govartes, "Geostatistics for Natural Resources Evaluation," Oxford University, New York, 1997.

17) S. Osmani, "Finite Element on Geostatistique Calculations," In: A. G. Fabri et Royer, Ed., 3rd International Codata Conference in Geomathematics and Geostatistics Science de la Terre, Nancy, 1994.

18) G. Dasgupta, "Integration within Polygonal Finite Elements," Journal of Aerospace Engineering, Vol. 16, No. 1, 2003, pp. 9-18.

19) S. Osmani, "Finite Element Method (in Albanian)," Tirana, 2009.

20) Nuclear Energy, "The Future Climat," The Royal Society, Portsmuth, 1999.

21) S. Osmani, "A Model of Convection Diffusion Equation in 3D with Finite Elements," 17th International Biennal Conference Numerical Analysis, Dundee, 1997.

Përktheu: Elisa Metaj,

Audituese e pare,

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Prof.Dr. Skënder Osmani[1], Prof.Dr.Mihallaq Kotro, Ervin Toromani, Aida Bode, Arben Boçari

1- Universiteti Politeknik i Tiranës

2- Universiteti Bujqësor i Tiranës

PARADIGMA E AUDITIMIT TË JASHTËM DHE MIRËQEVERISJA

Auditimi i jashtëm publik apo institucionet supreme të auditimit funksionojnë si organizata, eficienca dhe efektiviteti i të cilave janë në funksion të disa faktorëve, ndërlidhja e të cilave është trajtuar nga pikëpamja teorike dhe empirike nga autorë të ndryshëm.

Nga: Prof.Dr.Lindita Milo,

MSc. Amantia Patozi, KLSH

Abstrakt

Përgjithësisht, shumë dëgjojmë të artikulohet për qeverisjen e fondeve publike me synimin e rritjes së mirëqenies së njerëzve nëpërmjet ndërtimit të institucioneve të përgjegjshme dhe efektive në të gjitha nivelet, pohim i cili shkon përtej të përgjithshmes. Ndërlidhja midis qeverisjes së mirë dhe zhvillimit përbën thelbin e objektivit 16 –të, të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Qëllimi i këtij punimi është të adresojë paradigmën e auditimit të jashtëm publik si një nga mekanizmat e një qeverisjeje më të mirë që synojnë transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien mbi përdorimin me eficiencë të parasë publike, pra, mirëqeverisjen. Auditimi i jashtëm publik apo institucionet supreme të auditimit funksionojnë si organizata, eficienca dhe efektiviteti i të cilave janë në funksion të disa faktorëve, ndërlidhja e të cilave është trajtuar nga pikëpamja teorike dhe empirike nga autorë të ndryshëm.

Nëpërmjet analizës së eksperiencës së auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, pra të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është marrë si rast studimor, identifikohen faktorët që përcaktojnë performancën e aktivitetit auditues nga pikëpamja e outputit.

Qeverisja, qeverisja publike dhe parimet e mirëqeverisjes

Ka një interval shumë të gjerë të përkufizimeve të termit të qeverisjes, të trajtuar nga autorë të ndryshëm. Sipas Solomon, J. (2007) termi "qeverisje" rrjedh nga Latinishtja "gubernare" që do të thotë "*drejtojë*", zakonisht përdoret për drejtimin e anijes, e cila do të thotë se qeverisja e korporatës përfshin më shumë funksionin e drejtimit se sa të kontrollit. Në përgjithësi ky koncept është konsideruar si aspekt dinamik dhe kryesor i biznesit por jo vetëm. Pavarësisht se termi i qeverisjes në kontekstin e strukturave institucionale është përdorur në fund të viteve 1800[1], në kuptimin aktual të gjerë, duke përfshirë përgjithësisht aktivitetet e institucioneve private dhe publike, ky koncept është përdorur nga studiuesit e politikës dhe ekonomisë vetëm pas viteve 1990, bazuar edhe në përcaktimet e institucioneve të rëndësishme si Kombet e Bashkuara (UN), Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF) dhe Banka Botërore (WB). Në vitet vijuese termi i qeverisjes ka pasur një përdorim gjithnjë e më të shpeshtë.

Në këtë kontekst, koncepti i qeverisjes është i trajtuar dhe diskutuar gjerësisht dhe është pranuar se i referohet proceseve në të cilat ushtrohet pushtet, autoritet e influencë dhe ndërmerren politika e vendime që lidhen me jetën publike dhe mirëqenien sociale.

Për qëllimet e këtij punimi është përdorur përcaktimi i Shoqatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC, 2001), sipas të cilit "*Qeverisja është e lidhur me strukturat dhe proceset e vendim-marrjeve, llogaridhënies, kontrollit dhe sjelljes së drejtuesve të entiteteve*".

Përcaktimi i konceptit të qeverisjes në tërësi, dhe i qeverisjes publike si dhe i instrumenteve të saj janë artikuluar nga shumë autorë të cilët janë thelluar dhe kanë argumentuar aspekte të ndryshme të këtyre koncepteve. Kriza financiare e vitit 2008 e më tej, luhatjet në rritjen ekonomike në përgjithësi kanë sjellë në fokus të diskutimeve dhe debateve të studiuesve shkaqet e dështimeve të kompanive dhe të shërbimit të ofruar si në sektorin privat edhe në atë publik. Problematikat e evidentuara në funksionimin e instrumenteve të qeverisjes së korporatave treguan se

[1] nga Charles Plummer's *The Governance of England* (annjë përkthim i vitit 1885 të punimit të shekullit 15 të John Fortescue që ndryshe njihet si *Diferenca midis monarkise absolute dhe te kufizuar* (*The Difference between an Absolute and a Limited Monarchy*)

këto instrumente nuk mundën të garantonin që vendimmarrja menaxheriale të ishte tërësisht në funksion të objektivit të aksionerëve pavarësisht nëse aksionerët janë individ dhe/ose sipërmarrje private apo është qytetari, publiku si një e tërë.

Referuar OECD (2016), rënia e besimit të qytetarëve ndaj qeverive, e shoqëruar me rritjen e pabarazisë ka nxjerrë në pah nevojën për strategji të reja të qeverisjes publike si dhe domosdoshmërinë jetike të rritjes së eficiencës, pra që "qeveritë të bëjnë më shumë (të ofrojnë më shumë shërbime) me më pak para", duke iu përgjigjur nevojave të qytetarëve.

Prandaj sfida e vazhdueshme për institucionet e auditimit të jashtëm publik është auditimi i efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, pra auditimi nga këndvështrimi i "vlerës së parasë" publike të përdorur. Efektiviteti i aktivitetit audites të institucioneve të auditimit të jashtëm publik konsiderohet i ndërlidhur me transparencën mbi gjetjet e auditimeve kryesisht të ndërlidhura me zhvillimin e qëndrueshëm financiar, social dhe ambiental si dhe duke adresuar sfidat ekonomike dhe të politikave fiskale. Këto aspekte bëhen akoma dhe më të rëndësishme duke marrë në konsideratë situatat e reja të pandemisë globale dhe burimet në rënie të pasurisë së kombeve.

Sikurse Swarbrick, A., (2011) analizon se pavarësisht diferencave në debatin dhe opinionet lidhur me aspektet e qeverisjes publike, parimet bazë të qeverisjes së mirë konsistojnë në: llogaridhënien, transparencën, performancën (eficiencën e efektivitetin), përgjegjshmërinë, barazinë, përfshirjen dhe zbatimin e ligjit. Tërësia e reformave të ndërmarra nga të gjitha institucionet ndërkombëtare të ndërlidhura me përmirësimin e qeverisjes publike kanë përmirësuar instrumentet e monitorimit dhe të vlerësimit të menaxhimit publik duke synuar rritjen e transparencës dhe kredibilitetin, të cilat janë faktor determinues të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Këto reforma kanë marrë në konsideratë kompleksitetin dhe specifikat e sektorit publik.

Duke adresuar pyetjen kërkimore mbi pasojat e qeverisjes dhe të keqqeverisjes për zhvillimin ekonomik në tërësi, Kaufman (*e të tjerë*) në vitin 1999 argumentoi nëpërmjet një studimi empirik duke përshirë 150 vende e bazuar në 300 tregues të qeverisjes një korrelacion të rëndësishëm midis mirë qeverisjes dhe rezultateve të zhvillimit, i cili është matur nga rritja e të ardhurave

për frymë, uljen e vdekshmërisë foshnjore dhe rritja e dijes (njohurive). Kështu, gjetjet treguan se nga ndryshimi në një nivel në rritje (zbritje) të treguesit të qeverisje është shkaktuar një rritje (zbritje) 2,5 – 4 herë e të ardhurave për frymë apo vdekshmërinë foshnjore dhe 15% - 25% rritje në nivelin e dijeve.

Me evidenca të qëndrueshme dhe përgjithësuese konkludohet se aspektet e cilësisë së qeverisjes së parasë publike kanë rëndësi jetike për zhvillimin dhe për rezultatet e zhvillimit, pra për mirëqenien e qytetarëve.

Auditimi i jashtëm publik - demokracia e mirë qeverisja

Teoria e ekonomike, bazuar në problemin e agjentit (menaxherit) dhe principalit (aksionerit), i derivuar nga ndarja e pronësisë nga kontrolli, ka argumentuar se një nga mekanizmat e qeverisjes së korporatës është llogaridhënia dhe transparenca. Midis aksionerit (publiku, qytetari që përfaqësohet nga parlamenti) dhe menaxherit (pra qeveria-ekzekutivi) ka informacion asimetrik, i cili i krijon mundësi menaxherit të ndërmarri veprime dhe/ose vendime jo tërësisht në favor të aksionerit. Në këto kushte instrumenti që duhet të sigurojë dhe të evidentojë shkallën e transparencës dhe të llogaridhënies së menaxherit është auditimi i jashtëm. Në rastin e sektorit publik, shkalla e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparenca e qeverisë apo ekzekutivit në përdorimin e burimeve publike vlerësohet dhe evidentohet nga auditimi i jashtëm publik, i realizuar nga institucionet supreme të auditimit, pra, institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit në Shqipëri.

Në këtë kontekst, auditimi i jashtëm publik luan rol të rëndësishëm në zbatimin e parimeve bazë të mirëqeverisjes, duke vlerësuar dhe realizuar transparencën për zbatimin e ligjit dhe eficiencën e efektivitetin e entiteteve publike në përdorimin e parasë publike. Por vetëm ekzistenca e një institucioni të auditimit të jashtëm publik është kusht i nevojshëm por jo i mjaftueshëm për të luajtur rolin e pritshëm për të forcuar mirëqeverisjen duke sjellë përfitime për qytetarin.

Llogaridhënia mund të realizohet në mënyrë efektive nga institucionet që janë të mbrojtura nga kuadri konstitucional, të pavarura nga pikëpamja strukturore, me autonomi funksionale dhe me kapacitete që veprojnë në mënyrë objektive, të drejtë e neutrale, të afta që të sigurojnë informacion të besueshëm dhe profesional legjislativit mbi

performancën e ekzekutivit në përdorimin e fondeve publike.

Gjithashtu, një faktor jetik për eficiencën e institucionit të auditimit të jashtëm publik është funksionimi i një sistemi efikas të monitorimit dhe të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të derivuara nga aktiviteti auditues nga legjislativi ose nga institucionet e ekzekutivit.

Gjithashtu, auditimi i jashtëm publik është një instrument dinamik që zhvillohet vazhdimisht si nga pikëpamja institucionale ashtu edhe nga pikëpamja metodologjike duke reflektuar stadet e zhvillimit politik dhe ekonomik të vendit.

Eksperienca e vendeve me demokraci të konsoliduar dhe me ekonomi të zhvilluar tregon se gjithnjë e më tepër auditimi publik konsiderohet si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit. Posty, T., (2007) nënvizon se për të patur një demokraci reale, aktiviteti auditues duhet që të ketë gjithnjë e më tepër fokus në cilësinë e qeverisjes dhe në vlerësimin objektiv dhe kritik të efektivitetit të programeve të politikave publike. Demokracia reale kërkon që vlerat themelore të demokracisë të jenë realisht pjesë e jetës së vendit ku elementi kyç bazohet në fakte dhe njohuri dhe informacion të mjaftueshëm për pasojat e ushtrimit të pushtetit nga ekzekutivi.

Referuar faqes zyrtare të Kombeve të Bashkuara përcaktohet se: "..qeverisja konsiderohet "e mirë" dhe "demokratike" në varësi të shkallës së transparencës që kanë institucionet e një vendi dhe proceset". Në këtë kontekst institucioni i auditimit të jashtëm publik mbështet konsolidimin e demokracisë nëpërmjet pushtetit të komunikimit më qytetarin duke informuar mbi vlerësimin objektiv dhe profesional të informacionit financiar dhe të përformancës të përdorur për vendimmarrjen nga ekzekutivi dhe legjislativi, apo parlamenti. Pra duke bërë transparencë mbi shkallën e llogaridhënies, i cili përfshinë detyrimin për të raportuar dhe siguruar mbi ligjshmërinë e veprimeve dhe të përdorimit të fondeve publike sipas destinacionit të paracaktuar, por jo vetëm. Llogaridhënia përfshinë transparencën dhe raportimin mbi rezultatet e arritura dhe për eficiencën e menaxhimit dhe të funksionimit në përdorimin e fondeve publike.

Sfidat e shekullit të 21 të komunitetit të EUROSAI-t është qasja e vlerësimit të "p*ërfomancës së shtetit*", ku

pritshmëria e qytetarit është rritja e cilësisë dhe e efktivitetit të parave që ata i paguajnë qeverisë si taksapagues. Në thelb ka një ridimensionim të së drejtave klasike të qytetarëve ku e drejta për cilësi, e drejta për eficiencë dhe e drejta për një administratë publike që të përformojë mirë, janë përcaktuese dhe të detyrueshme për tu zbatuar nga qeveritë dhe legjislativi i vendeve me demokraci reale, në këtë kontekst, auditimi i jashtëm publik përbën mbështetjen institucionale të së drejtave të qytetarëve për eficiencë, përfomancë dhe llogaridhënie të administratës publike, ekzekutivit dhe legjislativit (Posty, T., 2007).

Efektiviteti i auditimit të jashtëm publik për të siguruar dhe nxitur vlerat e demokracisë, mirëqeverisjen dhe nivelin e duhur të efektivitetit dhe performancës së menaxhimit të parasë publike kërkon një lidhje të ngushtë midis auditimit dhe përdorimit të gjetjeve të aktivitetit auditues nga qeveria dhe nga legjislativi gjatë procesit të analizës së buxhetit faktit të shtetit si dhe miratimit të projekt buxhetit. Auditimi i jashtëm publik është burimi thelbësor i besueshëm, objektiv dhe profesional të informacionit.

Impakti ex-ante i aktivitetit auditues të KLSH-së konsiston në faktin që Parlamenti, nëpërmjet Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave të realizojë një vlerësim objektiv dhe realist të buxhetit faktik dhe që mësimet e nxjerra prej tij të përdoren për të orientuar drejtë projekt-buxhetin. Në vendet me demokraci të konsoliduar si SHBA apo Gjermania, ushtrojnë të drejtën e tyre për të ndryshuar projekt buxhetin përgjatë procesit të vlerësimit dhe të votimit duke siguruar që përpara se të kthehet në ligj ky dokument është alokuar sipas prioriteteve kombëtare. Ndërsa në vendet me demokraci të dobët, parlamenti-legjislativi e kthen në ligj projekt buxhetin e paraqitur nga qeveria-ekzekutivi pa ushtruan në mënyrë demokratike dhe profesionale të drejtën e votës bazuar në opinionin dhe bindjen e formëzuar.

Impakti post-ante i aktivitetit auditues të KLSH-së konsiston në mënyrën se si anëtarët e parlamentit, më konkretisht Komisioni i Ekonomisë dhe i Financës përdorin informacionin e gjetjeve të auditimit të jashtëm publik nëse entitetet e ekzekutivit i kanë përdorur në mënyrë të ligjshme, me efektivitet dhe me efeciencë fondet publike të vëna në dispozicion siguruar në mënyrë objektive dhe profesionale

mbi përdorimin e fondeve publike nga entitet publike para se të shprehen me vendimmarrje për ligjin e buxhetit të shtetit të vitit të ardhshëm.

Instrumentet që mundësojnë rritjen e impaktit dhe forcimin e partneritetit me shoqërinë civile, qytetarin dhe publikun e gjerë është jo vetëm raportimi i Kryetarit të KLSH-së në Parlament, por transparenca dhe komunikimi i vazhdueshëm i Institucionit Supreme të Auditimit shqiptar për gjetjet kryesore të auditimeve dhe të raporteve të depozituara në parlament. Në reflektim të eksperiencave të përfituara përgjatë viteve, praktikave më të mira dhe udhëzimeve të diskutuara apo të publikuara nga Institucionet e Supreme të Audutimit pjesë të komunitetit të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, KLSH ka diversifikuar kanalet dhe instrumentat e komunikimit dhe të transparencës me qytetarin duke përbërë edhe një eksperiencë unike në komunitetin ndërkombëtar të SAI-ve.

Një nga instrumentat e transparencës dhe të komunikimit me qytetarin dhe publikun e gjerë, i cili përbën edhe elementin unik të SAI-t shqiptar është përfshirja e audituesve në publikimin e gjetjeve kryesore të punës së tyre audituese, në mediat e shkruar dhe në dy vitet e fundit edhe në median vizive. Statistikat e institucionit të auditimit të jashtëm publik shqiptar tregojnë se për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar në total 764 artikuj në pothuajse në të gjitha gazetat e vendit. Vetëm përgjatë vitit 2019, 90 auditues kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 122 shkrime.

Gjithashtu, përmbledhja e këtyre shkrimeve, duke krijuar në këtë mënyrë memorien institucionale botohen në mënyrë sistematike. Shkrimet e audituesve janë botuar në 12 volume të cilat, jo vetëm përfaqësojnë historikun e gjetjeve më të rëndësishme por dhe ndërlidhja e tyre me interesin e publikut duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.

Konkluzion

Qeverisja publike nuk mund të shikohet e shkëputur nga ligjësitë që ndikojnë në qeverisjen në përgjithësi, prandaj marrja në konsideratë e instrumenteve që ndikojnë në qeverisjen e korporatës është një qasje e përdorur gjerësisht nga studiuesit e fushës.

Sikurse u paraqit është e provuar edhe nga pikëpamja empirike se mirë qeverisja ka ndikim të rëndësishëm në nivelin e mirëqenies dhe të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të një vendi. Nga ana tjetër cilësia e

qeverisjes është e lidhur ngushtësisht me cilësinë e demokracisë së një vendi dhe u argumentua se një rol të rëndësishëm luan institucioni i auditimit të jashtëm publik dhe eficienca e tij. Në punim u paraqitën të dhëna statistikore mbi instrumentat e komunikimit dhe të transparencës të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni i auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, të cilat përbëjnë dhe specifikën unike të këtij institucioni krahasuar me institucionet e tjera supreme të auditimit të komunitetit të INTOSAI-t dhe të EUROSAI-t.

Matja e efekteve të impaktit të aktivitetit audites do të paraqitet në një punim vijues pasi studimi është në procesin e mbledhjes së të dhënave të detajuara sipas pyetësorit të ndërtuar për rastin studimor.

Biblografia

International Federation of Accountants (2001), "Governance in the Public Sector: A Governing Body Perspective", study paper 2001

Kaufman, D., Kraay, A. and Zoido-Lobation (1999), "Governance matters", *World Bank, Policy research working paper No. 2196*

Kontrolli i Lartë i Shtetit (2020) Raporti vjetor i performanceës së KLSH, draft

OECD (2016), *Supreme Audit Institutions and Good Governance: Oversight, Insight and Foresight, OECD Pubic Governance Reviews*, OECD Publishing, Paris

Solomon,J. (2007), *Corporate governance and accountability,*2nd edition, John Wiley&Sons, Ltd

Swarbrick, A. (2011) Efective public sector governance and how external publicauditing supports it, *a paper for the UCCI International Conference on Leadership*

United Nations Economic and Social Commission for Asia and Pacific – *What is good governance.*

Nga: Prof.Dr.Lindita Milo,

MSc. Amantia Patozi, KLSH

ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE EFEKTIVE TË PUNËS NDËRMJET PARLAMENTEVE DHE INSTITUCIONEVE SUPREME TË AUDITIMIT

Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) dhe parlamentet janë dy aktorët më të rëndësishëm në monitorimin e qeverisë për llogaridhënien në përdorimin e fondeve publike.

Nga: Bianca Brétéché dhe Alastair Swarbrick, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (SIGMA)

Publikuar në revistën e ECA, Nr.4, 2019

Në një shoqëri demokratike, përgjegjshmëria dhe transparenca janë përbërësit kryesorë për të ruajtur besimin e qytetareve në qeverisjen publike. Si Parlamenti ashtu edhe Institucioni Suprem i Auditimit (SAI) kanë një rol thelbesor në sigurimin e përgjegjëshmërisë, dhe shpesh janë partnerë në zinxhirin e llogaridhënies.

Bianca Brété dhe Alastair Swarbrick, punojnë së bashku si Këshilltarë të Lartë për menaxhimin e financave publike duke përfshirë auditimin e jashtëm, në programin SIGMA në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Mbështetur nga Jan-Pieter Lingen (i cili më parë punonte në ECA) janë autorët e një punimi të SIGMA-s, i cili shqyrton në detaje praktikat e aplikuara brenda BE-së dhe disa vendeve të tjera për zhvillimin e marrëdhënieve midis parlamenteve dhe SAI-ve.

Më poshtë do të njihemi me disa njohuri kyce nga kërkimi dhe identifikimi i praktikave më të mira të miratuara, të cilat mund të jenë të rëndësishme për shumë deputetë të rinj të Parlamentit Evropian (mbi 450), të cilët kanë marrë përsipër te

kryejne punën e tyre pas zgjedhjeve të Parlamentit Evropian në maj 2019.

Partnerë në mbajtjen e qeverive të përgjegjshme

Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) dhe parlamentet janë dy aktorët më të rëndësishëm në monitorimin e qeverisë për llogaridhënien në përdorimin e fondeve publike. Parlamentet zakonisht nuk kanë kapacitete ose ekspertizë për të shqyrtuar përdorimin e fondeve publike nga qeveritë. Ata mbështeten në pikëpamjen objektive dhe profesionale tek SAI-et për të siguruar informacion në lidhje me besueshmerinë e raporteve financiare dhe përdorimin e burimeve publike. Megjithatë, parlamentet do të përdorin punën e SAI-ve, nëse është me interes dhe e kuptueshme në një kontekst politik. Për përmbushjen e rolit të tyre brenda sistemit të llogaridhënies, është e rëndësishme që SAI-t, të sigurojnë që puna e tyre të jetë e rëndësishme, të shtojë vlera dhe të ketë ndikim, jo vetëm duke rishikuar dhe raportuar ato që kanë ndodhur, por edhe duke shikuar përpara, duke identifikuar se ku mund të bëhen përmirësime, dhe promovime te praktikave më të mira. Në këtë mënyrë, auditimi i sektorit publik kontribuon në përmirësimin e standardeve të qeverisjes, menaxhim dhe vendimarrje më të mirë dhe përdorimin më efektiv të parasë publike.

Dokumenti SIGMA nr. 54

Në 2017 SIGMA, mbështetur nga një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe BE (financuar kryesisht nga BE) duke u perqëndruar në 'Mbështetjen dhe përmirësimin e menaxhimit dhe qeverisjes', botoi Dokumentin SIGMA nr.54, duke ofruar udhëzime për SAI-t dhe parlamentet për zhvillimin efektiv të marrëdhënieve mes tyre.

Në këtë punim ne përshkruajmë dhe analizojmë standardet ndërkombëtare, faktorët kontekstual, si dhe veçoritë dhe praktikat në të gjithë Evropën, duke nxjerre në pah çështjet kryesore për marrëdhënie efektive dhe praktika më të mira të fushës. Ajo gjithashtu ofron manuale për forcimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet SAI-ve dhe parlamenteve. Raporti bazohet në kontributet e 33 SAI-ve nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE), vendeve kandidate, dhe kandidatëve të mundshëm të BE-së. Në punim përshkruhen standardet ndërkombëtare aktuale, të cilat vendosin pritshmëri të mëdha për SAI-t në lidhje me mënyrën se si ata raportojnë para parlamenteve për punën e tyre në auditim dhe

përpjekjet që duhet të ndërmarrin për të ndihmuar anëtarët e parlamentit për të kuptuar dhe përdorur raportet e auditimit. Gjithashtu kërkohet që SAI-t të jenë më të përfshirë dhe të angazhuara me Parlamentin, në mënyrë që të jenë të vetëdijshëm për pritshmëritë e tij dhe të sigurohen që parlamentarët të kuptojnë rolin e SAI-t dhe se si ata mund të përfitojnë nga puna e tij. Më tej ne identifikojmë një numër faktorësh që ndikojnë në këto marrëdhënie, të cilat duhet të merren parasysh kur kërkohet të zhvillohen angazhime praktike midis SAI-t dhe Parlamentit. Sfondi kushtetues dhe historik i SAI-t, sistemi parlamentar, organizatat qeveritare, dhe sistemi i buxhetit dhe kontabilitetit, të gjitha formojnë marrëdhëniet midis SAI-t dhe parlamentit.

Zhvillimi i marrëdhënieve efektive të punës

Në përgjigje të një studimi të bërë nga SIGMA në fillim të vitit 2016, 33 SAI-t u përgjigjën duke përshkruar se si i përmbushin pritshmeritë nga parlamentet e tyre. SAI-t gjithashtu siguruan informacion në lidhje me mënyrën se si parlamentet përdorin punën e tyre. Rezultatet e anketës konfirmojnë që të gjitha SAI-t rishikojnë në mënyrë të vazhdueshme se si mund të rrisin ndikimin e tyre duke zhvilluar procedura të reja në komunikim, duke rritur transparencën dhe duke qenë pro-aktiv. Diversiteti dhe larmia e praktikave të raportuara është një burim frymëzimi për çdo SAI që kërkon të përmirësojë marrëdhënien e tij të punës me parlamentin. Në një farë mënyre kjo vlen edhe për parlamentet të cilat duhet të bëjnë detyrën e tyre duke përdorur raportet e SAI-ve për mbajtjen e përgjegjësisë nga qeveria.

Marrëdhëniet efektive të punës fillojnë me mjete të ndryshme bashkëpunimi që në fazën e planifikimit të programeve vjetore dhe shumë-vjeçare të punës së SAI-ve. Shumica e SAI-ve i kushtojnë vëmendje auditimeve specifike që sugjerohen nga parlamenti, pavarësisht nëse ekzistojnë dispozita ligjore që parlamenti të kërkojë apo jo auditime. Për të arritur identifikimin e praktikave më të mira duhet të kemi një dakordesi me parlamentin në proceduren e konsultimit për auditimet dhe numrin e atyre auditimeve qe do te kryhen.Ato gjithashtu përfshijnë informimin e parlamentit për programin e punës së SAI-t, planin strategjik të auditimit, organizimin e mundësive që parlamenti të sigurojë rregullisht kontribut nëpërmjet komisioneve të posatçme dhe komisioneve te tjera, dhe pas

diskutimeve në parlament të identifikohen auditimet e mundshme. Themelet e marrëdhënies midis SAI-ve dhe parlamenteve janë raportet e auditimit që SAI-t dërgojnë në parlament. Ndërsa të gjitha SAI-et evropiane raportojnë në parlament, ka dallime të konsiderueshme midis vendeve se kur, si dhe sa shpesh e bëjnë atë. Praktikat e mira të miratuara nga SAI-t për raportimin në parlament përfshijnë:

- dorëzimin e raporteve në parlament dhe publikimin e tyre në të njëjtën kohë;
- sigurohen që raportet janë shpërndarë midis të gjithë anëtarëve/komisioneve përkatëse;
- ofrojnë prezantime dhe njoftime mbi raportet;
- përdorin njoftimet për shtyp për të nxjerrë në pah çështje të rëndësishme të përfshira në raporte;
- selektojnë raportet e dorëzuara në parlament ose këshillojnë se cilat raporte duhen zgjedhur për shqyrtim;
- marrin parasysh raporte tematike që mbledhin të dhëna nga auditimet e mëparshme.

Duke shkuar përtej ofrimit të raporteve

Shumë SAI-e shkojnë përtej dërgimit të raporteve në parlament dhe ndërmarrin nisma për të krijuar marrëdhënie të mira pune me parlamentet e tyre, për të rritur ndërgjegjësimin për rolin e SAI-ve dhe për të ndihmuar në kuptimin e raporteve të auditimit. Këto aktivitete komunikimi gjithashtu synojnë të rrisin vëmendjen e parlamenteve ndaj raporteve të SAI-ve. Praktikat e mira të identifikuara për komunikimin me parlamentet përfshijnë: mbajtjen e takimeve të rregullta, të plotësuara nga kontakte joformale në nivelin e punës dhe intervista; koordinimin e axhendave dhe orareve të raportimit; organizimin e konferencave, tryezave të rrumbullakëta dhe grupeve të punës; memorandume për mirëkuptimin për procedurat e bashkëpunimit; krijimin e një politike komunikimi; përmirësimin e mirëkuptimit ndermjet stafit. Marrëveshja më e zakonshme e bashkëpunimit midis parlamentit dhe SAI-t për mbajtjen e qeverive të përgjegjshme, konsiston në caktimin e kësaj detyre një komisioni parlamentar. Në të gjithë parlamentet evropiane, kjo detyrë u takon komisioneve të buxhetit ose komisioneve të veçanta të auditimit publik, të cilat mund të jenë komisione të përhershme ose nënkomisione. Në një numër vendesh, komisionet po luajnë një rol

në nxitjen dhe përdorimin e punës audituese të SAI-ve.

Figura 1 - Numri i parlamenteve sipas marrëveshjes së komisioneve për trajtimin e raporteve të SAI-ve



Identifikimi i praktikave të mira për marrëveshjet parlamentare përfshin:

- sigurimin e organizimit adekuat të përgjegjësive të komisionit për raportet e SAI-t;
- krijimin e një komisioni të specializuar ose nënkomisioni të auditimit;
- sigurimin e disponueshmërisë së stafit të mjaftueshëm dhe burime analitike në parlament;
- përfshirjen e komisioneve sektoriale, veçanërisht në trajtimin e raporteve të auditimit të performancës;
- përdorimin e një procedure zyrtare të miratimit të auditimit të zbatimit të buxhetit faktik si pjesë e ciklit buxhetor.

Ndjekja e rekomandimeve

Për të siguruar që puna e tyre audituese të arrijë rezultate dhe të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike, të gjitha SAI-t evropiane monitorojnë përcjelljen e vëzhgimeve të tyre dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportet e tyre të auditimit. Shumë SAI gjithashtu mbajnë një bazë të dhënash dhe publikojnë informacione mbi mënyrën se si institucionet publike të audituara veprojnë mbi gjetjet e auditimit. Praktikat e tjera të mira të identifikuara për procedurat përcjellëse përfshijnë raportimin për zbatimin e rekomandimeve në interval të caktuar, integrimin e sistemit të monitorimit në sistemin e planifikimit të auditimeve të rishikimit dhe të ndjekjes së zbatimit të rekomadimeve, dhe vëmendjen e veçantë për raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve në raportet e auditimit të performancës. Puna audituese e SAI-ve do të ketë më shumë ndikim nëse parlamentet gjithashtu ndjekin punën e auditimit në ushtrimin e mbikëqyrjes së tyre buxhetore mbi qeverinë. Shumë parlamente në Evropë kanë zhvilluar procedura përkatëse. Shembuj të praktikës së mirë përfshijnë:

- zhvillimin e procedurave standarde dhe orareve për diskutimin e SAI-ve në parlament;
- raporte që bëjnë të mundur nxjerrjen në kohe të konkluzioneve;

- caktimin e një raportuesi për raporte specifike të SAI-ve;
- organizimin e seancave dëgjimore me të audituarit;
- Kërkimin e planeve të veprimit nga qeveria, dhe përcaktimin e afateve për masat që duhet të merren për zbatimin e rekomandimeve;
- Konsiderimin e sanksioneve në rastet e mosrespektimit të rekomandimeve të SAI-ve;
- Kërkimin e raporteve nga qeveria për zbatimin e masave adekuate.

Pothuajse të gjitha SAI-t raportojnë në parlament për të siguruar llogaridhënie për punën e tyre. Kjo zakonisht bëhet përmes raportimit për aktivitetet dhe përdorimin e burimeve të tyre në vitin paraardhës, qoftë në një raport të veçantë vjetor të veprimtarisë ose në një kapitull të veçantë të raportit vjetor. Praktika e mirë në këtë drejtim përfshin sigurimin e parlamentit me një raport vjetor të audituar për llogaritë dhe përdorimin e burimeve dhe një raport vjetor për aktivitetet dhe zbatimin e programit të punës. Shembuj të tjerë përfshijnë rishikime në mënyrë të rregullt dhe vlerësime të kursimeve të bëra për sektorin publik.

Manual që ofron praktika të mira për marrëdhëniet e punës

Këto praktika të mira, të lidhura me standardet dhe parimet përkatëse, rezultojnë në një 'Manual për forcimin e marrëdhënieve të punës ndërmjet SAI-ve dhe parlamenteve', siç pasqyrohet në Shtojcën 2, të Dokumentit SIGMA Nr. 54. Për të qenë të qartë: ne nuk mendojmë se ka një "*masë unike*", në të cilën mund të përfshihen marrëdhëniet efektive ndërmjet SAI-ve dhe parlamenteve për të gjitha vendet dhe për gjithnjë, me kalimin e kohës marrëdhëniet do të duhet të riorganizohen. Por manuali mund të ndihmojë në kërkimin e instrumenteve ose procedurave të reja për të ruajtur dhe përmirësuar marrëdhëniet efektive të punës, të gjitha me qëllimin e mbajtjes së qeverive të përgjegjshme në menaxhimin e fondeve publike, në mënyrat më të mira të mundshme.

Përktheu: Amantja Patozi,

Audituese e parë

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Bianca Brétéché dhe Alastair Swarbrick, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (SIGMA)

ÇFARË KONTRIBUTI MUND TË SJELLË AUDITIMI I SEKTORIT PUBLIK NË GARANTIMIN E SHOQËRIVE ETIKE DHE TRANSPARENTE?

Qasja e SAI-t të Austrisë ndaj Objektivit të 16- të të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Kompetencat e gjëra audituese, së bashku me pritshmëritë e larta të qytetarëve austriakë, nënkuptojnë përgjegjësi të madhe për të kontribuar në një shoqëri etike dhe transparente.

Nga Ariane Holezek, Njësia e Auditimit kundër Korrupsionit, Përputhshmërisë dhe Menaxhimit të Riskut, Gjykata Austriake e Auditimit.

Marrë nga EUROSAI Magazine

Nr. 25, 2019

Roli dhe detyrat e Gjykatës Austriake të Auditimit

Gjykata Austriake e Auditimit (ACA) shqyrton nëse institucionet publike përdorin paratë e taksapaguesve me efiçience, efektivitet dhe ekonomicitet. Kompetencat e gjëra audituese, së bashku me pritshmëritë e larta të qytetarëve austriakë, nënkuptojnë përgjegjësi të madhe për të kontribuar në një shoqëri etike dhe transparente.

ACA merr plotësisht përgjegjësinë e saj duke kontribuar në uljen e korrupsionit ose për të promovuar institucione publike transparente dhe llogaridhënëse. Ajo vepron në linjë me Objektivin e 16-të të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) "Për të promovuar shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm, siguroni akses në drejtësi për të gjithë dhe ndërtoni institucione efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet", veçanërisht kjo nënvizohet në pikën 16.5 "Reduktimi i korrupsionit dhe ryshfeteve".

ACA mbështetet në qasjen: Krahas "kolonës tradicionale", asaj të frenimit të korrupsionit nga agjencitë ligjzbatuese, parandalimi si "kolonë e dytë" ka më shumë prioritet, së bashku me edukimin si "kolonë e

tretë", si p.sh. leksionet dhe seminaret. "Kolona e katërt", bashkëpunimi në nivel kombëtar, si dhe bashkëpunimi i rëndësishëm ndërkombëtar, si p.sh. brenda Grupit të Punës së INTOSAI-t për Luftën kundër Korrupsionit dhe Pastrimit të Parave, na jep një tablo më të plotë mbi qasjen e ACA-s.

Për implementimin e kësaj qasje strategjike, u morën disa masa organizative.

Krijimi i një Njësie së veçantë kundër Korrupsionit, për Përputhshmërinë dhe Menaxhimin e Riskut

Krijimi i një Njësie të veçantë kundër Korrupsionit, për Përputhshmërinë dhe Menaxhimin e Riskut në vitin 2018 tregon rëndësinë e promovimit të etikës dhe transparencës që synojnë implementimin dhe koordinimin e politikave kundër korrupsionit si dhe duke rritjen dhe shpërndarjen e njohurive rreth parandalimit të korrupsionit.

Në vitin 2012 dhe më parë, aspekti anti-korrupsion konsiderohej vetëm me raste në auditimin publik, por nuk kishte një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike se si do të auditoheshin sistemet e parandalimit të korrupsionit.

Në vitin 2013-2014, "Manuali mbi Auditimin e Sistemeve të Parandalimit të Korrupsionit", i bazuar në strukturën e sistemit të menaxhimit të përputhshmërisë, u zhvillua për të mbështetur grupet audituese në promovimin e integrimit sistematik të etikës dhe transparencës në procesin e auditimit. Parandalimi i konflikteve të interesit është një element thelbësor në auditimet e ACA-s dhe gjithashtu përfshihet në manual.

Në vitin 2015-2016, Manuali mbi Auditimin e Sistemeve të Parandalimit të Korrupsionit u aplikua plotësisht në auditimin e sistemeve të parandalimit të korrupsionit në katër Ministri Federale. Manuali u publikua gjithashtu në faqen kryesore të ACA-s.

Njësia kundër Korrupsionit, për Përputhshmërinë dhe Menaxhimin e Riskut u krijua me detyra të brendshme e të jashtme në vitin 2018. Si pasojë, Manuali i Sistemeve të Parandalimit të Korrupsionit u përdor në auditime të kryera në tre qytete të mëdha, çka bëri të mundur studimin e masave të ndryshme të marra nga

secili qytet për të parandaluar korrupsionit. Detyrat e mëvonshme të Njësisë janë auditimet brenda mandatit të saj special.

Për vite, raste të ndikimit të pajustifikuar në vendime politike dhe lidhjeve të dyshimta mes biznesit dhe politikës kanë shkaktuar mjaft diskutime në mbarë botën. Institucione të respektuara, si Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Këshilli i Europës kanë hartuar standarde dhe rekomandime për të garantuar transparencë dhe integritet në lobim. Auditimi publik i kohëve të fundit në Regjistrin e Lobimit dhe Advokimit, brenda Ministrisë së Drejtësisë, krahasoi bazat ligjore me standardet dhe vlerësoi implementimin e regjistrit, në veçanti koston, plotësimin me korrektesë të hyrjeve, përdorimin e mundësisë së pyetjeve nga qytetarët, si dhe arritjen e objektivave.

Financimi nga burime private është bërë më i rëndësishëm për administratën publike, si pasojë e tkurrjes së buxhetit në vitet e fundit. Administrata publike duhet, sidoqoftë, të evitojë çdo shfaqje të influencës së paligjshme. Pranimi i financimit është gjithashtu subjekt i rregullave strikte dhe duhet të shqyrtohet gjithmonë me kujdes të madh. Prandaj, auditimi aktual fokusohet në marrëveshjet financuese dhe procedurat brenda tre Ministrive Federale për të vlerësuar dobinë dhe përputhshmërinë me rregullat. Në veçanti, ky auditim publik ndihmon në përmirësimin e performancës, llogaridhënies dhe transparencës së subjekteve të audituara dhe gjithashtu ndihmon në parandalimin e riskut të korrupsionit dhe ryshfetit.

Qendra Përgjegjëse e ACA-s për Çështjet kundër Korrupsionit, e krijuar rishtaz, po harton gjithashtu Manuale mbi Sistemet e Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut. Aktualisht, sistemi i menaxhimit të përputhshmërisë, i bazuar në analizën e riskut, po zhvillohet dhe më tej brenda ACAs dhe një version i rishikuar i Manualit mbi Auditimin e Sistemeve të Parandalimit të Korrupsionit me më shumë shembuj praktikë do të publikohet së shpejti.

Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet INTOSAI dhe UNODC për luftën kundër korrupsionit

Në 23 janar 2019, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, znj. Margit Kraker dhe Kryetari i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, njëkohësisht Presidenti i SAI-t të Emirateve të Bashkuara Arabe, z. Harib Saeed Al Amimi, zhvilluan një vizitë në Zyrën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara

mbi Drogën dhe Krimin, (UNODC) në selinë e tyre në Vienë.

Qëllimi i përbashkët ishte nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet INTOSAI-t dhe UNODC me fokus luftën kundër korrupsionit. Përfaqësuesit u zotuan të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet INTOSAI-t dhe UNODC. Çështjet prioritare janë, nga njëra anë, implementimi i Axhendës 2030 dhe Objektivit të 16 – të të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me fokus të veçantë në luftën kundër korrupsionit, dhe, në anën tjetër, ofrimi i mbështetjes për shtetet anëtare të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe anëtarëve të INTOSAI-t, duke implementuar në mënyrë efektive Konventën. Sekretariati i Përgjithshëm mbështeti në mënyrë aktive negociatat.

Në 30 korrik 2019, vetëm gjashtë muaj më vonë, Memorandumi i Mirëkuptimit u firmos nga Drejtori Ekzekutiv i UNODC, z. Yuri Fedetov dhe Kryetari i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, z.Harib Saeed Al Amimi, për të inkurajuar bashkëpunimin e mëtejshëm në luftën e përbashkët kundër korrupsionit.

Këto dy shembuj tregojnë se në ç'mënyrë Gjykata Austriake e Auditimit, si Institucion Suprem i Auditimit të Austrisë por edhe si Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t, përpiqet të japë kontribut në Axhendën 2030 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Përktheu: Delor Prosi, Auditues i pare,

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Nga: Ariane Holezek, Njësia e Auditimit kundër Korrupsionit, Përputhshmërisë dhe Menaxhimit të Riskut, Gjykata Austriake e Auditimit.

TEKNOLOGJIA: MUNDËSITË PËR TË NDËRTUAR KAPACITETE, PËR TË FORCUAR MBIKQYRJEN

Teknologjia ka ndryshuar në mënyrën se si ne bëjmë biznes, se si manaxhojmë administrimin publik dhe marrëdhëniet njerëzore, dhe se si ne e analizojmë informacionin. Përparimet teknologjike kanë ndikuar gjithashtu edhe në rolin e audituesit me implikime të mëdha në mbikëqyrjen e qeverisë.

Nga :Nelson Shack Yalta,

Kontrollor i Përgjithshëm i SAI të Perusë dhe President i Organizatës së SAI-eve të vendeve të Amerikës Latine dhe Ishujve të Karaibeve.

Publikuar në INTOSAI Journal, Winter 2020

Teknologjia ka ndryshuar në mënyrën se si ne bëjmë biznes, se si manaxhojmë administrimin publik dhe marrëdhëniet njerëzore, dhe se si ne e analizojmë informacionin. Përparimet teknologjike kanë ndikuar gjithashtu edhe në rolin e audituesit me implikime të mëdha në mbikëqyrjen e qeverisë. Nga përdorimi i mjeteve të reja të tilla si analiza e të dhënave, Inteligjenca Artificiale (AI) dhe teknologjitë e ndërlidhura, Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) tani mund të analizojnë risqet ekzistuese në menaxhimin publik; të përcaktojnë prioritetet për proceset me risk më të lartë; të alokojnë kapacitetet operacional në mënyrë më eficiente në mnyrë që të kenë rezultate në parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e akteve për sjelljet korruptive dhe jashtë funksioneve të përcaktuara. Në dy vitet e fundit, Zyra e Kontrollit të Përgjithshëm të Republikës së Perusë (SAI i Perusë) ka ndryshuar mënyrën se si ushtrohet auditimi i qeverisë. Bazuar në analizat e informacionit dhe të dhënat e regjistruara në aplikacionet kompjuterike, SAI i Perusë tani planifikon dhe kryen auditime me eficiencë dhe efektivitet më të madh.

Për shembull, projektet në shkallë më të gjerë (mega-projektet) priren të kenë ndërhyrje me risk të lartë publik

për shkak të financimit dhe qëndrueshmërisë ekonomike, të cilave ju shtohen risqet sociale, politike dhe mjedisore që ato sjellin. Duke pasur parasysh këtë, Institucionet Sai i Perusë transformoi institucionin duke synuar në këtë mënyrë kryerjen e sigurt të auditimeve për mega-projektet, transformim i cili përfshinte krijimin e një divizioni të veçantë i cili mbikëqyr projektet të mëdha, ku përfshihen edhe modalitetet e specializuara të investimeve, siç janë partneritetet publike-private (PPP).

SAI i Perusë hartoi një model auditimi të çështjeve prioritare bazuar në:

- **"Matricën e rëndësisë relative"** - e përbërë nga kriteret që lidhen me ndikimin socio-ekonomik të një projekti – shumën e investimit, numrin e përfituesve, fazën e investimit ose afatin e projektit; dhe
- **"Matricën e riskut"** që identifikon faktorët e riskut që rrisin mundësinë e pasojave negative, përfshirë ato që mund të rezultojnë me humbje ose dëmtim të shtetit.

Faktorët e riskut janë:

- ekzistenca e auditimeve të mëparshme;
- sasia e shtojcave në kontratat e nënshkruara;
- numri i raporteve të lidhura me një projekt;
- shkalla e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në sektor specifik; si dhe progresi fizik e financiar, janë vlerësuar për të vendosur shkallën e rëndësisë.

Për çdo kriter dhe faktor risku, përcaktohet rezultati specifik (dhe vërtetohet me gjykimet e një eksperti) për sa i përket ndikimit socio-ekonomik, madhësisë së humbjes ose dëmtimit, si dhe mundësinë e shfaqjes.

Në vitin 2019, të gjitha mega-projektet që po implementohen në Peru (900 projekte që arrijnë afërsisht një vlerë prej 63.3 bilionë dollarë) u analizuan bazuar në modelin e auditimit të çështjeve prioritare. Rezultatet treguan se cilat projekte kishin ndikim më të lartë shoqëror, mjedisor dhe ekonomik dhe e lejuan SAI-n e Perusë të përqëndrohet më mirë në kapacitetin operacional të disponueshëm për ato projekte që kishin risqe më të mëdha socio-ekonomike.

Ndërkohë që Institucionet Supreme të Auditimit përdorin gjithmonë e më shumë teknologji të cilat janë të afta të analizojnë proceset e prokurimit

publik, procesi i mbikëqyrjes në mënyrë të pashmangshme do të sjellë nevojën për shërbime të reja auditimi që përgjigjen ndaj sasisë, frekuencës, kompleksitetit dhe mundësive në të cilat paraqiten dhe zbulohen risqet. Si i tillë, një ndryshim i mundshëm që mund të shndërrojë mbikëqyrjen e qeverive, çka do të thotë kalim nga mbledhja e fakteve të së shkuarës (ex post) drejt auditimit të njëkohshëm të risqeve të raportuara në kohë reale (ex dure).

Megjithëse modelet e riskut ndihmojnë në përcaktimin se ku dhe kur duhet të ndërhyhet, identifikimi i pikave më të rëndësishme ose fazave brenda proceseve specifike të ndërhyrjes publike rrisin efikasitetin e mbikëqyrjes. SAI i Perusë i plotëson modelet e tij të riskut përmes ***Modelit të Njëkohshëm të Kontrollit (MNJK)***, një mekanizëm i njëkohshëm, sistematik, multidisiplinar, jo-detyrues që përdor teknika të ndryshme dhe shfrytëzon ***Shkencën dhe Teknologjinë (S&T)*** për të vlerësuar fazat e procesit dhe objektivat. Ky model ndihmon në vlerësimin e shkallës se si proceset kryhen sipas rregullave, dispozitave të brendshme dhe kontraktuale si dhe përcaktimeve të tjera të zbatueshme.

SAI i Perusë ka patur disa përfitime përmes përmes kontrollit të njëkohshëm, të tilla si:

- rritja e aftësisë për të paralajmëruar zyrtarët ndaj risqeve të mundshme dhe situatave të pafavorshme, të cilat ndihmojnë në zbutjen në kohë pasojave;
- adresimi i shqetësimeve të qytetarëve përmes raportimit në kohë, i cili lehtëson angazhimin e palëve të interesuara, përmirëson transparencën dhe rrit besueshmërinë;
- përdorimi i ekipeve multidisiplinare për të aplikuar metoda të specializuara (teste topografike, matje gjeodezike dhe fotogrametri ajrore), të cilat pasurojnë shumë punën e auditimit përmes mbledhjes së të dhënave në kohë reale.

Përmirësimi i mbikëqyrjes së punëve publike ose aplikimi i penaliteteve, kontrolli i njëkohshëm rrit aftësinë për korrigjimin në kohën e duhur të situatave të pafavorshme. Për shembull, SAI Peru investoi më pak se 2.7 milion dollarë në auditimin e punëve për ndërtimin dhe rindërtimin pas fenomenit "El Niño" të vitit 2017. Zbatimi i ***Modelit të Njëkohshëm të Kontrollit*** rezultoi në shmangien e një

humbjeje të mundshme prej 26.5 milion USD për shtetin.

MNJK përfshin gjithashtu implikimet indirekte, të cilat janë të rëndësishme për performancën e menaxhimit publik. Përqasja e modelit mbi skudarat multidisiplinare duke përdorur S&T me qëllim evidentimin e aftësive suplementare në kohë reale për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet, përmirëson mbikëqyrjen dhe rrit zhvillimin e kapaciteteve manaxheriale si dhe redukton mundësinë e kryerjes së sjelljeve jashtë funksioneve të përcaktuara (përmes perceptimit të zbulimit të menjëhershëm).

Përfundime

Teknologjia sjell vëmëndje ndaj proceseve dhe sjelljeve menaxheriale, e cila përkthehet në rritje të kapaciteteve të Institucioneve Supreme të Auditimit për të përmirësuar mirëqeverisjen. Mundësitë që teknologjitë e reja ofrojnë në punën audituese me siguri do të vazhdojnë të modifikojnë mbikqyrjen sotëm dhe në të ardhmen. Ky realitet i afërt na detyron të vazhdojmë automatizimin dhe inovacionin e procedurave të auditimit me përafrim drejt arritjes së rezultateve të matshme që u sjellin dobi qytetarëve.

Përvojat e fundit të SAI-t të Perusë kanë gjeneruar përvoja të rëndësishme të përftuara nga zhvillimi dhe zbatimi i modeleve të riskut që udhëheqin performancën e auditimit dhe kanë rezultuar në një model të ri kontrolli (MNJK) duke përmirësuar më tej përpjekjet e mëdha përmes parandalimit të riskut dhe shmangies së tij.

Sfidat e S&T, të zakonshme për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit, bëjnë thirrje për bashkëpunim si një instrument themelor për transferimin e njohurive dhe shkëmbimin e praktikave të suksesshme.

Mësoni më shumë rreth SAI të Perusë duke vizituar faqen zyrtare të SAInë: http://www.contraloria.gob.pe/

Përktheu: Krisa Shenjtolli, Audituese e dytë

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga :Nelson Shack Yalta,

Kontrollor i Përgjithshëm i SAI të Perusë dhe President i Organizatës së SAI-eve të vendeve të Amerikës Latine dhe Ishujve të Karaibeve.

AUDITIMI DHE STRATEGJIA E TË DHËNAVE

Zhbllokimi i njohurive përmes kapitalizimit të mundësive, adresimi i sfidave

Të dhënat janë bërë një fjalë shoqëruese kyçe e auditimit, ashtu siç konstatohet edhe përmes përdorimit të shtuar të këtij termi në të gjithë komunitetin globale të llogaridhënies ku përfshihet edhe Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) si edhe anëtarët e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-t).

Nga: Koen Van der Bracht, Institucioni Suprem i Auditimit të Belgjikës

Publikuar në INTOSAI Journal, Winter 2020

Të dhënat janë bërë një fjalë shoqëruese kyçe e auditimit, ashtu siç konstatohet edhe përmes përdorimit të shtuar të këtij termi në të gjithë komunitetin globale të llogaridhënies ku përfshihet edhe Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) si edhe anëtarët e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-t). Ndërkohë të dhënat paraqesin mundësi të reja për Institucionet Supreme të Auditimit, ku përshihen edhe perspektivat interesante për më shumë auditime të bazuara në risk, e cilat prezantojnë gjithashtu edhe sfida të shumta konceptuale, teknike dhe organizative.

Ky artikull shpjegon disa nga mundësitë dhe sfidat e përdorimit të të dhënave duke sjellë një përmbledhje se si SAI Belg i adreson ato.

Mundësitë

Disponueshmëria e të dhënave dhe analitika e të dhënave kanë ndikuar në fushën dhe profesinin e auditimit, veçanërisht dixhitalizimi i proceseve financiare, i cili ofron teknika të reja të cilat lejojnë që Institucionet Supreme të Auditimit të auditojnë 100% të transaksioneve. Kjo aftësi rrit efiçencën e auditimit financiar dhe lejon audituesit të veçojnë transaksionet normale dhe anormale. Veçimi i transaksioneve anomale

krijon eficiencë shtesë, pasi audituesit nuk kanë më nevojë të auditojnë një kampion të madh që mund (ose nuk mund) të jetë përfaqësues.

Auditimi i Performancës fokusohet në përcaktimin e ekonomiitetit dhe eficiencës së programit. Sidoqoftë, të dhënat e disponueshme (dhe mjetet për ta analizuar më lehtë sasi më të mëdhe të dhënash) lejojnë audituesit të masin drejtpërdrejt efektivitetin e programit. Për shembull, kur auditohet një program për uljen e varfërisë, Institucionet Supreme të Auditimit mund të vlerësojnë tashmë ndryshimet aktuale në shkallën e varfërisë referuar ndërhyrjeve të qeverisë.

Sfidat

Përhapja e të dhënave dhe teknikat e reja paraqesin disa sfida që zakonisht mund të ndahen në tre kategori: konceptuale, organizative dhe teknike.

Sfidat Konceptuale

Disponueshmëria dhe vlefshmëria e të dhënave mbetet sfida kryesore konceptuale. Për të matur efektivitetin e politikave, audituesit shpesh mbështeten tek bazat e të dhënave qeveritare të hartuara për qëllime të ndryshme. Për shembull, informacioni për pjesëmarrjen në tregun e punës mund të rrjedh nga baza e të dhënave tatimore të cilat humbet informacioni thelbësor i nevojshëm për një auditim. Para kryerjes së vlerësimeve të informacioneve të grumbulluara nga bazat e të dhënave të qeverisë, është i nevojshme një studim mbi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e të dhënave.

Përndryshe, audituesit riskojnë të ngrenë pyejet e duhura, si dhe kryerjen e vlerësimeve të duhura për të arritur më pas në përfundime të gabuara për shkak të pasaktësive ose mangësive të të dhënave.

Sfidat Organizative

Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat vendosin të investojnë në analizimin e të dhënave ju nevojiten edhe veprime rregulluese për mënyrat si kryhen auditimet. Përvetësimi i aftësive të duhura është thelbësor dhe kërkon një analizë të plotë të nevojave në Institucionet Supreme të Auditimit. Këtu mund të përmendet p.sh., adresimi i llojit të analizës të të dhënave dhe personeli i nevijshëm, përfshirë aftësitë dhe njohuritë për administrimin e bazës së të dhënave, rregulloret e mbrojtjes së të dhënave, si dhe vizualizimi i të dhënave. Për më tepër, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të marrin në konsideratë sesi mund të fitohen këto aftësi: ose duke trajnuar stafin

aktual ose duke rekrutuar punonjës të rinj.

Adresimi i një sistemi organizativ me specifikë analizimine të dhënave është thelbësore dhe shumë opsione janë të realizueshme. Kështu me qëllim vazhdimësinë mund të bëhet alokimi i grupeve të specialistëve të të dhënave me qëllimin e kryerjes së analizës së të dhënave për grupe të ndryshme auditimi ose specialistë të të dhënave të përfshigen tërësisht në grupet e auditmit duke kryer auditime nga fillimi deri në fund dhe duke analizuar vetëm të dhënat për auditimin specifik ku janë përfshirë.

Sfidat Teknike

Gjatë analizimit të të dhënave në një kontekst auditimi, Institucionet Supreme të Auditimit mund të përballen me sfida teknike të cilat kërkojnë software të ri ose kompjuterë më të fuqishëm. Konsiderimi i hershëm i softeve të nevojshëm siguron përfitime të tilla si:

(1) minimizimi potencial i kostove përmes marrjes në konsideratë të nevojave aktuale dhe të ardhshme të auditimit;

(2) sigurimi i një pike referimi për aftësitë; dhe

(3) përzgjedhjen e zgjidhjeve të duhura për mbrojtjen e të dhënave.

Përzgjedhja e softwa-eve të rinj, gjithashtu kërkon kompjutera me performancë të lartë për çdo specialstë të analizimit të të dhënave, servera qendror për shumë përdorues ose zgjidhje me bazë cloud. Këto mundësi mund të varen gjithashtu edhe nga mënyra se si janë alokuar specialistët e të dhënave.

Nëse specialistët e të dhënave, për shembull, punojnë në auditime nga fillimi në fund, atëhetë do të ishtë më eficient përdorimi i serverave qendror ose sistemet cloud, pasi numri i specialistëve që do të bëjnë analizimin e të dhënave njëkohësisht do të ishte i kufizuar. Pavarësisht nga opsionet e software-ev dhe hardware-ve, mbrojtja e të dhënave gjithmonë do të duhet të adresohet.

Ndërkohë që mblidhen, redaktohen dhe ruhen gjithnjë më shumë të dhëna janë mbledhur, investimet në mbrojtjen e këtyre të dhënave bëhen më të rëndësishme, veçanërisht duke marrë parasysh natyrën e të dhënave personale dhe/ose sensitive.

Zgjidhja Belge

Plani strategjik i SAI-t të Belgjikës përqendrohet në matjen e drejtpërdrejtë të efektivitetit të politikave, të cila shpesh shkojnë krah për krah me analizën e të dhënave. Për të zbatuar këtë plan strategjik,

SAI përdor teknika të shumta, siç janë:

- Punësimin e shkencëtarëve me njohuri të thelluara në shkencat sociale të trajnuar dhe me aftësi për analizimin e të të dhënave;
- Kryerja e një studimi për të zbuluar përvojat dhe interesin për analitizimin e të dhënave në stafit ekzistues;
- Organizimi i një seance ndërkombëtare trajnimi për analizimin e bazës së të dhënave;
- Formimi i një grupi diskutimesh "DataLab" që ndihmon në përhapjen e metodologjisë së analizimit të të dhënave përmes takimeve mujore brenda institucionit, ku përfshihen trajnime, këshillime dhe ndihmë nga specialistë të të dhënave.

SAI Belg zgjodhi të atashojë specialistët e analizimit të të dhënave pranë grupeve të auditimit, ku ata kryejnë auditime nga fillimi në fund. Megjithatë, përmes DataLab, specialistët e të dhënave mbështesin gjithashtu ekipe që nuk kanë specialistë të analizimit të të dhënave. Për shkak se disa paketa software-sh përdoren njëkohësisht, SAI Belg vazhdon të përballet me sfida teknike. Si rezultat kemi një grup punonjësish me formim të larmishëm profesional të cilët përdorin software ekzistues të kombinuar me përdorimin e teknikave të reja të analizimit të të dhënave.

Aktualisht, SAI Belg po investon në kompjutera të centralizuar me kapacitet të lartë si dhe krijimin e një depo-je të të dhënave përmes gjuhës së strukturuar Query për të ruajtur të dhënat financiare të ardhurat nga administrata. Zyrtari i Organizatës për Mbrojtjen e të Dhënave ka krijuar një politikë për mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu po vlerësohen zgjidhjet e teknologjisë së informacionit me bazë cloud dhe zyrtari brenda SAI-t për mbrojtjen e të dhënave ka hartuar politika për mbrojtjen e të dhënave.

Përfundimet

Disponueshmëria dhe teknikat e të dhënave mund të ofrojnë mundësi të vlefshme për llojet e reja të auditimeve. SAI i Belgjikës i ka marrë në konsideratë plotësisht këto mundësi dhe përvojat e përfituara nxjerrinë në pah nevojën për: (a) hartimin e një strategji për analizimin e të dhënave dhënave; dhe (b) marrjen në konsideratë të sfidave të mundshme konceptuale, organizative dhe teknike.

Ndër kokë që SAI i Belgjikë i ka përjetuar të gjitha sfidat e përshkruara në këtë artikull, krijimi i

DataLab rezultoi thelbësor për adresimin e këtyre sfidave, veçanërisht pasi grupi i krijuar siguron një forum për strategjitë e shkëmbimit të ideve për të kapërcyer të gjitha sfidat dhe përdorur të gjitha mundësitë.

Përktheu: Krisa Shenjtolli, Audituese e dytë

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Koen Van der Bracht, Institucioni Suprem i Auditimit të Belgjikës

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

AKTIVITETE TË KLSH-së PËR PERIUDHËN SHTATOR - DHJETOR 2019

KLSH merr pjesë në takimin e nëngrupit të e-Qeverisjes të grupit IT të EUROSAI-t

Në datat 18 dhe 19 shtator 2019 në Lisbonë të Portugalisë u zhvillua takimi mbi Hapësirën e Kontrollit të e-Qeverisjes dhe Manualit Aktiv të Auditimit IT, i nën grupit IT të EUROSAI-t, ITWG, një nga grupet e punës më aktive të EUROSAI-t që ka si qëllim të nxisë Institucionet Supreme të Audimit të Evropës që së bashku të eksplorojnë ndikimet strategjike që vijnë si rezultat i zhvillimeve në fushën e teknologjisë së informacionit (IT), si në fushën e auditimit dhe në përdorimin e IT-së në administrimin institucional të SAI-ve.

Në takimin e organizuar nën kujdesin e Gjykatës së Llogarive të Portugalisë morën pjesë përfaqësues nga Polonia, Portugalia, Estonia, Letonia, Sllovakia, Bosnia dhe Herzegovina, si dhe një përfaqësues i GAO-s së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. KLSH u përfaqësua në këtë takim nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit z. Kozma Kondakçiu dhe audituesit znj. Elsona Papadhima dhe z. Delor Prosi.

Në datën 18 Shtator, z. Pawel Jan Banas, përfaqësues i NIK-ut të Polonisë, në emër të SAI-t kryesues të grupit të punës, pas fjalës se hapjes dhe falënderimit të Gjykatës së Llogarive të Portugalisë si vend pritës i këtij takimi, beri një prezantim të projekteve të nëngrupit të qeverisjes elektronike. Më pas pjesëmarrësit diskutuan mbi rëndësinë që ka për qeveritë që kërkojnë të aplikojnë

qeverisjen elektronike e-GOV, hartimi dhe zbatimi i një baze ligjore që rregullon përdorimin e IT në shërbimet publike, duke u siguruar që korniza ligjore të jetë në një hap me zhvillimet në këtë sektor. Ky diskutim u ndoq me shumë interes dhe vëmendje nga përfaqësuesit e KLSH pasi dhe Shqipëria ka një platformë shërbimesh digjitale si e-Albania.

Nga z.João Carlos Cardoso, përfaqësues i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë, u prezantua versioni web i Manualiti Aktiv të Auditimit IT (AITAM), një version i ri dhe i përditësuar. Dita e parë e takimit u përmbyll me prezantimin e z. Madhav Singh Panwar, përfaqësues i GAO së SHBA-ve mbi përditësimin e kapitullit të 5-të mbi IS/Siguria e informacionit në Manualin e Auditimit IT.

Në ditën e dytë, takimi vijoi me prezantimin e projektit IC-Watch nga z.Banas. Së bashku me z.Piotr Prokopczyk të NIK-ut të Polonisë, z. Banas prezantoi gjendjen e projektit CUBE për auditimet, duke e demonstruar atë dhe me shembuj konkretë të raporteve të auditimit të GAO-s së Shteteve te Bashkuara të Amerikës dhe NAO-s së Britanisë së Madhe. Në prezantimin e tij z. Banas theksoi se "CUBE (Control Space for e-Government) është një modul i dizenjuar nga SAI-t pjesëtarë të EUROSAI - IT Working Group, për të thjeshtuar dhe konsoliduar auditimin IT. Synimi i këtij moduli është që të kthehet në një bazë të dhënash inteligjente për raportet e auditimit, prej të cilit mund të aksesohen lehtësisht auditimet e qeverisjes elektronike e-GOV".

Në vijim, përfaqësuesit në takim u përfshinë në zhvillimin e ushtrimeve praktike nga auditime të marra nga CUBE për testimin e modulit të ngritur me bazë teknologjinë e inteligjencës artificiale për përzgjedhjen dhe vlerësimin gjetjeve kryesore të një projekti auditimi. Në fjalën përmbyllëse moderatorët e takimit, z. Pawel Jan Banas dhe z. João Carlos Cardoso, njoftuan se takimi i radhës i EUROSAI-t ITWG do të zhvillohet në tetor 2019 në Bratislavë të Sllovakisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës pranohet anëtare me të drejta të plota e INTOSAI-t

KLSH në Kongres: ZKA përmbush kushtet për të qenë vend anëtar. Nga data 23-27 shtator 2019 u zhvillua në Moskë Kongresi i XXIII-të i INTOSAI-t. Bordi Drejtues i INTOSAI-t në datën 24 shtator miratoi me shumicë votash pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Gjatë miratimit

të Raportit të Sekretariatit të INTOSAI-t në seancë Plenare në datën 25 shtator 2019, Kongresi votoi pro këtij raporti, duke konfirmuar përfundimisht anëtarësinë e ZKA në INTOSAI, që nga 1 janari 2020. Gjatë procesit të votimit në Kongres, SAI i Serbisë kundërshtoi anëtarësimin e ZKA-së në këtë institucion të rëndësishëm ndërkombëtar.

Përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbështetën fuqimisht vendimin e Sekretariatit të INTOSAI-t, duke theksuar që ZKA përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet për të qenë anëtar i INTOSAI-t. Ky qëndrim u mbështet edhe nga përfaqësuesit e SAI-ve të disa vendeve të tjera, veçanërisht nga GAO e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Zyra e Auditimit të Polonisë, të cilat kanë qenë gjatë viteve të fundit partnerët kryesorë të KLSH-së në rrugën e modernizimit institucional, si dhe SAI Suedez.

KLSH merr pjesë në Kongresin e XXIII-të të INTOSAI-t, zhvilluar në Moskë në datat 23-27 shtator 2019

Nga data 23-27 shtator 2019 u zhvillua në Moskë Kongresi i XXIII-të i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Në kongres morën pjesë 600 delegatë nga 168 SAI nga 194 anëtarë, përfaqësuese të të gjitha organizatave rajonale të INTOSAI-t.

Kongresi u përshëndet nga zj. Margaret Kraker, Sekretare e Përgjithshme e INTOSAI-t dhe Presidente e Gjykatës Austriake të Auditimit, si edhe nga Drejtuesit më të lartë të Federatës Ruse.

Bordi Drejtues i INTOSAI-t, në të cilin marrin pjesë SAI-t e 20 shteteve (Austri, SHBA, Emiratet e Bashkuara Arabe, Polonia, Argjentina, Peru, Samoa, Brazil, Norvegji, Federata Ruse, Arabia Saudite, Afrika e Jugut, Indi, Pakistani, Egjipti, Gaboni, Kina, Japonia, Bahamas, Portugalia,) zhvilloi në datat 23 dhe 24 takime pune që i paraprinë Kongresit të INTOSAI-t dhe në datën 24 shtator miratoi me shumicë votash pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, nga data 1 janar 2020. Propozimi u ideua dhe u mbështet fuqishëm nga

SAI-t e SHBA (GAO) dhe Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të autorizuar nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, mbështetën fuqimisht vendimin e Sekretariatit të INTOSAI-t, që drejtohet nga Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, të iniciuar nga GAO e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke theksuar që ZKA përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet për të qenë anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Ky qëndrim u mbështet edhe nga përfaqësuesit e SAI-ve të disa vendeve të tjera, veçanërisht nga Zyra e Auditimit të Polonisë (NIK), nëpërmjet z. Kutyla, Zv/President i NIK, i cili ka qenë gjatë viteve të fundit një nga partnerët kryesorë të KLSH-së në rrugën e modernizimit institucional, si edhe nga SAI i Suedisë.

Kongresi në ditët në vijim trajtoi dy tema kryesore: I.Teknologjia e Informacionit dhe roli i saj në zhvillimin e administratës publike;II. Roli i SAI-ve në Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

I. Teknologjia e Informacionit dhe roli i saj në zhvillimin e administratës publike

Në temën e I-rë u diskutuan shumë çështje të rëndësishme që lidhem me zhvillimet IT sepse në vitet e fundit këto zhvillime kanë ndikuar në mënyrë sinjifikative në jetën e qytetarëve në mbarë botën. Revolucioni teknologjik, në veçanti telefonia celulare, big data dhe inteligjenca artificiale janë në zhvillim të vazhdueshëm. Në këtë proces, zhvillet e reja teknologjike kanë sjellë rritje eksponenciale të të dhënave në forma të ndryshme, duke krijuar mundësinë që marrja e vendimeve publike të jetë më racionale dhe më eficiente. Nga diskutantët e ndryshëm gjatë zhvillimit të seancave plenare lidhur me këtë temë u trajtuan tematikat si më poshtë:

- Roli i IT në Administratën Publike;
- Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e administratës publike;
- Karakteristikat e Big Data;
- Roli i Big Data në përmbushjen e detyrave nga SAI-t;
- Sfidat që duhet të përballen nga Auditimi i Big Data.

Në përfundim të diskutimeve, problemet më të shpeshta me të cilat

ndeshen SAI-t në drejtim të zhvillimeve teknologjike janë “Sfidat teknologjike”, “Mungesa e profesionistëve”, “Mungesa e dizejnimit nga drejtuesit e nivelit të lartë për Audimet IT” dhe “Buxhet i pamjaftueshëm dhe investimet në IT”.

Aplikimi i metodave të Big Data Audit, si në operacionet qeveritare, në financat e qeverisë dhe në buxhet, si edhe në shërbimet sociale, kanë sjellë për disa SAI që i kanë aplikuar ndërtimin e modeleve përmes analizimit të Big Data, duke gjetur transaksione anormale dhe duke sjellë rezultate në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit.

II. Roli i SAI-ve në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në këtë seancë plenare diskutimi më i rëndësishëm ishte ai i z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA. Zoti Dodaro nënvizoi lidhjen mes 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Planit të Zhvillimit Strategjik të GAO-s, të cilat i referohen gjithashtu çështjeve vitale dhe relevante në SHBA.

Nëse i referohemi Programit të Riskut të Lartë, duke filluar që nga viti 1990, ky program është fokusuar në operacionet e qeverisë me risk më të lartë për mashtrime, vjedhje, abuzime, keq-menaxhim dhe kjo me qëllim që të përballojmë sfidat me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet.

Në drejtim të realizimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm-vijoi z. Dodaro- ne duhet të kemi një qasje të re, mënyra të reja të menduari dhe kapacitete të reja qeverisëse, të cilat janë esenciale për qeveritë kombëtare për të arritur objektivat kombëtarë, përfshirë ato të zhvillimit të qëndrueshëm.

Si përfundim mund të themi që duke adoptuar një qasje të plotë qeverisëse në auditimet e tyre, SAI-t mund të kontribuojnë në arritjen e prioriteteve dhe objektivave kombëtare, duke sjellë vlera dhe përfitime për palët e interesit dhe për qytetarët.

Në datën 27 shtator Kongresi miratoi Deklaratën e Moskës, me anë të së

cilës SAI-t anëtare të INTOSAI-t shprehen se:

- njohin Axhendën e Zhvillimit të Qendrueshëm të vitit 2030 të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombet e Bashkuara më 25 shtator 2015 dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombet e Bashkuara A / RES / 69/228 "Promovimi dhe nxitja e eficiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit";
- riafirmojnë angazhimin për të dhënë një kontribut të rëndësishëm të auditimit të pavarur për Agjendën e Zhvillimit të Qendrueshëm të vitit 2030 siç përcaktohet në deklaratën e Abu Dabi-it;
- pranojnë pavarësinë e SAI-eve si parakusht themelor për një kontribut efektiv për llogaridhënien, transparencën, qeverisjen e mirë, përdorimin e mirë të fondeve publike si dhe vlerat dhe përfitimet e SAI-eve në përputhje me ISSAI 12 dhe Plani Strategjik të INTOSAI-t 2017-2022;
- zbatojnë Kuadrin e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale.

Ata deklarojnë se drejtimet e ardhshme të auditimin publik varen nga angazhimi i fuqishëm i SAI-eve dhe INTOSAI-t për:

i. sigurimin e një mbikëqyrjeje të pavarur të jashtme për arritjet e objektivave kombëtare, përfshirë dhe ato që lidhen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm;
ii. përgjigjen në mënyrë efektive ndaj mundësive që sjell përparimi teknologjik;
iii. rritjen e ndikimit të SAI-eve në llogaridhënien e menaxhimit publik dhe transparencë.

Anëtarët e INTOSAIT ranë dakord për sa vijon:

1.SAI-et inkurajohen të kontribuojnë për rezultate më efektive, transparente dhe të përgjegjshme, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e përpjekjeve të qeverive të nevojshme për të mbështetur arritjen e objektivave kombëtare dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

2.SAI-et inkurajohen të zhvillojnë qasje strategjike të auditimit publik që mbështesin arritjen e objektivave kombëtare dhe objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

3.SAI-et mund të rrisin vlerën e auditimit publik duke zgjeruar përgatitjen e informacioneve të bazuara në auditim për çështje të rëndësishme dhe strategjike të

administratës publike si dhe funksione të qeverisë.

4.SAI-et mund të promovojnë parimin e aksesimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave, burimit të kodeve dhe algoritmeve.

5.SAI-et mund të synojnë përdorimin më mirë të analizës së të dhënave në auditime, përfshirë dhe adaptimin e strategjive për planifikimin e auditime të tilla, krijimin e grupeve me përvojë në analizimin e të dhënave dhe prezantimin e teknikave të reja në praktikën e auditimi publik.

6.SAI-et mund të nxisin mendimin eksperimental për të përmirësuar inovacionin dhe zhvillimin.

7.SAI-et mund të shtrijnë fokusin në:

(a) identifikimin e zonave të riskut me interes kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ndërgjegjësimin mbi rreziqet;

(b) nevojat për menaxhimin e risqeve sistemike në qeverisje, përveç risqeve operacionale, institucionale dhe risqeve të tjera të një entiteti të vetëm.

8.SAI-et inkurajohen të edukojnë audituesit e së ardhmes, të cilët mund të përdorin analizën e të dhënave, mjetet e inteligjencës artificiale dhe metoda të përparuara cilësore për forcimin e inovacionit dhe të veprojnë si aktorë strategjikë, shkëmbyes të njohurive dhe prodhues të largpamësisë.

9.SAI-et duhet të marrin në konsideratë gjetjen e më shumë mënyrave për të adresuar gjithëpërfshirjen kur kryejnë auditime që kanë si pikë kryesore Axhendën e vitit 2030, me parimin për të mos lënë askënd pas dhe agjendat e të tjera të zhvillimit.

10.SAI-et mund të rrisin ndikimin e tyre pozitiv duke vendosur një bashkëveprim produktivë me subjektin e audituar dhe duke forcuar bashkëpunimin e komunikimin me komunitetin akademik dhe publikun në përgjithësi.

Arritja e këtij vizioni kërkon angazhime nga SAI-et individuale, si dhe mbështetje bashkëpunuese për SAI-et nga të gjithë organet e INTOSAI, të tilla si Komitetet e Objektivave të veçantë, strukturat e INTOSAI-t, organizatat rajonale, IDI, Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisjes dhe Sekretariati i Përgjithshëm. Bashkëpunimi shumëpalësh dhe dypalësh midis SAI-ve do të vazhdojë të luajë një rol veçanërisht të rëndësishëm për të ndihmuar SAI-të të mbeten relevant.Në përfundim të këtij aktiviteti të rëndësishëm u vendos që Kongresi i ardhshëm i INTOSAI-t, INCOSAI XXIV të zhvillohet në Brazil.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm, KLSH u përfaqësua nga zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme; zj. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme dhe zj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

KLSH merr pjesë në Nën Komitetin e 11-të për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikave, BE – Shqipëri

Në datën 3 Tetor 2019 në Bruksel, u mbajt Takimi i Nën Komitetit të 11-të, BE- Shqipëri për Çështje Ekonomike - Financiare dhe Statistikat.

Axhenda e takimit për KLSH mbuloi diskutimin e zhvillimeve në KLSH për fushën "Auditimi i Jashtëm", Shtylla 6, në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014 -2020, për periudhën raportuese përgjatë 2018 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.
KLSH u përfaqësua me delegacionin e përbërë nga znj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme, znj. Albana Gjinopulli, Drejtore Departamenti dhe z. Gjovalin Preci, Drejtor i Drejtorisë së Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë.

Objekti i diskutimit u fokusua në katër aspektet kryesore që përfshinë çështjet: Progresi në implementimin e Ligjit të KLSH dhe eksperienca në zbatimin e manualeve të auditimit të përmirësuara së fundmi; Përgjithësimi i ndjekjes së Raportit Vjetor të KLSH; Vështrim i përgjithshëm i impaktit të perceptuar të punës audituese të KLSH dhe Roli i KLSH në luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit, situata e rasteve të raportuara nga KLSH në Prokorori.

Në përfundim të prezantimit nga ana e përfaqësuesve të Nënkomitetit u vlerësua puna e bërë nga KLSH dhe progresi i arritur në kuadër të raportimit dhe përmbushjes së kërkesave në fushën e auditimit të jashtëm në sektorin publik në Shqipëri. Kjo u reflektua në Deklaratën për shtyp të nënkomitetit ku u vlerësua se KE mirëpriti përpjekjet e Shqipërisë për të përmirësuar zbatimin në kohë dhe sistematik të rekomandimeve të auditimit.

Përfaqësuesit e Drejtorive të Përgjithshme (DG NEAR dhe DG Budget) në komentet mbi raportimin e KLSH, theksuan gjithashtu përpjekjet e KLSH për: përditësimin e kuadrit ligjor dhe përditësimin e manualeve të auditimit si kërkesa themelore për të siguruar prekuizitën e një SAI, "Pavarësinë" e institucionit dhe të audituesve. Po ashtu dhe zhvillimin metodologjik me një kuadër të plotë të manualeve, metododikave dhe udhëzuesve të auditimit sigurojnë që zhvillimi i kapaciteteve të realizohet në drejtimin e duhur dhe pritshmëritë të

përmbushen. Përpjekjet e KLSH për rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve u vlerësuan maksimalisht dhe Komisioni u njoh dhe me shkresën më të fundit që Kryetari i KLSH i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, duke theksuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e ngritjes se nën komisionit parlamentar për çështje të auditimit. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e DG-ve treguan interes të lartë për të mbështetur këtë iniciativë duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme për auditimin publik. Për këtë qëllim, në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022, nën shtyllën 7 për mbikëqyrjen e financave publike, krahas KLSH, KE ka kërkuar të përfshihet dhe është përfshirë dhe Kuvendi i Shqipërisë.

Një vlerësim i veçantë u paraqit nga z. Raymond Hill mbi impaktin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet KLSH dhe OJF, Institucioneve publike dhe organizatave profesionale dhe universiteteve. Argumentimi mbi bazën e implementimit të Strategjisë së Komunikimit të KLSH 2017 -2029, njohu përfaqësuesin e DG Budget me përfitimet e implementimit të Marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe veprimtarive të tjera që synojnë përfshirjen e grupeve të interesit sikurse është përfshirja e eksperteve në auditimet e KLSH, veprimtaritë konsultative në formën e sesioneve shkencore apo tryezave të diskutimit, Konferenca Shkencore, organizimi i Muajit të Hapur, shkëmbimi informacionit dhe shumë forma të tjera të komunikimit me atë të cilave KLSH synon që impakti i punës audituese të shkojë deri tek qytetari më i thjeshtë dhe anasjelltas "zëri i qytetarit të dëgjohet" dhe të vlerësohet, duke përmbushur moton " KLSH shërbestar i qytetarit".

Me gjithë arritjet që KLSH ka shënuar në vitet e fundit, rekomandimet e KE-së për auditimin e jashtëm mbeten dhe kanë si qëllim përmirësimin në drejtim të:

a.Sigurimit të implementimit të plotë të Kuadrit Ligjor të SAI-t;

b.Përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së punës audituese;

c.Përmirësimin e zbatimit në kohë të rekomandimeve të auditimit.

KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga SAI Çek dhe Gjerman mbi Objektivat Strategjikë të EUROSAI-t

Në datat 9-10 Tetor 2019 në Liberec, të Republikës Çeke u zhvillua takimi i 3-të i një prej drejtimeve kryesore të Planit Strategjik të EUROSAIt 2017-2023, për mbështetjen e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të

bashkëpunimit profesional (SG1). Ky takim u realizua me mikpritjen e SAI-ve bashkë-organizatore të Republikës Çeke dhe Gjermanisë. Në takim morën pjesë 36 përfaqësues nga 12 SAI-e të Evropës: Belgjika, Britania, Estonia, Çekia, Gjermania, Hungaria, Lituania, Portugalia, Spanja, Suedia dhe Turqia. Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga z. Muhamed Kavaja, z. Ryisim Xhaja dhe znj. Armanda Begaj.

Takimi filloi me një përmbledhje të zhvillimeve në Planin Operacional të EUROSAI-t, nga Gjykata Turke e Llogarive, si SAI që ka Presidencën e EUROSAI-t dhe Kryetari i Ekipit të Koordinimit, si dhe nga SAI-et e Çekisë dhe Gjermanisë.

Nga SAI i Tuqisë u prezantuan projekt-dokumentet mbi:

- Mbylljen e Projektit;
- Sigurimin e Cilësisë së Produkteve të EUROSAI-t,

Nga SAI-et e Gjermanisë, Çekisë, Belgjikës, Hungarisë dhe Britanisë së Madhe u prezantuan progres raportet për projektet:

1. Risi në EUROSAI;
2. Baza e të dhënave për auditimet e EUROSAI-t;
3. Baza e të dhënave për produktet e EUROSAI-t;
4. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit;
5. Trajnimet;
6. Projekt Grupi për menaxhimin e Cilësisë, etj.

SAI Cek prezantoi platformën BIEP– Benchmarking Information Exchange Project (Platforma e Shkëmbimit të Informacionit), e cila është një platformë që nxit bashkëpunimin ndërmjet SAI-ve, përmes shkëmbimit të ideve dhe përvojave në përdorimin e së njëjtës metodologji të auditimit dhe që synon të krahasojë indikatorët kryesorë të performancës (KPI) në kushtet specifike të vendeve të ndryshme.

Në fund të seancës u organizua një sesion shkëmbim idesh mbi bazat e të dhënave që përdoren në SAI-et anëtarë të EUROSAI-t, si dhe anketimet dhe pyetësorët e ndryshëm.

Dita e parë e takimit u përmbyll me një informacion të hollësishëm mbi Kongresin e XI-të të EUROSAI-t, që do të mbahet në Pragë në vitin 2020.

Dita e dytë e takimit të SG1 ishte kushtuar kryesisht në sesione diskutimesh dhe shkëmbime mendimesh për çështje të tilla si

integrimi i bazave të të dhënave EUROSAI për t'i bërë ato më miqësore dhe efektive. Në fund të takimit u përditësua Plani Operacional SG1.

Qeveria e Polonisë (Ministri i Jashtëm) Dekoron me Medaljen e Nderit "Bene Merito" Kryetarin e KLSH-së, z. Bujar Leskaj

Në datën 10 tetor në një ceremoni në mjediset e Ambasadës së Polonisë në Shqipëri, Ambasadori polak z. Karol Bachura i dorëzoi z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit medaljen "Bene Merito", me nr. Vendimi 69, dt. 12.08.2019 (Fletorja Zyrtare nr.189, pozicioni 1469), akorduar nga Ministri i Jashtëm i Polonisë Jacek Czaputoëicz.

Duke lexuar vendimin përkatës të Ministrit të Jashtëm Polak, për motivimin e vlerësimit të lartë, Ambasadori Bachura theksoi se *"Zoti Bujar Leskaj është një mik i shquar i Polonisë, promotor i dijes për vendin tonë në Republikën e Shqipërisë dhe mbajtës i Medaljes "Kalores i Urdhrit të Meritës të Republikës së Polonisë" (2017)".*

Më tej ambasadori polak nënvizoi se *"Me iniciativën e z. Leskaj doli Albumi me titull "100 simbolet polake - 100 vende, figura dhe ngjarje të rëndësishme për Poloninë, Evropën dhe botën"*. Versioni dy gjuhësh shqip-anglisht është botimi i parë kompleks në Republikën e Shqipërisë, që afron dhe ilustron historinë dhe simboliken polake. Botimi paraqet 100 vendet, ngjarjet, figurat dhe arritjet më të rëndësishme nga protagonistë polakë, që kanë ndryshuar Poloninë, Evropën dhe botën".

Z. Bachura u shpreh se në cilësinë e Kryetarit të KLSH, z. Leskaj ka intensifikuar bashkëpunimin me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Polonisë (NIK). Dëshmi e bashkëveprimit ka qene projekti dyvjeçar i binjakëzimit IPA 2013 me fonde të Bashkimit Evropian, realizuar nga NIK dhe institucioni i auditimit suprem të Kroacisë për zhvillimin e kapaciteteve audituese të KLSH, duke realizuar më shumë se 100 misione ekspertësh në Shqipëri dhe vizita studimore në

vendet e BE-së, duke përfshirë Poloninë.

Më tej, Ambasadori polak vazhdoi, duke cilësuar se *"Në tetor 2018, me rastin e 125 vjetorit të lindjes së Prof. Stanislav Zuber, zbuluesit polak të rezervave të naftës, gazit dhe shumë mineraleve në Shqipëri, i vdekur tragjikisht në burgjet komuniste në Shqipëri në vitin 1947, z.Leskaj organizoi në sallën e Akademisë së Shkencave një simpozium kombëtar për veprën e Prof. Zuber…Z. Leskaj është autor i shumë shkrimeve rreth rolit të Polonisë në arenën ndërkombëtare".*

Në fjalën e tij, z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH e falenderoi Ambasadorin Bachura dhe nëpërmjet tij qeverinë dhe popullin polak, për vlerësimin e dhënë. Ai u shpreh se: "*Kjo medalje është e dyta, pas asaj të Presidentit polak Duda dhe ndihem shumë i nderuar, pasi me popullin mik polak na lidhin shumë gjera: krenaria kombëtare, mikpritja, sinqeriteti, karakteri i fortë dhe integriteti. Ndihem thellësisht i vlerësuar, pasi janë me qindra studentet shqiptarë që kanë studiuar në Poloni dhe me dhjetëra prej tyre, disa prej të cilëve janë të pranishëm edhe në këtë sallë, janë personalitete të spikatura në fushat përkatëse në jetën tonë shoqërore, artistike dhe kulturore dhe ky vlerësim që m'u dha mua mendoj se u takon edhe atyre, për kontributin e dhënë. Ndihem tejet i obliguar nga ky nderim, për të bërë gjithnjë e më shumë e gjithnjë e më mirë, në promovimin e vlerave të shpirtit dhe qytetërimit polak.*

Historia polake, sikurse edhe historia e kombit shqiptar, ka njohur shumë ndarje dhe drama kombëtare. Nëse mund ta perifrazoj historinë polake me mazurkën, vallen kombëtare polake, Polonia në historinë e saj ka luajtur pesë mazurka të mëdha. Në vitin 1683, polakët luajtën "mazurkën" e parë, një rol vendimtar për shpëtimin e Vjenës nga rrethimi otoman dhe me këtë, edhe për shpëtimin e të gjithë Europës. Në 1920, polakët e shpëtuan Europën nga invazioni i Rusisë bolshevike, duke e ndalur Ushtrinë e Kuqe në hyrje të Varshavës. Kjo ishte "mazurka"e dyte. Në qoftëse nuk do të kishte qenë qëndresa polake dhe Ushtria e Kuqe do të hynte në Gjermani, ku lëvizja komuniste ishte shumë e fortë, e gjithë Europa do të ishte bërë bolshevike, duke përfshirë edhe Francën. Historia e

Europës dhe botës do të kishte qenë shumë më e ndryshme, nga ç'është sot.

Në vitet 1939-1945, Polonia si shtet dhe si komb, luajti ndoshta mazurkën më heroike të saj. Me qindra mijëra polake dhanë jetën në një nga qëndresat me madhështore të Luftës së Dytë Botërore, edhe pse vendi ishte i okupuar. Në kohën e Luftës së Ftohtë, kur Polonia dukej e nënshtruar, ajo luajti mazurkën e katërt madhështore me rëndësi për fatin e Europës dhe të Botës, me Papa Gjon Palin II (ose ndryshe polaku erudit, filozof dhe poet Karol Vojtila) si lider shpirtëror, i cili përgatiti revolucionet në Europën Lindore që përmbysën "Perden e Hekurt" komuniste, si dhe me qëndresën antikomuniste të Solidarnostit, të drejtuar nga Les Valesa.

Në vitet e demokracisë, asnjë vend tjetër ish-komunist nuk ka ecur më mirë se Polonia, në të gjitha fushat, atë të ndërtimit të institucioneve demokratike, të shtetit ligjor, të modernizimit të ushtrisë, të shoqërisë civile dhe të ekonomisë. Sot Polonia është faktikisht një fuqi e madhe europiane, vendi i pestë në Evropë për potencialin ekonomik, si dhe një shtyllë e rëndësishme e NATO-s në Europën Lindore".

Më tej z. Leskaj theksoi se *"Polonia është një vend mik i Shqipërisë dhe këtë e ka treguar me prova. Për të gjitha marrëveshjet për integrimin e Shqipërisë në strukturat euroatlantike, të cilat kanë pasur nevojë për ratifikim nga parlamentet e vendeve anëtare, Polonia ka qenë gjithmonë në grupin e parë të vendeve që i ka ratifikuar".*

Ceremonia, në të cilën ndodheshin të ftuar personalitete të jetës kulturore, artistike dhe shoqërore të Shqipërisë, që kanë studiuar dhe jetuar në Poloni, shumë analistë dhe njohës të kulturës dhe artit polak dhe auditues të KLSH-së, kaloi në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore.

KLSH merr pjesë në takimin e 3-të të Task Forcës së EUROSAI-t mbi Auditimin e Bashkive

Në datat 10-11 tetor, në Lisbonë të Portugalisë u zhvillua takimi i 3-të i Task Forcës së EUROSAI-t(TFMA) mbi Auditimin e Bashkive. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në cilësinë e anëtarit të TFMA, u përfaqësua nga audituesit, z.Alush Zaçe, znj.Marjola Llanaj, znj. Aulona Jonuzi dhe z. Redi Ametllari. Task Forca e EUROSAI-t mbi Auditimin e Bashkive mbledh në gjirin e saj rreth 28 SAI evropiane dhe konsiderohet si një nga takimet më të rëndësishëm në plejadën e aktiviteteve të zhvilluara nën ombrellën e EUROSAI-t.

Në vitin e tretë të zhvillimit të saj, takimi i TFMA kishte në fokus "Funksionet e ushtruara nga bashkitë"

dhe punimet u çelën me fjalën e Kryetarit të Gjykatës së Audituesve të Portugalisë, z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, si SAI mikëpritës i aktivitetit të TMFA. Në fjalën e tij, z.Caldeira e vlerësoi takimin e 3-të të TMFA si një organizim me rëndësi madhore për komunitetin e Institucioneve Supreme të Auditimit të Europës, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave mbi auditimin e bashkive mes SAI-ve të kontinentit të vjetër.

Përgjatë fjalës së tij, z.Caldeira informoi pjesëmarrësit mbi ndryshimet e reja që po ndërmerr Portugalia për të filluar një proces të ri decentralizimi të pushtetit lokal. Në dritën e këtyre ndryshimeve në Portugali, z.Caldeira theksoi se ky takimi i tretë i TFMA-së ofron një kontribut të çmuar për procesin e decentralizimit në njohjen e praktikave më të mira. Me vlerë për t'u theksuar është se Gjykata e Audituesve të Portugalisë është një SAI mike e KLSH-së dhe Kryetari z.Vitor Manuel da Silva Caldeira, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Europiane të Audituesve i është akorduar titulli "HONORIS CAUSA" nga Universiteti i Tiranës në vitin 2015.

Takimi u përshëndet edhe nga z.Arunas Dulkys, Kryetari i Zyrës së Auditimit të Lituanisë, SAI themelues i Task Forcës së EUROSAI-t mbi auditimin e bashkive. Në fjalën e tij, z.Dulkys vuri theksin në faktin se TFMA po bëhet gjithnjë e më shumë një forum protagonist dhe me jehonë në komunitetin e EUROSAI-t, ku përpos shkëmbimit të eksperiencave audituese, po luan një rol edhe në shkëmbimin kulturor mes pjesëmarrësve. Në diskursin e tij, z.Dulkys nënvizoi se auditimet e SAI-ve në pushtetin lokal përbëjnë një shtyllë të rëndësishme të mandatit auditues të Institucioneve Supreme të Auditimit, të cilat sjellin një vlerë të shtuar në përmirësimin e shërbimeve që qytetarët marrin nga pushteti lokal.Në takimin e moderuar nga znj.Jura Ivonaityte, nga SAI i Lituanisë u prezantuan punime mbi:

- Funksionet e bashkive dhe financimin e tyre efektiv;
- Alternativat për përmirësimin e funksioneve të bashkive;

- Kryerjen e auditimeve të përformancës mbi marrëdhëniet ndër-buxhetore (qendror-vendor).

Pjesë e takimit ishte edhe zhvillimi një workshop-i, ku pjesëmarrësve u kërkohej të zgjidhnin funksione, si p.sh mbrojtja shëndetësore, turizmi, mbrojtja e konsumatorëve për t'i argumentuar sipas disa kritereve, nëse duhej apo jo të përfshiheshin në kompetencat e pushtetit lokal.

Në ditën e dytë të takimeve, u prezantuan raportet mbi aktivitet e TFMA-së, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit kontribuoi në të gjitha raportet dhe anketat si më poshtë:

- Aktiviteti 1.1.1: Implementimi objektivave strategjikë, Përdorimi i të dhënave të bashkive";
- Aktiviteti 1.9.2: Mbledhja dhe sistemimi i informacionit mbi të ardhurat e bashkive;
- Aktiviteti 1.9.2: Ngritja e një data-baze mbi të dhënat e shpenzimeve të bashkive;
- Aktiviteti 1.9.3: Publikimi i të dhënave audituese mbi "Kompanitë me kapital shtetëror (vendor)";
- Aktiviteti 2.1-2.3: Sistemet e auditimit të brendshëm në shtetet anëtare të TMFA.

Në përmbyllje të aktivitetit, shtetet anëtare miratuan dhe draftin e aktivitetit preliminar për vitin 2020.

Nën patronazhin dhe organizmin e Gjykatës së Llogarive të Audituesve të Portugalisë, u zhvillua një tur turistik në zonën historike të Lisbonës, Belem, ku pjesëmarrësit e SAI-ve të TFMA-së patën mundësi të vizitonin sitet e famshme historike, si Kullën e Belemit dhe Monumentin e Zbulimeve.

Kryetari i KLSH-së merr pjesë në Konferencën e 11-të vjetore të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës

Në datat 14-15 tetor 2019, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) organizoi në Strugë Konferencën e 11-të vjetore të saj me temë : *"Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik".*

Në këtë konferencë morën pjesë SAI-t e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Suedisë, Malit të Zi dhe Gjykata Turke e Llogarive. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga një delegacion i kryesuar nga Kryetari i KLSH-se, z.Leskaj dhe nga z.Bashkim Arizaj, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qëndrore; z.Bexhet Zeqiri, Kryeauditues, Drejtoria e zbatimit të Standarteve dhe Kontrollit të Cilësisë; z.Aldo Kume dhe z.Altin Tafilaj, auditues.

Konferenca u organizua në dy panele dhe në panelin e parë u trajtua tema *"Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik"*. Fjalën përshëndetëse në këtë

Konferencë e mbajti z.Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm i ZKA-së. Ky panel u drejtua nga z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së; z. Dag Levin Sparr, Këshilltar i Lartë dhe Zyrtar Ndërlidhës për BE-në, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë; zj. Tanja Tanevska, Drejtore e Departamentit, Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe z. Haci Ömer Köse, Drejtor i Departamentit të Auditimit, Gjykata Turke e Llogarive.

Kumtesën e parë e mbajti z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, i cili e hapi fjalën e tij me urimet për anëtarësimin e ZKA-së në INTOSAI: *"Është nder dhe privilegj i veçante te marrë pjesë ne Konferencën e 11-të vjetore te Zyrës Kombëtare te Auditimit te Kosovës (ZKAK).*

Ky aktivitet vjen menjëherë pas 24 shtatorit 2019, datë kur Bordi Drejtues i INTOSAI-t miratoi në Kongresin e tij INCOSAI XXIII në Moskë, me shumicë dërrmuese votash anëtarësimin e institucionit më të lartë të auditimit publik të Kosovës, Zyrës Kombëtare të Auditimit në INTOSAI, në organizatën botërore të institucioneve supreme të auditimit. Anëtarësimi me të drejta të plota i ZKAK, i cili bëhet efektiv më 1 janar 2020, përbën pa dyshim jo vetëm suksesin më të madh në historinë e auditimit të jashtëm publik të Shtetit të Kosovës, por edhe një arritje në rrugëtimin për njohjen e institucioneve të Kosovës nga partnerët ndërkombëtarë".

Auditori i Përgjithshëm i ZKA-së, z.Osmani shprehu mirënjohje të thellë për kontributin që ka dhënë KLSH dhe veçanërisht Kryetari, z.Bujar Leskaj në anëtarësimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në INTOSAI.

Më pas Kryetari Leskaj u përqendrua në punën e KLSH-së në rritjen e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes publike. Kjo rritje ka përbërë një nga tre objektivat kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Qëllimi Strategjik 1 "Rritja e Impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të". KLSH e ka parë realizimin e

këtij qëllimi nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të auditimit, duke gërshetuar gjetjet dhe rekomandimet nga auditimet financiare, të rregullshmërisë dhe përputhshmërisë, me këshillat dhe sugjerimet e përmbajtura në auditimet e performancës. Gjatë vitit 2018, KLSH ka kryer 29 auditime financiare, 52 auditime rregullshmerie, 42 auditime përputhshmërie dhe 18 auditime performance, duke synuar me rekomandimet dhe këshillimet tona që KLSH të bëhet nxitës i ndryshimeve pozitive në administratën publike.

Duke e konsideruar veten si institucion shërbestar i qytetarëve dhe si agjent kryesor i Kuvendit për të garantuar mirëqeverisjen, KLSH ka dhënë rekomandime, të cilat mund të ndryshonin kulturën menaxheriale, sidomos në segmentet më fundore të organeve qeverisëse, duke u përpjekur që zbatimi i tyre të sillte cilësi më të larte në shërbimin e qytetarëve.

Zoti Leskaj vijoi diskutimin e tij duke u fokusuar tek *udhëheqja nëpërmjet shembullit*, e cila ka si parakusht të përpiqesh të jesh një organizate model sepse ne jemi të vetëdijshëm se mund të ndikojmë në përmirësimin e qeverisjes, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit institucional; tek Zhvillimi i Metodologjisë; në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore; zhvillimin profesional; rritjen e kapaciteteve të audituesve në auditimet financiare dhe në përdorimin e teknologjisë së informacionit në mbështetje të aktivitetit auditues; tek transparenca dhe komunikimi i institucionit me palët e interesit dhe veçanërisht komunikimi me Parlamentin e Shqipërisë, si partnerin më efektiv për të mundësuar zbatimin në praktikë të rekomandimeve nga auditimet.

Zoti Leskaj e mbylli diskutimin e tij duke duke iu referuar ISSAI 12 *"Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-të sjellësh ndryshimin në jetën e qytetarëve"*: *"...gjykoj se në si KLSH, në bashkëpunim të ngushtë me ZKA e Kosovës, jemi në një rrugë të përbashkët për forcimin e kapaciteteve tona audituese. Duke i uruar Konferencës punime te mbara, shpreh bindjen e plotë se, edhe nëpërmjet konsolidimit të praktikes së auditimeve të përbashkëta dhe paralele me ZKA-në e Kosovës, do të vijojmë të punojmë fort, në përmirësim të qeverisjes publike të dy vendeve tona dhe në përfitim të drejtpërdrejtë të qytetareve të Kosovës dhe Shqipërisë".*

Paneli i dytë u përqendrua në temën, ***"Sfidat në zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe rëndësia e komunikimit efektiv me palët e interesit"*** dhe kumtesat kryesore u mbajtën nga: z. Peter Welling, Shef i

Sektorit të Qeverisjes dhe Demokratizimit në OSBE - Misioni në Kosovë; z. Ilir Salihu – Zëvendësauditor i Përgjithshëm i ZKA-së; z. Visar Prebreza, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, BIRN; z. Ahmet Ismaili, Drejtor i Thesarit të Republikës së Kosovës; znj. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal; z. Driton Selmanaj, ish-kryetar, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe znj. Safete Hadergjonaj, ish-nënkryetare, Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kumtesat e të dy paneleve u ndoqën me interes nga pjesëmarrësit dhe pati shumë diskutime.

Workshopi i Grupit të Punës IT të EUROSAI-t, ITWG, mbi Hapësirën e Kontrollit të e-Qeverisjes dhe Manualin Aktiv të Auditimit IT, Bratislavë, 14-16 Tetor 2019

Në datat 14 - 16 tetor 2019 në Bratislavë të Sllovakisë u zhvillua takimi mbi Hapësirën e Kontrollit të e-Qeverisjes dhe Manualit Aktiv të Auditimit IT, i grupit IT të EUROSAI–t, ITWG, një nga grupet e punës më aktive të EUROSAI-t që ka si qëllim të çojë më tej shkëmbimin e ekspertizës ndër-institucionale dhe të përvojave midis SAI-ve në rajonin evropian, të inkurajojë zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta, të stimulojë SAI-t evropiane për të eksploruar pasojat strategjike të zhvillimeve të lidhura me IT, të promovojë bashkëpunimin në hartimin e auditimeve të lidhura me IT dhe të promovojë auditime të përbashkëta mes SAI-ve.

Në takimin e organizuar nën kujdesin e Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Sllovakisë morën pjesë përfaqësues nga Polonia, Portugalia, Estonia, Sllovakia, Mali i Zi, Bullgaria, Serbia, Turqia, Hungaria si dhe një përfaqësues nga Gjykata Federale e Llogarive të Gjermanisë.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga z. Benard Haka, Kryeauditues dhe audituesit znj. Elsona Papadhima dhe z. Redon Xhelilaj.

Workshop-i u hap me fjalën përshëndetëse të z. Karol MITRÍK, President i SAI-t të Sllovakisë, i cili theksoi rëndësinë e organizimit të këtyre workshop-eve si një nga mënyrat efektive për të ndarë eksperiencat më të mira ndërmjet SAI-ve dhe për të mësuar më shumë nga puna e përbashkët me njëri-tjetrin.

Në datën 14 tetor, z. Pawel Jan Banas, përfaqësues i NIK-ut të Polonisë, në emër të SAI-t kryesues të grupit të punës, pas fjalës se hapjes dhe falënderimit të SAI-t të Sllovakisë si vend pritës i këtij takimi, beri një prezantim të projekteve të nëngrupit të qeverisjes elektronike dhe arritjet e deritanishme.

Në ditën e parë u diskutua mbi platformën CUBE, për të cilën z. Banas prezantoi risitë e këtij projekti për auditimin, përfshirjen e teknikave të reja të kërkimit dhe evidentimit të rasteve me risk duke përdorur teknologji të reja si inteligjenca artificiale mbi raportet e auditimit, dhe duke e demonstruar atë dhe me shembuj konkretë të raporteve të auditimit të GAO-s të Shteteve te Bashkuara të Amerikës, NAO-s së Finlandës dhe NAO-s së Suedisë. Në prezantimin e tij z. Banas theksoi se "CUBE (Control Space for e-Government) është një modul i dizenjuar nga SAI-t pjesëtarë të EUROSAI - IT Working Group, për të thjeshtuar dhe konsoliduar auditimin IT. Synimi i këtij moduli është që të kthehet në një bazë të dhënash inteligjente për raportet e auditimit, prej të cilit mund të aksesohen lehtësisht auditimet e qeverisjes elektronike e-GOV", nga ku secili SAI mund të përthithë nga ndarja e eksperiencave ndërmjet SAI-ve. Dita vijoi me zhvillimin e disa detyrave praktike për testimin e modulit të ri të CUBE për përzgjedhjen dhe vlerësimin e rasteve më me risk të një projekti auditimi.

Në ditën e dytë takimi vijoi me prezantimin e projektit mbi Manualin Aktiv të Teknologjisë së Informacionit (AITAM) nga z.João Carlos Cardoso, përfaqësues i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë. Nga z. Cardoso, u prezantua versioni web i Manualit Aktiv të Auditimit IT (AITAM), një version i ri dhe i përditësuar. Dita vazhdoi me zhvillimin e një detyre praktike nga auditime të marra nga CUBE për ndërtimin e matricave kryesore për planifikimin e një projekti auditimi. Nga pjesëmarrësit u realizuan edhe disa testime përmes mobile në Manualin Aktiv të Auditimit IT (AITAM) në web.

Në ditën e tretë takimi vijoi me prezantimin e plug-in të reja për versionin web dhe impelemtimin e tyre

në Manualin Aktiv të Auditimit IT (AITAM) nga z.João Carlos Cardoso. Z. Cardoso shpjegoi mënyrën e funksionimit të tyre dhe lehtësirat që ato ofrojnë kur bëhen pjesë e auditimeve sa i takon vlerësimit të riskut.

Gjatë ditëve të zhvillimit të workshop-it, pjesëmarrësit patën mundësinë të merrnin pjesë edhe në disa nga aktivetet turistike të organizuara nga SAI i Sllovakisë.

Në përmbyllje të workshop-it tre ditor, moderatorët e takimit, z. Pawel Jan Banas dhe z. João Carlos Cardoso, realizuan një përmbledhje të të gjitha konkluzioneve të përftuara dhe falenderuan të gjithë pjesëmarrësit.

KLSH merr pjesë në Konferencën për Biodiversitetin dhe takimin e 17-të të Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimet e Mjedisit në Luksemburg

Në datat 22 - 24 tetor 2019 në Luksemburg, u zhvillua konferenca për Biodiversitetin, organizuar nga Auditori i Përgjithshëm i Estonisë, Kryetari i Grupit të Punës së EUROSAI për Auditimin e Mjedisit (WGEA) dhe Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA). Fokusi i kësaj Konference ishin aspekte të ndryshme të biodiversitetit dhe kryesisht shqetësimi për shkatërrimin e tij. Ky shqetësim është pasqyruar së fundmi edhe nga platforma ndër-qeveritare e politikës shkencore IPBES në raportin e saj global të vlerësimit, ku theksohet e ardhmja e zymtë e Evropës në këtë çështje. Ruajtja dhe përdorimi i biodiversitetit duhet të mirë menaxhohet në mënyrë që të parandalohet përkeqësimi i kontributeve të natyrës tek njerëzit dhe ruajtja e vlerave të saj. Konferenca e përbashkët u zhvillua me qëllim ofrimin e një mundësie për të mësuar rreth trendeve të fundit të politikave evropiane mbi biodiversitetin, si dhe mbi mundësitë dhe sfidat e auditimit për biodiversitetin.

KLSH u përfaqësua në këtë takim nga z. Alfred Cako, Kryeauditues dhe audituesit znj. Eva Kasmi dhe znj. Eneida Seraj.

Gjatë tre ditëve të zhvillimit të punimeve të konferencës, pati prezantime nga përfaqësues të SAI-ve të ndryshme, diskutime në grup, si dhe shkëmbime nga eksperiencat më të mira.

Në ditën e parë, fjalën e hapjes e mbajtën z. Klaus-Heiner Lehne, President i Gjykatës Evropiane të

Audituesve dhe z. Janar Holm, Kryetar i EUROSAI WGEA, Auditor i Përgjithshëm i Estonisë ku pasi shprehën falenderimet e tyre, vunë theksin mbi problematikat kryesore dhe ndikimet negative në biodiversitet. Nga diskutimet e ditës së parë rëndësia u vu në statusin dhe kërcënimet kryesore për biodiversitetin, politikat, rezultatet dhe strategjitë përkatëse në Bashkimin Evropian, si dhe përmirësimi i situatës në Evropë në tërësi.

Në ditën e dytë u zhvilluan prezantime nga SAI të ndryshëm pjesëmarrës në konferencë ku u shkëmbyen eksperiencat mbi auditime të ndryshme të kyera rreth çështjes. Përfaqësuesit e KLSH-së sollën si praktikë të mirë auditimin e performancës mbi Zonat e Mbrojtura Detare, auditim ky paralel i kryer gjatë vitit 2018 midis SAI-ve Qipro, Maltë, Greqi, Portugali dhe Spanjë. Gjatë këtij prezantimi pjesëmarrësit u njohën me situatën e përgjithshme dhe mangësitë për sa i përket menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri, si dhe sfidat që hasen në mirë menaxhimin e tyre. Gjatë prezantimeve, SAI-t pjesëmarrëse, zhvilluan bisedime në formën e pyetjeve edhe mbi përfitimet e tyre nga këto auditime bashkëpunuese.

Në ditën e tretë dhe të fundit, diskutimet u fokusuan mbi menaxhimin e mbetjeve, ndryshimet klimaterike, si dhe mbi principin "Ndotësi paguan". Gjithashtu, u zhvilluan edhe punime në grup në formën e brainstorming mbi masat e nevojshme për zbatimin e Strategjisë së EUROSAI WGEA 2020-2023.

KLSH merr pjesë në Workshopin me temë "Administrimi i mjedisit në vendet anëtare të BE-së kundrejt sistemit tregues të vlerësimit" të zhvilluar në Bruksel

Në datën 22 tetor 2019 në Bruksel, Belgjikë, u zhvillua workshopi me temë "Administrimi i mjedisit në vendet anëtare të BE-së kundrejt sistemit tregues të vlerësimit". Workshopi organizohej nga Komisioni Europian në kuadër të Forumit të Qeverisjes dhe Përputhshmërisë Mjedisore ku EUROSAI, WGEA është observator.

Qëllimi i këtij workshopi ishte zhvillimi i mëtejshëm mbi bazën e rezultateve të projektit të qeverisjes së mjedisit, përzgjedhja dhe aplikimi i indikatorëve të përshtatshëm për transparencën, përfshirjen e publikut, aksesin në drejtësi, sigurimin e përputhshmërisë dhe efektivitetit në shtetet anëtare të BE-së, të cilat do të përdoren për monitorimin e qeverisjes së mjedisit dhe të performancës të qeverisjes të mjedisit.

Në këtë workshop morrën pjesë përfaqësues të Drejtorisë së

Përgjithshme për Mjedisin në Komisionin Europian, Bankës Botërore, Institutit për Politikat Europiane të Mjedisit (IEEP), Austrisë, Gjermanisë, SHBA, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Holandës, Beligjikës, Polonisë, Bullgarisë etj.

KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga z.Luan Kuka, Auditues i Lartë dhe z.Orgest Levani, Auditues i Parë.

Workshop-i u hap me fjalën përshëndetëse të z. Joachim D'Eugenio, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme për Mjedisin në Komisionin Europian, i cili theksoi rëndësinë e organizimit të këtij workshopi si një nga mënyrat efektive për të ndarë eksperiencat më të mira ndërmjet shteteve anëtare të BE dhe grupeve të interesit. Ai paraqiti objektivat specifike të cilat ishin:

- Zhvillimi i një kuadri indikatorësh të përbashkët dhe të qëndrueshëm për qeverisjen e mjedisit;
- Krijimi i një sistemi informal monitorimi (p.sh data flow) i shoqëruar me publikime të shpeshta si pjesë e Revistës së Implementimit të Mjedisit (EIR);
- Të sigurohet që një kuadër i tillë indikatorësh të jetë multi-funksional;
- Të ndihmoj monitorimin e progresit dhe demonstrimin e rezultateve të arritura nëpërmjet indikatorëve, të cilat mund të ndihmojnë në implementimin e fushave të ndryshme të politikave mjedisore.

Më pas, workshopi vazhdoi me prezantime të ndryshme rreth konceptit të qeverisjes së mjedisit nga të cilat, brenda 5 dimensioneve që formojnë bazën për vlerësimin e qeverisjes së mjedisit, u identifikuan 22 tema ndër të cilat përfshihej dhe një temë e ndërlikuar kontekstuale që shqyrton strukturat e qeverisjes.

Sesioni i pasdites i filloi punimet me një panel-debat lidhur me 5 dimensionet (1. transparenca, 2. përfshirja e publikut, 3. aksesi në sistemin e drejtësisë, 4. sigurimi i përputhshmërisë dhe llogaridhënia, si dhe 5. efiçenca dhe efektiviteti). Me anë të pyetjeve të parashtruara dhe përgjigjeve të dhëna nga katër grupet e formuara u formuluan avantazhet dhe disavantazhet e qeverisjes së mjedisit, vlerësimit të qeverisjes së mjedisit nga shtetet anëtare të BE-së, si dhe u bë krahasimi i informacionit të mbledhur dhe një përmbledhje esenciale e çështjeve më të rëndësishme në mënyrë që ky informacion të përdoret në nivel europian.

Përpjekja për të kategorizuar dhe vlerësuar performancën e Shteteve Anëtare të BE-së në pesë dimensionet ishte e dobishme si një mjet për të

ilustruar dhe përmbledhur rezultatet, për të identifikuar modelet, si dhe për të identifikuar ato vende me sisteme më të përparuara në dimensione specifike. Ndër të tjera, u nxorrën në pah disa sfida kërkimore të cilat mundësuan formulimin e rekomandimeve se si korniza e vlerësimit mund të zhvillohet më tej. Gjithashtu, u vërejt se qeverisja mjedisore është një fushë dinamike, dhe përpjekjet për përmirësim janë ndërmarrë në shumë shtete anëtare, të cilat mund të çojnë në ndryshime në kategorizimin e performances së qeverisjes mjedisore. Takimi u përmbyll me konkluzione të rëndësishme për të gjithë pjesëmarrësit.

Audituesit e KLSH-se zhvillojnë një vizitë studimore në Dubrovnik

Mbi bazën e motos së INTOSAI-t "Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë", rrugëtimi i radhës për audituesit e KLSH ishte Kroacia. Zyra Kombëtare e Kroacisë është një ndër SAI-t me të cilët KLSH ndër vite ka një bashkëpunim të ngushtë, e cila është konkretizuar në shkëmbimin e eksperiencave nëpërmjet takimeve, trajnimeve, seminareve, pjesërmarrjen aktive në Konferencat Shkencore të KLSH-së dhe në vitet 2016-2018 në zbatimin e projektit të BE-së, IPA 2013.

Në vijim të këtyre bashkëpunimeve u organizua një vizitë studimore në Zyrën Rajonale në Dubrovnik në datën 30 tetor 2019, për shkëmbimin e praktikave më të mira në lidhje me auditimin e Buxhetit të Shtetit. Nga KLSH morën pjesë 8 përfaqësues nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit: Znj. Alketa Kallesha, Znj. Elida Kocani, Z. Rigels Guzi, Znj. Helena Solis, Znj. Eriola Hoxha, Z. Alban Polovina, Z. Redon Xhelilaj, Z. Xhein Xhindole, të cilët kanë punuar dhe për përgatitjen e Raportit të Buxhetit Faktik që u dorëzua në Kuvendin e Shqipërisë në Tetor 2019. Zyra Rajonale e Dubvronikut, një ndër 20 zyrat Rajonale të Kroacisë, zë një peshë të konsiderueshme si në kryerjen e

auditimeve financiare ashtu dhe atyre të përputhshmërisë dhe performancës. Në këtë vizitë studimore audituesit e KLSH u pritën nga Kryetari i Zyrës Rajonale të Dubrovnikut dhe audituesit e saj. Kjo vizitë studimore u zhvillua në formën e prezantimeve të materialeve dhe diskutimeve 2-palëshe në lidhje me procedurat e auditimit, ngjashmëritë dhe ndryshimet mes dy SAI-ve, si mënyra më e mirë për rritjen e njohurive dhe shkëmbimin e eksperiencave që do të kontribuojnë edhe më tepër në përmirësimin e punës audituese në të ardhmen. Ashtu si çdo SAI, edhe Dubrovniku me KLSH, i zhvillojnë procedurat e auditimit në varësi të Ligjit të Brendshëm të tyre, INTOSAI-t, rregulloreve, udhëzimeve të ndryshme, Kodit të Etikës, etj.

Gjatë kësaj vizite studimore një vëmendje e vecantë iu kushtua fazave të kryerjes së auditimeve dhe përzgjedhjes së Institucioneve që do të auditohen mbi bazën e riskut dhe materialitetit. Përfaqësuesit e dy SAI-ve sollën një përqasje të auditimeve më kryesore të kryera përgjatë vitit 2019, duke sjellë në vëmendje rëndësinë dhe peshën e tyre në buxhetin e Shtetit. Një fakt i rëndësishëm nga SAI i Dubrovnikut ishin ndryshimet ligjore të vitit 2019. Sipas këtyre ndryshimeve rekomandimet që lihen në çdo raport auditimi për Institucionet, nuk kanë më karakter thjesht rekomandues, por duke filluar nga ky vit janë me karakter detyrues për zbatim. Në bashkëpunim të ngushtë me sistemin gjyqësor, në raste të moszbatimit të rekomandimeve të lëna brenda afatit të përcaktuar, Institucioneve të audituara u vendoset një gjobë në raport me shkallën e rekomandimeve që nuk kanë zbatuar. Nga ky përmirësim ligjor, SAI-Kroat synon rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve, kontrollin mbi Institucionet publike dhe përmirësimin e punës në administratën kroate.

Vizita studimore u mbyll me falenderime për shkëmbimin e eksperiencave duke rikujtuar dhe njëherë se të ardhmen vërtet nuk mund ta kemi nën kontroll, por me përpjekje të përbashkëta dhe kolektive ne mund ta krijojmë atë.

KLSH merr pjesë në seminarin me temë "Të kontribuosh në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në sferën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave"

Në datën 30 tetor 2019, Grupi i Punës i EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat dhe SAI i Serbisë organizuan në Beograd seminarin me

temë: “Të kontribuosh në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në sferën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave”. Në të morën pjesë përfaqësues nga SAI-t e Ukrainës, Serbisë, Turqisë, Polonisë dhe Rumanisë, ndërsa KLSH u përfaqësua nga audituesit Ermira Vojka, Arminda Bushi dhe Dorel Balliu.

Ky seminar u organizua në vijimësi të takimit të V-të që u zhvillua në Tiranë në datat 24-25 prill 2019, dhe në kuadër të implementimit të objektivit strategjik nr. 3 të Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat “Të kontribuosh në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”. Seminari kishte në fokus të diskutimeve çështjet aktuale që lidhen me parandalimin dhe eliminimin e pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave.

Ndër prezantimet që u paraqitën dhe u diskutuan ishin prezantimi i rezultateve të auditimeve të kryera nga SAI i Polonisë dhe Ukrainës por me interes u ndoq edhe prezantimi i ekspertes së jashtme znj. Olena Tkach me temë “Pasojat e ndryshimeve klimaterike-menaxhimi i riskut të fatkeqësive”. Në këtë prezantim vihej theksi tek pasojat që kanë sjellë ndryshimet klimaterike në rritjen e riskut nga fatkeqësitë dhe lidhjen që ka menaxhimi i riskut ndaj fatkeqësive në nivel lokal-kombëtar dhe global.

Seminari përfundoi me mesazhin se roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në parandalimin dhe eliminimin e pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave është shumë i rëndësishëm. SAI-t me anë të auditimeve të kryera ndërgjegjësojnë qeveritë që të ulin riskun e prekjes nga fatkeqësitë dhe të vënë theksin që një pjesë e fondeve të alokuara të shkojnë për kërkime dhe studime shkencore që ndihmojnë parandalimin dhe ulin mundësinë për të ndodhur fatkeqësitë.

KLSH merr pjesë në konferencën Young EUROSAI në Londër

Në bazë të suksesit të Konferencës së parë të Young EUROSAI të zhvilluar në Roterdam në nëntor të vitit 2013, audituesit e rinj në mbarë Europën iniciuan një praktikë të vazhdueshme të shkëmbimit të eksperiencave me njëri-tjetrin. Vizioni ishte që të organizohej një Konferencë që i jep përfaqësuesve të Institucioneve Supreme të Auditimit (rreth 35 vjeç e poshtë) mundësinë për të shkëmbyer

ide dhe zgjidhje të reja për sfidat me të cilat përballen Institucionet Supreme të Auditimit, sot dhe në të ardhmen.

Për vitin 2019 Konferenca Young EUROSAI u zhvillua në Londër në datat 5-8 Nëntor. Tema e përzgjedhur për këtë vit ishte "Relevanca". Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme nga organizatorët lidhet me kushtet në të cilat veprojnë Institucionet Supreme të Auditimit.

Sot karakterizohemi nga rrjedhja e shpejtë e informacionit, ndërkohë që kushtet teknologjike, sociale dhe politike janë në ndryshim të vazhdueshëm dhe automatikisht edhe SAI-t duhet t'i përshtaten këtyre ndryshimeve.

KLSH u përfaqësua nga z.Azmi Stringa, Drejtor Departamenti, znj.Eriola Hoxha, Audituese dhe znj.Erjola Meçaj, Audituese.

Gjatë Konferencës, audituesit pjesëmarrës së bashku me Organizatorët eksploruan sfidat që SAI-t përballen sot duke ndarë praktika, projekte dhe inovacione për zgjidhjet kryesore të secilit institucion në mënyrë që të vazhdojnë të mbeten relevante.

Në ditën e parë të Konferencës, datë 5 Nëntor, të ftuarit në panel ishin:

-Lord Bichard KCB, i cili pas fjalës përshëndetëse në Konferencë ndau disa njohuri duke e vënë theksin në rëndësinë që secili SAI duhet të ketë për të marrë parasysh ndryshimet në shoqëri gjatë punës audituese.

-Meg Hillier, foli për rolin kritik të Parlamentit në Mbretërinë e Bashkuar që nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm se në këto kohë sfidash për ecurinë politike dhe ekonomike.

-David Hencke paraqiti një tablo interesante të ndryshimeve më të fundit, vecanërisht të NAO.

-Gareth Davies ndau perspektivën e tij unike si Kontrollues dhe Auditor i Përgjithshëm i sapoemëruar mbi sfidat e ardhshme në fushën e auditimit.

-Nik Kirby foli për rëndësinë e besimit të publikut, demokracisë dhe kuptimin e zyrtarit publik me integritet.

-Presidenti Seyit Ahmed Baş, Kryetar i Gjykatës së Llogarive të Turqisë i cili gjithashtu mban dhe pozicionin e drejtuesit të EUROSAI-t, ndau sfidat e përbashkëta për SAI-t dhe theksoi qëndrimin e duhur për çështjet në zhvillim në matjen e cilësisë së auditimit.

Në ditën e dytë të Konferencës, datë 6 Nëntor, audituesit pjesëmarrës u ndanë në grupe për të punuar në Workshop-e sipas temave të përzgjedhura që gjatë fazës së regjistrimit si pjesëmarrës në Konferencë. Përfaqësuesit e KLSH ishin

pjesëmarrës në Workshop-et e mëposhtme:

Ndikimi i SAI-ve, si mund të bëhemi ndikues?

Lituania dhe Izraeli drejtuan këtë seancë ku hulumtuan mënyrat për të ndihmuar në rritjen dhe shpërndarjen e informacionit si dhe përcaktimin e identitetit dhe vlerave të SAI-ve, duke përshtatur mesazhe për grupe të ndryshme të interesit. Ata gjithashtu sugjeruan përdorimin e grafikëve dhe zhvillimin e raporteve më të shkurtër.

Si munden SAI-t të qëndrojnë relevante me ndryshimet e legjislacionit?

Përfaqësuesit e Kroacisë ndanë njohuri të tilla si ata auditojnë financiarisht partitë politike dhe ndajnë gjetjet sipas vlerave të tyre në raport me paratë dhe me Parlamentin.

Inovacionet në auditimet e partive politike

Spanja solli si inovacion sistemin e auditimit të partive politike si një proces solid për mbledhjen e të dhënave.

Liberalizimi i parimeve të auditimit

Ky workshop u prezantua nga Bjellorusia ku ata shpjeguan parimet e tyre të auditimit dhe se si përfshijnë organizatat publike dhe private. Një nga zgjidhjet e prezantuara ishte dhënia e mundësisë organeve të audituara për përmirësim përpara penalizimit.

KLSH u përfaqësua duke prezantuar dhe drejtuar Workshop-in me temë "Rëndësia e auditimit të BIG DATA (të dhënave të mëdha)" i cili u prezantua nga Drejtor i Departamentit z.Stringa.

Prezantimi përmbante:

-Një prezantim i përgjithshëm i SAI-t të Shqipërisë;

-Auditimi dhe raportimi për Ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit-Përmbledhje e Ekonomisë dhe Buxhetit të Shtetit Shqiptar-Çështjet kryesore në Ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit;

-Roli i Big Data në auditimet e KLSH, ku u prezantuan 3 raste studimore:

- Përdorimi i Big Data në auditimin e Ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit;
- Përdorimi i Big Data në auditimin e Procedurave të Prokurimit;
- Përdorimi i Big Data në auditimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Z.Stringa me rastet praktike tregoi për përfaqësuesit e SAI-ve pjesëmarrës në këtë workshop se si auditimi i mbështetur në analitikën e të dhënave, po ndryshon mentalitetin dhe metodologjinë tradicionale të auditimit duke identifikuar zonat me risk të lartë në mënyrë që të mbyllen boshllëqet për abuzim dhe si u përdorën me sukses Big Data-t për të audituar Buxhetin e Shtetit, pa të cilat do të ishte e pamundur arritja e auditimeve të suksesshme dhe analiza e veprimtarisë mashtruese si një mënyrë thelbësore për të siguruar që auditimi mbetet efektiv. U theksua nevoja e trajnimeve të vazhdueshme, trajnime të cilat KLSH u ka kushtuar një vëmendje të veçantë për të siguruar rritjen e kapaciteteve audituese dhe aftësisë së njerëzve për të përdorur këto të dhëna.

Përdorimi i të dhënave të mëdha në auditimin e Buxhetit të Shtetit ka provuar të ketë vlerë të shtuar nisur nga rezultatet e arrira dhe aktualisht KLSH është duke punuar në zgjerimin e përdorimit të dhënave të mëdha në fushat e tjera të auditimit.

Në ditën e tretë dhe të fundit të Konferencës pyetjet e ngritura gjatë zhvillimit të workshop-eve morën përgjigje dhe Audituesit e SAI-ve u bënë më të qartë në lidhje me misionin e tyre për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Nëpërmjet “brain storming” në këtë Konferencë u identifikuan sfidat më të rëndësishme me të cilat përballen sot Institucionet Supreme të Auditimit si dhe zgjidhjet ndaj tyre:

1. Si mund Institucionet Supreme të Auditimit të qëndrojnë të rëndësishme për audiencën e tyre? SAI-t duhet të marrin në konsideratë se kush është audienca e tyre dhe cilat janë karakteristikat unike të një Institucioni Suprem Auditimi që e bëjnë atë të rëndësishëm. Hipoteza jonë fillestare na ka shtyrë të përcaktojmë audiencën tonë: qeverinë, median dhe publikun. Karakteristikat unike të një Institucioni Suprem të Auditimit janë se ai është i pavarur, transparent dhe i besueshëm.

2. Si mund të sigurojnë Institucionet Supreme të Auditimit pavarësinë e tyre nga presionet e publikut, mediave dhe qeverisë?

Liria për të dhënë gjykime të balancuara dhe të pavarura të auditimit është ajo që e bën rolin e Institucionit Suprem të Auditimit kaq të veçantë. Në kohët tona moderne, nevoja për një vlerësues të drejtë, të ekuilibruar dhe të pavarur bëhet gjithnjë e më thelbësore. Që gjykimet e auditimit të jenë relevante, të besueshme dhe efektive, ato duhet të jenë të lira nga ndikimi i jashtëm.

3. Si mund të sigurojnë Institucionet Supreme të Auditimit që puna e tyre të besohet në vazhdimësi nga publiku, media dhe qeveria?

Debati rreth 'lajmeve të rreme' ka sjellë një rritje të mosbesimit ndaj burimeve të informacionit dikur shumë të besueshëm. Institucionet e larta të auditimit mund të mos jenë imune nga ky mosbesim në rritje dhe është e rëndësishme të eksplorohet ajo që duhet të bëjmë për të siguruar që të vazhdojmë të jemi Institucion i besuar nga publiku.

4. Si mund të vazhdojnë të vlerësohen Institucionet Supreme të Auditimit si të besueshme?

Rëndësia e Institucionit më të lartë të auditimit është fort e lidhur me besueshmërinë e tij si një Institucion. Pavarësia dhe transparenca e diskutuar më lart, padiskutim që sjellin të dyja besueshmërinë e një Institucioni.

Në përfundim të Konferencës, organizatorët theksuan se sa e rëndësishme është për Institucionet e Auditimit që ta rinovojnë vazhdimisht veten e tyre, në mënyrë që të kenë po atë forcë, pushtet dhe impakt tek palët e tyre të interesit.

Workshop për auditimin dixhital nga institucionet supreme të auditimit

SIGMA zhvilloi në Shkup të Maqedonisë së Veriut, në datat 6 dhe 7 Nëntor 2019, një workshop me rrjetin e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) të vendeve kandidate për BE dhe Gjykatën Europiane të Audituesve(ECA).

Workshop-i u organizua në bashkëpunim me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë Veriore dhe u përqendruan në auditimin dixhital.

Tryeza e rrumbullakët mblodhi SAI-t e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Mali të Zi, Maqedonisë së Veriut, Serbisë dhe Turqisë.

Në takim u theksua se zhvillimi gjithnjë e më shumë në dekadën e fundit i teknologjive dixhitale kryesisht për ofrimin e shërbimeve publike ka hapur mundësi të reja për qytetarët dhe njëkohësisht ka projektuar sfida të reja për Institucionet Supreme të Auditimit, pasi ato duhet të adresojnë problematika dhe çështje që lidhen me epokën dixhitale. SAI-et duhet të

marrin në konsideratë dixhitalizimin e operacioneve qeveritare dhe shërbimeve publike në planifikimin e punës së tyre, dhe të ekzaminojnë se si ato zhvillojnë aftësitë dixhitale, mjetet dhe teknologjinë për të ofruar produkte auditimi më me ndikim në mënyrë të efektshme dhe efektive.

Objektivat kryesore të workshop ishin krijimi i një platforme për diskutim në mes të SAI-ve të rrjetit në lidhje me:

a.sfidat me të cilat përballen gjatë dixhitalizimit të operacioneve qeveritare dhe shërbimeve publike;

b.mjetet dixhitale dhe teknologjia që ata mund të përdorin për të mbështetur punën e tyre;

c.si këto institucione supreme të auditimit të ndërtojnë kapacitetet dhe aftësitë përkatëse për auditimet digjitale.Workshop-i ishte interaktiv, ku u diskutua rreth eksperiencave dhe prezantimeve të SAI-ve pjesëmarrëse.

Ekspertët nga SAI të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE) specifikisht Skocisë dhe Letonisë, informuan pjesëmarrësit për praktikat që ata ndiqnin në zhvillimin e auditimeve dixhitale.

SAI-et e rrjetit shkëmbyen përvojat se si ata, po zhvillojnë teknologjitë e informacionit dhe auditimin dixhital.

KLSH në këtë workshop u përfaqësua nga z. Alfred Leskaj, znj. Anxhela Kosta, znj. Klea Saliu dhe znj. Angjela Nesturi.

Pas prezantimeve të eksperteve të vendeve të BE dhe përfaqësuesit të ECA-s, në ditën e dytë të workshop-it, KLSH prezantoi eksperiencën në auditimet e Teknologjive të Informacionit duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet e nxjerra gjatë auditimit të platformës dixhitale "e-Albania", prezantimi u bë nga Audituesi i Lartë z. Alfred Leskaj.

Tryeza e rrumbullakët gjithashtu u dha pjesëmarrësve mundësinë për të diskutuar dhe krahasuar përvojat kombëtare dhe për çështje specifike për auditimet dixhitale midis rrjetit të SAI-ve të vendeve kandidate të BE-së.

KLSH merr pjesë në takimin e parë për rakordimin e auditimit paralel me fokus "Ndotja e menjëhershme e deteve"

Në datat 12-13 nëntor u zhvillua në Rijeka, Kroaci, takimi i parë për rakordimin e auditimit paralel me fokus "Ndotja e menjëhershme e deteve". Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të zyrave të auditimit suprem të Shqipërisë, Kroacisë, Sllovenisë, Italisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës. Ideja e një auditimi të tillë lindi nga bashkëpunimi i mëparshëm, në kuadër të projektit IPA, i drejtuesve të auditimit të performancës në SAI-et e Kroacisë dhe Shqipërisë, konkretisht z. Božo Vuletić-Antić dhe z. Rinald Muça. Mbështetur në suksesin e dy auditimeve të performancës në bashkëpunim me SAI-n kroat, realizuar në periudhën 2017-2018, auditimit mbi "Zhvillimin Strategjik të Turizmit" dhe atij mbi "Cilësinë e ndërtesave shkollore" dhe në përmbushje të motos së INTOSAI-t "Nga Eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë", u konkludua se një fushë me interes potencial për të shtrirë bashkëpunimin e mëtejshëm është ajo mjedisore dhe veçanërisht ajo e pasurive të përbashkëta natyrore, siç është deti Adriatik.

Me nismën e Presidentit të rizgjedhur të SAI-t kroat, z. Ivan Klešić, auditimi u vendos të zgjerohej në një auditim rajonal, duke ftuar të marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e vendeve që lagen nga deti Adriatik. Takimi në Rijeka i shërbeu pikërisht njohjes së problematikave të përbashkëta në menaxhimin dhe mbrojtjen e këtij aseti

natyror, fokusimin e auditimit në një temë të posaçme dhe dakordësimin e një kalendari pune për vitin 2020, vit në të cilin parashihet të realizohet ky auditim.

Ditën e parë të takimit, pas prezantimeve të z. Damir Zec, profesor në Universitetin e Studimeve Detare në Rijeka dhe z. Vedran Martinić, drejtor i qendrës për Kërkim dhe Trajnim mbi Gatishmërinë dhe Përgjigjen ndaj Ndotjes së Menjëhershme Detare, përfaqësuesit audites dakordësuan që auditimi paralel duhet të fokusohet pikërisht mbi ndotjen e menjëhershme të detit Adriatik. Ndotje të tilla shkaktohen zakonisht nga katastrofat natyrore në det, mbytja e anijeve të tonazhit të rëndë, mungesa e masave parandaluese apo keqmenaxhimi i masave ekzistuese për të shmangur evente të tilla me impakt negativ në mjedis, etj. Ndonëse në detin Adriatik nuk kanë ndodhur ngjarje të përmasave të tilla që të klasifikohen si emergjenca mjedisore, rritja e aktivitetit tregtar, zhvillimi i vendeve që lagen nga ky det dhe faktorët mjedisorë që gjithnjë e më tepër po impaktojnë negativisht klimën globale e atë rajonale, mund të shpien në katastrofa mjedisore, përmasat e të cilave mund të shumëfishohen nga karakteri i mbyllur i detit Adriatik dhe mosmarrja në kohë e masave parandaluese e të ndërhyrjes së shpejtë.

Nëse dita e parë e aktivitetit u fokusua në njohjen e problematikave dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për rëndësinë e çështjes potenciale për auditim, në dytën e dytë u diskutua mbi anën teknike të realizimit të auditimit. Konkretisht u diskutua që, për të ruajtuar karakterin autonom të trajtimit të çështjes, auditimi të marrë formën e një auditimi paralel dhe jo të një auditimi të përbashkët. Kjo nënkupton që çdo vend pjesëmarrës do të përgatisë një raport individual auditimi, në përputhje me mandatin dhe planin e vet të punës, duke e prezantuar tek ato palë interesi që SAI i gjykon të arsyeshme. Gjithashtu, metodologjia audituese do të jetë individuale. Më pas, do të përgatitet një raport sintetik, ku do të përmblidhen mesazhet, gjetjet e rekomandimet e çdo vendi të angazhuar, për të kuptuar e adresuar problematikën në nivel më të gjerë. SAI kroat propozoi gjithashtu edhe piramidën e pyetjeve për këtë auditim. Nga kjo piramidë pyetjesh, të gjitha

vendet, me përjashtim të Bosnje-Hercegovinës që ka një vijë të shkurtër bregdetare (rreth 10 km), ranë dakord që pyetja kryesore vlente për të gjithë. Me propozimin e z. Rinald Muça, pjesa vijuese e piramidës së pyetjeve duhej të fokusohej në auditimin e inputeve dhe outputeve të procesit menaxhues të ndërhyrjeve në rast katastrofash, propozim i cili u pranua nga pjesëmarrësit dhe u detajua më tej. Në takimin vijues, kolegët auditues të vendeve pjesëmarrëse do të prezantojë planin e auditimit për të mësuar dhe komentuar nga puna e gjithësecilit.

Si gjithnjë, mikpritja e SAI-t kroat, veçanërisht ndaj grupit shqiptar të përbërë nga z. Rinald Muça, znj. Elfrida Agolli, z. Alfred Zylfi dhe znj. Megi Kurushi, ishte mbresëlënëse dhe dëshmi e mbështetjes që Kroacia ka dhënë dhe jep vazhdimisht për vendin tonë. Një rëndësi të veçantë në këtë takim morën edhe bisedat midis palës shqiptare dhe asaj sllovene, kryesuar nga drejtori i auditimit të performancës në SAI-n slloven, z. Miroslav Kranjc, një novator i mirëfilltë në auditimin e performancës.

KLSH nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Në datën 14 nëntor 2019, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj dhe Rektori i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Prof.Dr.Adem Bekteshi nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në ambientet e KLSH-së, në kuadër të Muajit të Hapur që po zhvillon institucioni.

Marrëveshja vjen në kuadër të interesit të përbashkët për të bashkëpunuar në rritjen e kapaciteteve dhe njohurive profesionale të stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në njërën anë, si dhe në zhvillimin e kurrikulave, mendimit shkencor të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në anën tjetër, përmes kontributit që ofron KLSH-ja si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili ndihmon në përmirësimin e menaxhimit të fondeve publike nga Qeveria dhe entet e tjera publike nëpërmjet auditimit.

Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj falënderoi fillimisht Rektorin për gadishmërinë e treguar për nënshkrimin e marrëveshjes dhe theksoi se vijimi dhe thellimi i bashkëpunimit me stafet akademike

dhe universitare tregon jo vetëm hapjen e institucionit por edhe dëshirën për të bashkëpunuar dhe për të mësuar nga eksperienca dhe përvoja e institucioneve të tjera. Ne, në këtë drejtim, jemi mbështetur në moton e INTOSAI-t,"Nga Eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë", duke qenë të bindur se përfitimi do të jetë dypalësh si për KLSH, ashtu edhe për Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Prof.Dr.Adem Bekteshi, Rektori i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", nga ana e tij theksoi se e ka pritur me kënaqësi ftesën e KLSH-së, duke vlerësuar këtë institucionin si më të rëndësishmin për kontrollin financiar në vend. Realizimi i praktikave të studentëve të Universitetit "Luigj Gurakuqi" në KLSH do të ngrinte kapacitet e studentëve dhe do t'u jepte atyre mundësinë të ushtronin dijet e tyre në "laboratorin e një ekonomisti të vërtetë". Gjithashtu - vijoi z.Bekteshi- Universitetit "Luigj Gurakuqi" do të presë me shumë interes drejtuesit dhe audituesit e KLSH-së që të japin leksione në auditorët e këtij Universiteti.

Zoti Leskaj e mbështeti kërkesën e Rektorit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", duke theksuar që KLSH ka të gjitha kapacitetet për të realizuar leksione me vlerë nga drejtues dhe auditues me shumë eksperiencë në Auditimin e Jashtëm Publik dhe gjithashtu nga anëtarë të stafit të cilët mbajnë grada dhe tituj shkencorë.

Në nënshkrimin e kësaj marrëveshje morën pjesë përfaqësues të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si dhe drejtues dhe auditues të KLSH-së.

Fuqizimi i marrëdhënieve ndërmjet Parlamentit dhe Institucionit Suprem të Auditimit për përmirësimin e performancës së auditimit të jashtëm në vendet e Ballkanit Perëndimor

Në 12- 14 Nëntor, në Podgoricë, Mali i Zi, Banka Botërore dhe Parlamenti i Malit të Zi organizuan seminarin Rajonal " Fuqizimi i Marrëdhënieve ndërmjet Parlamentit dhe Institucionit Suprem të Auditimit, për të përmirësuar performancën e auditimit të jashtëm në vendet e Ballkanit Perëndimor", në të cilën KLSH mori pjesë me delegacionin e përbërë nga znj.Albana Gjinopulli, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, znj. Edlira Sako, Drejtore e Drejtorisë së

Burimeve Njerëzore dhe audituesit e lartë znj. Miranda Haxhia dhe znj. Jorida Zhegu.

Iniciativa e organizimit të Seminarit Rajonal për Institucionet Supreme të Auditimit dhe Komisionet Parlamentare për Financat dhe Llogaridhënien Publike, është një vazhdimësi e nismës të mbajtur në Tiranë në maj 2019, të organizuar nga Banka Botërore dhe Programi OECD për Mbështetjen e Reformave të Administratës Publike (SIGMA), ku përfaqësuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor identifikuan planet e veprimit në nivel vendi, për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë midis këtyre dy institucioneve.

I konceptuar mbi katër interface, Seminari eksploroi situata të zhvillimit në rajon lidhur me raportin dhe marrëdhëniet që ekzistojnë ndërmjet Parlamentit dhe SAI-t të vendeve pjesëmarrëse, sfidat kryesore për auditim dhe mbikëqyrje financiare efektive si dhe u diskutuan çështje të formësuara rreth tri fushave me interes të ndërsjellë për SAI-n dhe Parlamentin të tilla si: Pavarësia e SAI-t, Shqyrtimi i Raporteve të auditimit nga Parlamenti dhe ndjekja e rekomandimeve të auditimit.

Seminari Rajonal siguroi një platformë për ekspertët nga parlamentet dhe SAI-t për të:

(i) informuar njëri-tjetrin për zbatimin e planeve institucionale të veprimit;

(ii) shkëmbyer njohuri të praktikave dhe prezantime të strategjive dhe qasjeve teknike për të forcuar bashkëpunimin midis parlamenteve dhe institucioneve supreme të auditimit; dhe

(iii) hulumtoi se si të maksimizohen përfitimet e bashkëpunimit nëpërmjet aplikimit të llojeve të ndryshme të auditimit ose mbikëqyrjes së subjekteve specifike, siç janë ndërmarrjet shtetërore.

Përfaqësuesit e KLSH dhe institucioneve supreme të auditimit të vendeve të rajonit prezantuan progresin e bërë në lidhje me planin e veprimit për forcimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe nxorën në pah fushat për përparim të mëtejshëm. Diskutimet u fokusuan në përdorimin e

një memorandumi bashkëpunimi që i shërben të dy palëve si një mjet për arritjen e një komunikimi më efektiv, i cili përcakton masa për përmirësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë në mënyrë që të promovojë përgjegjshmëri, transparencë dhe qeverisje të mirë në fushën e financave publike.

Gjatë punimeve të Seminarit pjesëmarrësve iu mundësua shkëmbimi i përvojave dhe për të nxjerrë përfundime në lidhje me çështje që lidhen me të kuptuarit e raporteve të auditimit, nëpërmjet përdorimit të produkteve të auditimit në vlerësimin e performancës së sektorit publik, monitorimin e zbatimit të rekomandimeve dhe punën e Institucioneve Supreme të Auditimit në planifikimin dhe buxhetimin.

Bazuar në përvojat e përbashkëta të pjesëmarrësve dhe konkluzionet nga Seminari, do të hartohen instruksione të përbashkëta që do t'i shërbejnë Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor si një udhëzues për zhvillimin e protokolleve të bashkëpunimit.

KLSH merr pjesë në edicionin e XXII-të të Panairit të Librit

Në datat 13-17 nëntor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXII-të të Panairit të Librit, në Tiranë, duke shënuar kështu për të shtatin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 109 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë në këtë panair.

Fjalën e hapjes e mbajti zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH-së, e cila vlerësoi botimet e KLSH-së në vite dhe rëndësinë që ato kanë në drejtim të rritjes së transparencës së veprimtarisë së institucionit.

Më pas e mori fjalën zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me jashtë. Zonja Islami theksoi që mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit për vitet 2018-2022 dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH-se 2017-2019, ne jemi mbledhur sot në këtë sallë për të promovuar botimet e KLSH-së në vite dhe veçanërisht ato të vitit 2019.

Në panairin e këtij viti, KLSH po paraqitet me 109 tituj, ndër të cilët :

- 22 numra të Revistës Shkencore “Auditimi Publik” në gjuhën shqipe dhe angleze;
- 7 analiza vjetore të punës së KLSH-së;
- 8 botime që i dedikohen Performances së institucionit në shqip dhe në anglisht;
- 12 volume të shkrimeve të përmbledhura të audituesve në shtypin e përditshëm;

- 6 volume që lidhen me Konferencat Shkencore vjetore të KLSH-së;
- Tituj te tjerë që pasqyrojnë auditimet e KLSH-së në vitet 2012-2018, strategjitë e KLSH-së, historikun e INTOSAI-t, rregulloret e KLSH-së, etj

Jo pa qëllim në fillim kemi renditur 22 numra të Revistës Kërkimore Shkencore "Auditimi Publik", e cila vijon "të qëndrojë me dinjitet", megjithë përpjekjet e mëdha që nevojiten për realizimin e saj.

Në këtë Revistë kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, duke i dhënë "Auditimit Publik" një vlerë të shtuar dhe një përmasë rajonale, duke kontribuar në mbledhjen e mendimit të përparuar të profesionistëve të fushës së auditimit.

Në kolanën e botimeve të KLSH-së bëjnë pjesë 12 botime krejt të veçanta (një enciklopedi), "Audituesit e KLSH-së në median e shkruar", referuar shkrimeve të audituesve të KLSH-së në periudhën 2013- gusht 2019. Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar në median shqiptare, duke rritur transparencën e veprimtarisë së institucionit.

Kolana e botimeve të KLSH është shtuar me 8 tituj në 2019 :

- Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2018 në shqip dhe në anglisht;
- Dy numra te Revistës Kërkimore-Shkencore, "Auditimi Publik";
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm;
- Dokumente të Kryetarit, 2016-2018;
- Manuali i Auditimit të Prokurimeve Publike;
- Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së &Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të proceseve;

Kolana e botimeve të KLSH-së do të plotësohet deri në fund të këtij viti edhe me 2 botime të tjera, duke e çuar në 111 numrin e botimeve të realizuara në tetë vjet (revista nr.23 dhe botimi për Konferencën Young ALSAI).

Zonja Islami bëri një përmbledhje të shkurtër të çdo botimi të vitit 2019, duke u ndaluar në :

Manuali i Auditimit të Prokurimeve Publike

Duke theksuar rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që auditimi i

jashtëm publik ka në mbrojtjen e interesave të Shtetit në fushën e prokurimeve, KLSH u mbështet nga Banka Botërore nëpërmjet Projektit "Rritja e Performancës së Prokurimit" i cili kishte si Objektiv: forcimin dhe zhvillimin e monitorimit të pajtueshmërisë dhe rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit publik si dhe rritjen e kapaciteteve të KLSH-së për të audituar prokurimin e kontratave publike dhe kontratat e financuara nga donatorët në Shqipëri.

Si produkti më i rëndësishëm ishte hartimi i "Manualit të Auditimit të Prokurimit Publik", i përgatitur nga një Ekspert i Bankës Botërore ne fushën e prokurimeve publike, i cili është përshtatur nga KLSH sipas kërkesave të institucionit.

Së bashku me botimin e KLSH "Direktiva e BE-së mbi Prokurimin Publik dhe Kontratat Koncesionare", Manuali i Auditimit të Prokurimit Publik formojnë një paketë të plotë udhëzuesish me instruksione dhe dokumente të dobishëm për audituesit e KLSH në realizimin e misionit të tyre në kqyrjen dhe vlerësimin e rregullshmërisë dhe perfomancës së sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, si dhe mënyrës së përdorimit të fondeve publike.Revista Shkencore, numri 21 (gusht-dhjetor 2018) dhe Revista Shkencore, numri 22 (janar-prill 2019)

Tre numra të Revistës Kërkimore-Shkencore të KLSH-së i shtohen çdo vit kolanës së botimeve të Institucionit, duke filluar që nga viti 2012. Ketë vit janë përfunduar dy numra (21 dhe 22) në të cilët kanë kontribuar me shkrimet e tyre Dr.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së,Prof.Dr.Skënder Osmani, auditues dhe drejtues të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve, pedagogë, profesorë, Profesionistë të fushës, etj.

Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së

KLSH i udhëhequr nga praktikat më të mira profesionale ndërkombëtare, i angazhuar për t'u zhvilluar dhe ecur përpara, zhvillon dhe përditëson bazën metodologjike, rregullatore dhe udhëzuese dhe për këtë arsye ka si pjesë të kolanës së saj të vitit 2019 botimet :

-Rregullorja e Procedurave të Auditimit; dhe

-Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve(RevZone).

Ligji i ri organik zgjeroi dimensionet audituese duke përvijuar horizonte të reja. Në funksion të këtij zhvillimi u kristalizua e plotë metodologjia audituese në të gjithë nivelet e saj.

Zoti Fatos Çoçoli, u përqëndrua në botimin, Dokumente të Kryetarit, 2016-2018 dhe theksoi që ky botim vjen në vijim të botimit "4 vjet Auditimi i Jashtëm Publik" (2012-2015) dhe i referohet aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën tre vjeçare 2016-2018. Në të njëjtën linjë me këto dy botime, KLSH ka botuar edhe librin "Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939".

Libri ka shtatë kapituj, në të cilët përfshihen Raportimet e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë; Artikuj të botuar në shtypin e përditshëm; Shkrime në Revistën Kërkimore-Shkencore "Auditimi Publik"; Diskutime në Analizat Vjetore të KLSH-së; Prezantime dhe kumtesa në Konferenca Shkencore, etj.

Zonja Luljeta Nano, Sekretare e përgjithshme e KLSH-së diskutoi rreth dy botimeve: Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2018 në shqip dhe Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2018 në anglisht.

KLSH ka përfshirë në kolanën e botimeve të tij që prej vitit 2013 botimin e Performancës së aktivitetit të veprimtarisë së tij në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze (një botim i përbashkët) dhe është hera e katërt në vitin 2019 që ky libër botohet veçmas në gjuhën angleze, për t'ju përgjigjur interesit në rritje për këtë botim nga partnerët ndërkombëtarë, duke filluar nga institucionet supreme të auditimit me të cilët ne kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë, si edhe me të gjitha përfaqësitë e huaja diplomatike të akredituara në Tiranë, organizmat dhe shoqatat e huaja që punojnë në Shqipëri, veçanërisht në fushën e mirë-administrimit të fondeve dhe luftës kundër korrupsionit.

Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të proceseve

Përfshirja në këtë botim e Rregullores së Sistemit të Menaxhimit të Proceseve i referohet faktit që përdorimi i teknologjinë së informacionit është i domosdoshëm për rritjen e efektivitetit, efiçencës dhe transparencës së procesit të auditimit.

Zoti Aldo Kita, Përgjegjës i Sektorit të IT bëri një pasqyrë të këtij botimi.Implementimi i sistemit të informacionit për menaxhimin e proceseve në Kontrollin e Lartë të Shtetit do të optimizojë procesin e

auditimit duke respektuar parimet mbi të cilat ai mbështetet.

Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve paraqet një pasqyrim të plotë të procedurave që ndiqen për menaxhimin, administrimin dhe përdorimin e sistemit të informacionit që Kontrolli i Lartë i Shtetit përdor për menaxhimin e proceseve të auditimit dhe atyre administrative.

Kjo rregullore ofron një dokumentim të plotë të udhëzimeve të nevojshme për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit dhe proceseve që gjenerohen nëpërmjet sistemit të informacionit.

Si një dokument i rëndësishëm për mirëfunksionimin e sistemit, kjo rregullore gjithashtu përcakton parimet e përgjithshme dhe masat organizative e teknike për mbrojtjen dhe ruajtjen e sigurisë së të dhënave.

Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (volumi XII, janar-gusht 2019)

Prezenca e audituesve të KLSH-së në median e shkruar, shkrimet e të cilëve i janë paraqitur të përmbledhura publikut në disa volume dhe konkretisht KLSH ka përfunduar volumin e XII-të të këtyre botimeve, ose ndryshe "Enciklopedinë" me 12 volume të punës së Audituesve të KLSH-së në 7 Vjet (periudha 2013-2019).

Zoti Redi Ametllari nënvizoi që botimi "Audituesit e KLSH-së në Shtypin e përditshëm" ka arritur në volumin e tij të XXII, por botimi i 12-te nuk është stacioni i fundit i saj. Zakonisht, botimeve që pasohen me volume u ndodh që të pësojnë një bjerrjeje, por ky botim ka ardhur gjithnjë e duke pasuruar dhe për këtë kanë një kontribut të gjithë audituesit, të cilët janë bashkautorët e saj.

Ndonëse mund të duket një libër i thjeshët, një antologji shkrimesh, në fakt botimi në vetvete, përbën një reformë të rëndësishme institucionale për transparencën. E gjitha puna jonë është e lidhur me procesin e të shkruarit, nga fillimi deri në fund dhe fale punës sonë në KLSH, na ofrohet një mundësi për t'u ofruar qytetarëve drejtpërdrejt përmes gazetës, problem dhe shkaqet që fshihen pas shifrave dhe vargut të ligjeve dhe VKM-ve.

Audituesit në shtypin e përgjithshëm- vijoi z.Ametllari- ka edhe një rol tjetër, të cilën një pjesë e mirë prej nesh mund ta zbulojnë më vonë. Ai do të shërbejë si një mozaik kujtimesh, ku secili prej nesh, mund t'i kthehet më vonë, qoftë për të kujtuar kohën në KLSH apo qoftë edhe për pse jo për një libër me kujtime apo punim shkencor.

Në fund takimin e mbylli zj.Islami, e cila theksoi që sfida e KLSH-së ishte 100 tituj në fund të vitit 2018. Me numrin e botimeve që kemi realizuar deri tani si institucion, mund te themi që nuk kemi më përpara nesh një sfidë por një realitet.

Kolana e botimeve të KLSH-së me 111 titujt e saj deri në fund të vitit 2019 ka certikuar faktin që institucioni po sfidon veten sepse nuk ka asnjë institucion tjetër shtetëror që ti ketë dhënë kaq rëndësi librit dhe forcimit të kapaciteteve të stafit të tij.

Pas përfundimit të promovimit të kolanës së botimeve të KLSH-së, audituesit vizituan panairin e librit dhe stendën e KLSH-së.

Aktivitet mbi Rregullimin e përgjithshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe impaktin në proceset audituese

Ndërthurjen e proceseve audituese me angazhimet e derivuara nga rregullimet ligjore të përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave personale ishin në fokusin e diskutimeve përgjatë workshopit të mbajtur në datën 15 Nëntor në Larnaca, Qipro, në të cilin, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua me Drejtori i Përgjithshëm, znj. Lindita Milo dhe specialistja e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Amantja Patozi.

Zyra e Auditimit të Republikës së Qipros, në bashkëpunim me Gjykatën Europiane të Audituesve (ECA) dhe Komisionin Europian, në kuadrin e aktiviteteve për Objektivin Strategjik nr 1, "Mbi promovimin e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) të pavarura, me njohuri shumë-disiplinore dhe të forta si dhe nxitjen e mirëqeverisjes së tyre", organizuan një diskutim të detajuar mbi parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe menaxhimin e tyre gjatë proceseve audituese, duke përfshirë grumbullimin, transferimin, arkivimin, të drejtën e aksesit, anonimatin dhe fshirjen e sigurtë të të dhënave personale të subjekteve të audituara nga KLSH.

Eksperiencat më të mira të paraqitura nga ekspertet e Komisionit Europian, znj. Irini Haller, zyra e Auditimit të Brendshëm, z. Bertil Ramussen, zyra e Mbrojtjes së të Dhënave dhe z. Johan Van Damme, Gjyakata Europiane e Audituesve, evidentuan domosdoshmërinë e përmirësimit të infrastrukturës ligjore dhe organizative, të cilat do të mundësojnë

kapërcimin e pengesave që mund të evidentohen përgjatë përdorimit të të dhënave të gjeneruara nga sistemet e integruara të informacionit të qeverisë "Big Data dhe Data Mining".

Aktiviteti u përshëndet edhe nga Audituesi i Përgjithshëm i Republikës së Qipros,Dr. Odysseas Ph. Michaelides.

KLSH merr pjesë në seminarin e parë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2030

Në datën 21-22 nëntor 2019, në Lisbonë të Portugalisë, u organizua seminari i parë i EUROSAI-it dhe AFROSAI-t mbi ndarjen e eksperiencave në auditimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për realizim deri në vitin 2030. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga mbi 50 SAI të ndryshme, kryesisht europiane dhe afrikane. Qëllimi i takimit ishte sensibilizimi i pjesëmarrësve për emergjencën në arritjen e 17 objektivave dhe adresimin e duhur të tyre tek qeveritë përkatëse.

Fjalën përshëndetëse të takimit e mbajtën z. Vítor Kaldeira, president i Gjykatës Portugeze të Llogarive dhe z. António Guterres, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Ata e vunë theksin tek sfidat e përbashkëta me të cilat ndeshet sot komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht tek varfëria, pabarazia sociale, ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor, paqja, drejtësia dhe arsimimi. Më pas, për të reflektuar mbi kontributin që mund të japin SAI-et përballë këtyre sfidave, fjalën e morën z. Dmitry Zaitsev, President i SAI-t rus që aktualisht mban presidencën e INTOSAI-t, z. Mamadou Faye, Auditor i Përgjithshëm i Senegalit, që mban njëkohësisht dhe postin e Presidentit të AFROSAI-t dhe z. Seyit Baş, President i Gjykatës Turke të Llogarive dhe njëkohësisht President i EUROSAI-t.

Në ditën e parë të takimit u diskutuan perspektivat e ndryshme për temën potenciale nën auditim. Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t solli këndvështrimin global, përmes një auditimi performance të kryer mbi një implementimin e një pjese të këtyre objektivave. SAI të ndryshme, si ai portugez, austriak, brazilian, gjerman, kenian, spanjoll, turk, etj., sollën eksperiencat e tyre kombëtare në auditimin e implementimit të objektivave të ndryshëm në kuadrin e 17 objektivave. Në mbyllje të ditës së parë të takimit u formulua edhe një rezolutë mbi konkluzionet e seminarit e konkretisht:



INTOSAI - EUROSAI - AFROSAI

1. SAI-et kanë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm;
2. SAI-et mund të implementojmë një larmishmëri qasjesh dhe metodash për të audituar përgatitjen e qeverive respektive, duke përfshirë të gjithë aktorët shoqërorë.
3. Është kritik auditimi i performancës së qeverive në arritjen e objektivave kombëtare, për të garantuar se nevojat e brezave të ardhshëm janë pasqyruar me vëmendjen e duhur në dokumentet e politikës;
4. Eksperienca që buron nga auditimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm ka një ndikim pozitiv në punën e anëtarëve të EUROSAI-t dhe AFROSAI-t;
5. Në auditimin e këtyre objektivave ka hapësira të çmueshme për bashkëpunim midis anëtarëve të EUROSAI-t, AFROSAI-t, OLACEF e më gjerë.

Rrjedhimisht, anëtarët e EUROSAI-t dhe AFROSAI-t të mbledhur në Lisbonë, janë të përkushtuar në bashkëpunimin dhe ndarjen e informacionit në fushën e auditimit, si edhe në ngritjen e kapaciteteve që lidhen me auditimin e implementimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Në ditën e dytë të takimit u organizua ceremonia festive për 630-vjetorin e Casa dos Contos dhe 170-vjetorin e Tribunal de Contas portugez. Ceremoninë e përshëndeti Presidenti i Republikës së Portugalisë, z. Marcelo Rebelo de Sousa, përfaqësuesit më të lartë të SAI-t portugez dhe të ftuar të tjerë të institucioneve kombëtare e ndërkombëtare.

Në këtë seminar, KLSH u përfaqësua nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, dhe Drejtori i Përgjithshëm, z. Rinald Muça. Delegacioni shqiptar pati takime frytdhënëse me drejtues të SAI-t portugez, polak, turk, bullgar, malazez, etj. Në takim u vendosën ura bashkëpunimi për auditime të përbashkëta performance me vendet anëtare të EUROSAI-t, sikurse ai që është aktualisht në proces me SAI-n kroat, italian e slloven mbi “Ndotjen e Menjëhershme të Deteve”. Gjithashtu, departamenti i auditimit të performancës në KLSH ka kryer një sërë auditimesh performance që reflektojnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, me fokus barazinë gjinore, cilësinë e arsimimit, varfërinë, eficiensën e energjisë, menaxhimin e ujit të pijshëm, etj. Në të ardhmen, departamenti i performancës do të vijojë angazhimin në auditimin e implementimit të këtyre objektivave, për një Shqipëri që ecën krahas partnerëve të saj europianë e botërorë.

Tryezë diskutimi i Grupit të përfaqësuesve nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës dhe Departamentit të Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë në Kontrollin e Lartë të Shtetit

Në datën 26 Nëntor 2019, në Kontrollin e Lartë të Shtetit u organizua tryeza e diskutimit "Sigurimi i Cilësisë në Auditim" si një iniciativë e përbashkët ndërmjet stafit me përfaqësues të Zyrës kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe Departamentit të Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë së KLSH-së. Delegacioni kosovar u prit nga Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj.

Tryeza u realizua në formatin e bisedimeve të hapura duke shkëmbyer njohuri dhe përvoja mbi tematikën e përzegjdhur. Fokusi i aktivitetit ishte kontrolli dhe sigurimi i cilësisë së auditimit si një sfidë për cdo SAI modern dhe të zhvilluar.

Trajtimi i çështjeve mes të pranishëmve sollën një pejsazh të plotë nga secili institucion të procedurave të realizimit të kontrollit në të ftohtë dhe në nxehtë të dosjeve të auditimit. Trajtimi i ideve të reja dhe nxjerrja e konkluzioneve mbi ndryshimet dhe të përbashkëtat ndërmjet dy Institucioneve të Auditimit të dy vendeve tona nxorën në dukje diferenca dhe problematika që shoqërojnë këto procedura, varësisht qasjeve të ndryshme që kanë institucionet.

Aktualisht në ZKA, kontrolli i cilësisë në të "ftohtë" asistohet drejtpërdrejtë nga ekspertët e NAO-s suedeze, ç'ka u ka bërë të mundur kolegëve kosovarë të "prekin" në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të përfitojnë nga eksperienca e vendeve të zhvilluara. Marëdhëniet ndërmjet ZKA-së dhe Parlamentit në Kosovë duket se kanë një intensitet të ndryshëm nga praktika e punës së KLSH-së. ZKA paraqet në Parlament cdo Raport Auditimi respektivisht në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë.

Diskutime të shumta pati ndërmjet kolegëve lidhur me problemet që stafi i departamentit të metodologjisë dhe veçanërisht sigurimi i cilësisë has në praktikën e punës. Në këtë prizëm u trajtuan eksperiencat e dy vendeve me problematikat e identifikuara gjatë procesit të sigurimit të cilësisë duke vërejtur dhe natyrën e tyre sistematike. Problematika të tilla gjetën vend tek eksperiencat e të dy

SAI-ve homologe me raste të situatave të ngjashme nga përditshmëria e punës së tyre, duke i mëshuar faktit se të qënurit në pozitat e një kontrolluesi të cilësisë në auditim, është një pozicion, i cili duhet të nxisë palët në komunikim dhe qasje mirëkuptuese. Në fund takimi u përmbyll me konsiderata nga të dy palët dhe me besimin tek përkrahja dhe bashkëpunimi ynë i ndërsjellë institucional.

KLSH merr pjesë në seminarin mbi Ndërtimin e Mirëbesimit – Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në sigurimin e besueshmërisë së të dhënave fiskale

Në datat 28-29 nëntor 2019, Në Helsinki të Finlandës, u organizua seminari për "Ndërtimin e mirëbesimit – Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në sigurimin e besueshmërisë të të dhënave fiskale". Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) të vendeve të BE-së, autoritetet e statistikave finlandeze dhe greke dhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore finlandeze u mblodhën sëbashku për të diskutuar rëndësinë e të dhënave të besueshme në drejtimin dhe monitorimin e financave të qeverisë së përgjithshme. Seminarin e përshëndeti znj. Tytti Yli-Viikari, Auditor i Përgjithshëm i Finlandës, e cila u shpreh se duhen diskutuar dhe gjetur mënyra të përbashkëta për të siguruar besueshmërinë e të dhënave fiskale. Në një botë me ndryshim, është gjithnjë e rëndësishme të ruhet besimi në informacionin e qeverisë dhe të sigurohet që të dhënat fiskale janë të besueshme. Të dhënat statistikore jo të besueshme dhe jo të plota kanë shkaktuar probleme në të kaluarën e fundit, gjatë krizës së euros.

Sipas znj. Tytti Yli-Viikari, Auditor i Përgjithshëm i Finlandës, autoritetet Supreme të Auditimit duhet t'u sigurojnë qytetarëve dhe vendimmarrësve informacion të besueshëm. Besueshmëria e të dhënave fiskale mund të sigurohet, për shembull, me udhëzime të zakonshme, rregullore, monitorim dhe auditim të jashtëm.

Pjesëmarrës në seminar ishin z.Olli Rehn, Guvernator i Bankës së Finlandës, i cili shërbeu si Komisioner Evropian gjatë krizës së euros, z.Martti Hetemäki, Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Financave dhe z.Marjo Bruun, Drejtor i Përgjithshëm i Statistikave në Finlandë.

Fokusi kryesor i seminarit ishtë besueshmëria e të dhënave fiskale. Të dhëna të tilla përfshijnë të dhëna të kontabilitetit të sektorit publik, si dhe statistika dhe parashikime në lidhje më financat e qeverisë. Në fjalën e tij z. Matti Okko, Drejtor në Zyrën Kombëtare të auditimit të Finlandës, theksoi fakte konkrete për rëndësinë e besueshmërisë së të dhënave. Kriza ekonomike evropiane ishtë një dëshmi konkrete e asaj që ndodh kur vendimet merren mbi bazën e të dhënave jo të besueshme. Duket se statistikat ekonomike ishin shtrëmbëruar dhe ishin mbajtur informacione thelbësore për detyrimet. Prandaj është e rëndësishme që autoritetet të sigurojnë të dhëna statistikore dhe parashikuese të besushme në financat e përgjithshme të qeverisë dhe SAI-t duhet të sigurojnë besueshmërinë e këtyre të dhënave.

Në fjalën e tij të hapjes, z. Martti Hetemäki, Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së Financave, tha "*Qëndrueshmëria fiskale është ndërtuar mbi autoritete të besueshme, të dhëna të fuqishme dhe rregulla të arsyeshme të politikës fiskale. Sidoqoftë, ajo që nevojitet përveç tyre është disiplina e tregut. Përpjekjet për të dhëna të besueshme fiskale bëhen si në nivelin ndërkombëtar ashtu edhe në atë kombëtar".*

Z. Olli Rehn, Guvernator i Bankës së Finlandës, i cili shërbeu si Komisioner Evropian gjatë krizës së euros, u shpreh në fjalimin e tij kryesor në seminar se *"Në vitet e fundit, BE ka rritur përpjekjet e saj në udhëzime dhe monitorim në lidhje me statistikat dhe rregullimin e politikës fiskale. Sidoqoftë, përgjegjësia për të dhëna të besueshme dhe vendime të qëndrueshme i takon secilit Shtet Anëtar".*

Në këtë seminar, KLSH u përfaqësua nga znj. Helena Solis, audituese në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe znj.Elisa Metaj, specialiste në sektorin e Statistikave.

Vizita studimore në Prishtinë "Sigurimi i Cilësisë në Auditim"

Në datën 2 dhjetor 2019, në kuadrin e muajit të hapur, një grup audituesish nga Kontolli i Lartë i Shtetit vizituan Zyrën Kombëtare të Auditimit në Kosovë, me fokus në „ *Sigurimin e Cilësisë në Auditim".* Grupi i KLSH i përbërë nga audituesit : z.E.Stafasani, zj.E.Kabashi, z.S.Hajdari, z.V.Rizvani, z.M.Hajro, z.R.Lushaj, z.E.Kojku, z.F. Çika, z.I.Bidaj, z.R.Alimerkaj, u prit edhe nga Auditori i Përgjithshëm i ZKA, z. Besnik Osmani.

Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit u mbajtën

dy kumtesa mbi sigurimin e silësisë në auditim, nga Drejtoria e Metodologjisë dhe Cilësisë së Auditimit të ZKA-së. Pjesmarrësit e dy institucioneve tona diskutuan mbi zhvillimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave midis dy institucioneve. Ata ishin të një mendimi me idenë që cilësia në auditim është përparësi dhe se kjo duhet të arrihet përmes një menaxhimi të vazhdueshëm dhe standarti të lartë të procesit të auditimit.

Korniza ligjore e cilësisë së auditimit në ZKA përfshinte tre komponentë kryesorë:
së pari, kontrolli i cilësisë, i cili ka lidhje me kryerjen e punës mirë, që në fillim, duke siguruar që procedurat e cilësisë janë të përfshira në punën operative të auditimit. Gjithashtu, kontrolli i cilësisë zbatohet në të gjitha fazat e procesit të auditimit siç janë: planifikimi, zbatimi, raportimi dhe përcjellja, dhe kjo realizohej nëpërmjet listave të hollësishme verifikuese për secilën fazë të auditimit.

Së dyti, monitorimi i cilësisë përfshinte rishikimin në të "nxehtë" për të siguruar që procedurat e kontrollit të cilësisë, janë duke vepruar në mënyrë efektive. Drejtoria e Metodologjisë dhe Cilësisë së Auditimit kryen rishikimin në të "nxehtë" sipas referencës në listat verifikuese standarde. Sipas praktikës në ZKA diagrama e rishikimit të cilësisë së auditimit tregohet si më poshtë:

Faza e Auditimit	Lista Kontrolluese	Rishikuesi
Faza e Planifikimit të Auditimit	A	Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
	B	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	C	Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit
Faza së Punës së Auditimit në Terren	D	Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
	E	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	F	Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit
Faza e Raportimit	G	Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
	H	Drejtori i Departamentit të Auditimit
	I	Departamenti për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit

Së treti, sigurimi i cilësisë, "rishikimi në të ftohtë", përfshin një vlerësim të jashtëm të pavarur të procedurave të kontrollit të cilësisë. Qëllimi i rishikimit të jashtëm është sigurimi i plotë i një vlerësimi të pavarur të standardeve të përmbushura. Në praktikën e ZKA, ky rishikim i jashtëm kryhet në kuadër të një projekti të përbashkët me Zyrën Kombëtare të Auditimit Suedez, nëpërmjet një procesi me zgjedhje. Ekipi i rishikimit të jashtëm do ta paraqesë raportin tek Auditori i Përgjithshëm duke i shtjelluar gjetjet

kryesore, fushat për përmirësim dhe masat e marra për arritjen e tyre.

Në funksion të zbatimit të qëllimeve strategjike, u pa me shumë interes fokusimi i ZKA në fushat si më poshtë:

-Rritja dhe forcimi i mëtejshëm i pavarësisë institucionale nëpërmjet: inicimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore; përditësimit të dokumenteve të metodologjisë së auditimit; pilotimit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe atyre të rregullsisë së proceseve të prokurimit të projekteve të donatorëve; zhvillimit të mëtejshëm të metodologjisë për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në risk; përdorimit të platformave elektronike për menaxhimin e auditimit.

-Forcimi i kapacitetit institucional nëpërmjet: ngritjes dhe forcimit të mëtejmë të kapaciteteve profesionale të personelit për zbatimin e planit strategjik; forcimit të mëtejshëm të kontrolleve të brendshme institucionale;

Gjithashtu, në funksion të zbatimit të qëllimeve strategjike të përbashkëta, si edhe me përkrahjen e Auditorit të Përgjithshëm Z.Besnik Osmani, pjesëmarrësit shprehën idenë mbi nevojën e organizimit të auditimeve të përbashkëta mbi menaxhimin e emergjencave si edhe sigurinë në industrinë e ndërtimit.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është themeluar më 4 tetor të vitit 2002 me Rregulloren 2002/18. Ky ishte hapi i parë i shpallur nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) për krijimin e auditimit suprem në Kosovë. Gjithashtu, në qershor të vitit 2016, Kuvendi Kosovës shpalli Ligjin e ri nr. 05/L-055 për Auditorin e Pëgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke zëvendësuar kështu ligjin e vjetër. ZKA kryen kryesisht auditime të rregullsisë, përfshirë edhe atë të Buxhetit të Kosovës. Ajo, duke filluar nga viti 2016 kryen auditime të performancës dhe të IT-së. Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës (ZKA) harton dhe dorëzon në Kuvend mbi 100 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performancës. Vetëm gjatë vitit të fundit ajo ka kryer 116 auditime të rregullsisë dhe 15 auditime të performancës. Mbi 1000 rekomandime jepen çdo vit për organizatat buxhetore. Të gjitha raportet e auditimit bëhen publike. Aktualisht, ZKA ka të punësuar rreth 160 punonjës, 130 prej të cilëve janë staf auditues.

KLSH merr pjesë në Trajnimin e 7-të Ndërkombëtar mbi Auditimin Mjedisor në Jaipur, Indi

Në datat 25 nëntor - 7 dhjetor 2019 u zhvillua në "Qendrën Ndërkombëtare

të Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm" (iCED) në Jaipur, Indi, Trajnimi i 7-të Ndërkombëtar mbi Auditimin Mjedisor. Në këtë takim morën pjesë auditues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga 16 vende të ndryshme të botës, konkretisht, Shqipëria, Rumania, Finlanda, Zambia, Gana, Sudani, Fixhi, Egjipti, Maldivet, Vietnami, Kuvajti, Vanuatu, Butani, Tanzania, India si dhe Gjykata Evropiane e Audituesve. Fjalën përshëndetëse të hapjes së Trajnimit e mbajtën z. A.W.K Langstieh zv. President i SAI-t të Indisë, z. Manish Kumar, Drejtor i Përgjithshëm i iCED dhe z. Pushkar Kumar, Drejtor i Trajnimeve dhe Kërkimit në SAI-n e Indisë. Në këtë event KLSH u përfaqësua nga z. Aulent Guri, Kryeauditues në Departamentin e Performancës.

Trajnimi u zhvillua duke kombinuar konceptet thelbësore teorike në fushën e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm me ushtrime praktike duke shkëmbyer eksperiencën e secilit auditues pjesëmarrës. Trajnues (auditues) me eksperiencë dhjetëra vjeçare nga SAI të ndryshme të botës referuan duke prezantuar auditimet më pikante dhe më të rëndësishme të zhvilluar në vendet e tyre duke prekur problemet kryesore mjedisore të cilat ata hasin. Trajnimi ishte projektuar për të garantuar njohuri për pjesëmarrësit për çështje mjedisore, duke përfshirë përzgjedhjen e tematikave të përshtatshme për auditim, zhvillimin e metodologjisë së auditimit, kritereve të duhura të auditimit dhe dhënien e rekomandimeve kuptimplotë.

Dita e parë e trajnimit u fokusua në përkufizimin e “Auditimit Mjedisor”, Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe bashkëpunimin e SAI-ve me INTOSAI WGEA (Working Group on Environment Auditing). Qëllimi i INTOSAI WGEA është të asistojë Institucionet Supreme të Auditimit në përvetësimin e çështjeve specifike lidhur me auditimin mjedisor, të lehtësojë shkëmbimin e eksperiencave midis SAI-ve duke publikuar “Përmbledhje” të raporteve të auditimit që të gjithë SAI-t realizojnë si dhe të hartojnë udhëzime dhe materiale informuese të ndryshme.

Studimi mbi “Kontabilitetin e Burimeve Natyrore” më 1998 dhe “Si mund të bashkëpunojnë SAI-t” kanë qenë dy publikimet e para të INTOSAI WGEA. Trajnuesit indonezianë, SAI i të cilëve ka udhëhequr INTOSAI WGEA në vitet

e fundit, theksuan disa prej auditimeve të performancës me tematikë mjedisore që janë publikuar nga INTOSAI WGEA pjesë e të cilëve është edhe auditimi i realizuar nga KLSH me temë "Ruajtja e Ekosistemit të Parkut Kombëtar të Prespës". Ditët pasuese vazhduan me tematika të ndryshme mjedisore si ndryshimet klimatike, përdorimi i energjive të rinovueshme, eficienca e energjisë, biodiversiteti, menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, si dhe rëndësia e Raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në projektet infrastrukturore. E veçanta e këtij Programi Trajnimi ishte se në çdo sesion "trajnuesit" aplikonin ushtrime duke kërkuar nga të gjithë pjesëmarësit jo vetëm të vinin në praktikë dijet e marra, por të ndërtonin pjesë të ndryshme të një raporti auditimi performance me perspektivë mjedisore.

Një tjetër çështje me mjaft interes, të cilën pothuajse të gjithë trajnuesit e prekën gjatë referimeve të tyre ishte dhe ajo e auditimeve bashkëpunese. Tre llojet kryesore të auditimeve bashkëpunuese janë "Joint Audit", "Co-ordinated Audit" dhe "Parallel Audit". Përgjatë diskutimeve të ndryshme z. Guri solli në vëmëndjen e të gjithë pjesëmarrësve eksperiencën pozitive të KLSH-së në auditimet paralele të cilat ka zhvilluar vitet e fundit e veçanërisht në auditimet e performancës me tematikë mjedisore. Nën moton "Experentia mutua omnibus prodest" të gjithë audituesit pjesëmarrës ishin në sinkron për rëndësinë që kanë auditimet bashkëpunese, të cilët janë vlerë e shtuar për auditimin e jashtëm publik. Përgjatë diskutimeve u hodhën ide të shumta për bashkëpunimin dhe organizimin e auditimeve të përbashkëta për ato çështje mjedisore që kanë ngjashmëri midis vendeve pjesëmarrëse në këtë trajnim. Trajnimi u mbyll më datën 7 nëntor me fjalën përshëndetëse dhe falenderuese të z. Venkatesh Mohan, zv/Presidentit i SAI-t të Indisë, i cili bërë edhe dorëzimin e çertifikatave për të gjithë pjesëmarrësit.

Pjesëmarrje e KLSH-së në Takimin Organizativ mbi auditimin e përbashkët për mbetjet plastike në Krakovë, në datat 10-11 Dhjetor 2019

Në datat 10-11 Dhjetor 2019, në Krakovë, Poloni, u organizua Takimi Organizativ mbi auditimin e përbashkët për mbetjet plastike.

Në këtë auditim kanë shprehur dëshirën të marrin pjesë katërmbëdhjetë SAI, të cilët janë SAI Polak, që është dhe drejtuesi i projektit, Gjykata Europiane e Audituesve, Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë, SAI i Bullgarisë, SAI i Republikës Çeke, SAI i Estonisë, SAI i Hungarisë, SAI i Maltës, SAI i Moldavisë, SAI i Portugalisë, SAI i Rumanisë, SAI i Serbisë, SAI i Sllovakisë dhe SAI i Holandës.

SAI i Holandës e ka përfunduar auditimin, Gjykata Europiane e Audituesve e ka filluar tashmë, ndërsa SAI i Republikës Çeke do ta fillojë në vitin 2021. Të gjithë SAI-t e tjerë do ta kryejnë auditimin gjatë vitit 2020. Pjesëmarrës në takim ishte dhe SAI i Finlandës si i ftuar, duke qenë se nuk do të marrë pjesë në auditim por do të ndihmojë përgjatë procesit të këtij auditimi.

Gjatë ditës së parë të Takimit, prezantuan SAI i Holandës mbi përfundimet e auditimit në këtë SAI, si dhe përfaqësuesi i Gjykatës Europiane të Audituesve mbi të dhënat e grumbulluara deri në fazën aktuale të auditimit për mbetjet plastike. Këto prezantime kishin për qëllim të ndihmojnë SAI-t e tjera të krijojnë ide paraprake mbi punën në vijim.

Në vijim SAI Polak prezantoi fushën dhe drejtimet e auditimit, të cilat janë si në vijim: Pyetja kryesore e auditimit: A kanë zhvilluar autoritetet përkatëse publike (administrata shtetërore dhe / ose vetëqeverisja) politikë (plane, strategji) dhe masa të zbatuara që synojnë arritjen e qëllimeve (të miratuara në këtë politikë) në lidhje me menaxhimin e mbetjeve plastike?

Aspekti 1: A ka miratuar vendi rregullore ligjore dhe rregullime organizative në lidhje me trajtimin e mbetjeve plastike?

Aspekti 2: A është aplikuar ndonjë politikë (plane, strategji) për të zbatuar menaxhimin e duhur të mbetjeve plastike dhe për të përmirësuar efiçiencën e përdorimit të burimeve të disponueshme?

Aspekti 3: A janë monitoruar rezultatet e masave të zbatuara në lidhje me trajtimin e mbetjeve plastike dhe cilat efekte janë arritur në kontekstin e qëllimeve të përcaktuara?Auditimi do të kryhet për periudhën 2017-2019.

Gjatë ditës së dytë të auditimit u ra dakord mbi përmbajtjen Memorandumit të Mirëkuptimit mes

SAI-eve pjesëmarrëse. Pasi të jetë hartuar i plotë dhe sipas sugjerimeve që u bënë gjatë takimit Memorandumi do t'i dërgohet çdo SAI me postë për t'u firmosur.

Auditimi i përbashkët do të zhvillohet gjatë vitit 2020 me synimin për t'u publikuar i plotë në vitin 2021.

KLSH në këtë takim u përfaqësua nga z.Kozma Kondakçiu, Drejtor i Departamentit të Auditimit të IT, zj.Mimoza Lloji, Audituese e Lartë dhe zj.Keida Muça, Audituese e Parë.

KLSH merr pjesë në takimin e X-të për Auditimin e Etikës, organizuar nga grupi Task Force (EUROSAI) për Auditimin e Etikës

Në datat 10-11 dhjetor 2019, u zhvillua në Bon, takimi i X-të i grupit Task Force të EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi, KLSH mori pjesë në këtë aktivitet të EUROSAI-t, i cili trajtoi çështje të rëndësishme që lidhen me Etikën dhe integritetin, si edhe diskutoi për të ardhmen e kësaj Task- Force dhe planin e saj të aktiviteteve.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e 22 SAI-ve: Gjermania si

